Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (178) QERSHOR 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
Tani edhe në
MAQELLARË
Mbi 100 produkte
1+1 falas
— Faqe 24

VLERËSIM

Doktorët Alma Cani dhe Edmond Puca marrin titullin "Qytetar Nderi"

Nga **SAKIP CAMI** — Faqe 11

KULTURË

Sami Gonxhja, autori i muzikës "Marshi i Djelmënisë dibrane"

Nga **prof. HYQMET GONXHJA** — Faqe 7

VLERËSIM

"Mjeshtër i madh", titull i merituar për Muharrem Gjokën

Nga **HALIL RAMA** — Faqe 19

PROFIL

Hysen Kuka, biri i rrallë i Rremullit të Matit

Nga **MEVLUD BUCI** — Faqe 21

Qeveria ecën përpara me projektin e Skavicës, firmos me 'Bechtel' fazën e parë të ndërtimit

Nënshkruhet kontrata: Kompania amerikane "Bechtel" ka 18 muaj kohë për studimin gjeologjik, mjedisor, teknik e social

SHËNIM

Braktisja e Dibrës nuk duhet të ndodhë

Është koha që banorët të bëhen bashkë jo vetëm për ta kundërshtuar, por edhe për të kërkuar më shumë investime në të gjitha fushat e ekonomisë, në mënyrë që edhe nëse vendoset të ndërtohet, banorët nuk duhet të shpërngulen. Ata duhet ta ringrenë jetën e tyre rreth asaj toke dhe në ato troje. Është koha të maksimalizojmë kërkesat dhe interesat tona, me qëllim që shpërngulja të mos ndodhë, për asnjë çmim.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Qeveria shqiptare ka vazhduar me projektin për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës. Ashtu siç kishte premtuar edhe më parë, me miratimin në mars të ligjit nr. 38/2021, me 93 vota pro në parlamentin shqiptar, u vazhdua me nënshkrimin e kontratës për fazën e parë të procesit, e cila u firmos nga drejtori i KESH dhe përfaqësuesi i kompanisë amerikane Bechtel, me praninë e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.

Faza e parë e projektit përfshin matjet topografike dhe studime hidrologjike; studime dhe inspektime gjeoteknike në terren; zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit; rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social; përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, si dhe shërbime të tjera të dakordësuara, për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës.

(Vijon në faqen 2)

REPORTAZH

Rafting në Dri, një risi e turizmit në Dibër **plot surpriza dhe adrenalinë**

— Faqe 12-13





Prezantohet nisma "Rruga Lidhja e Prizrenit", një lidhje e re mes Dibrës e Kukësit

— Faqe 7

NË BRENDËSI:

■ "**Vera në Dibër**", veprimtari që synojnë të mbajnë gjallë dashurinë për vendin ■ **Gratë** shqiptare që mbledhin krom përballen me shfrytëzim ■ Në bahçen e **Kapllan Keshit**… ■ **Resorti "Beça"** në Podgorcë, një biznes që rritet pak nga pak në shërbim të turizmit ■ **Mendja** dhe dora e dibranit gjallonte në çdo lëndinë… ■ "Aty te portat Skée", ribotohet libri i parë poetik i **Agron Tufës** ■ Hani i udhëtarëve planetarë - një kritikë rreth librit të ri me tregime të **Eqrem Bashës** ■ Kontribut në zhvillimin e novelistikës sonë ■ "Mos ma prekni lumin tim" ■ Personaliteti i **Hafiz Xhemal Mullait** ■ KSENOMANIAKU - rrëfenjë nga **Abdurahim Ashiku** ■ Panoramë e historisë së **Rremullit** dhe të Matit ■ **Selim Çerpja** vjen me "Gonxhe në muzg" ■ **Qemal Kërkuti**, mësuesi i mijëra nxënësve

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 6 (178). Qershor 2021
Gazeta doli nga shtypi, 9 Korrik 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Qershor 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Agron TUFA
Ali ALIU
Ahmet PRENÇI
Fjori SINORUKA
Hyqmet GONXHJA
Agron GJEDIA
Sakip CAMI
Ramazan BUCI
Halil RAMA
Xhemal BALLA
Mevlud BUCI
Ilmi DERVISHI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

SHËNIM: Qeveria duhet të tregohet e përulur dhe e përgjegjshme ndaj kërkesave të banorëve

Braktisja e Dibrës nuk duhet të ndodhë

(Vijon nga faqja 1)

Siç është e përcaktuar edhe me ligj dhe siç u deklarua edhe nga palët gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshje, puna do të përqendrohet në terren, së paku formalisht, në studimet që duhet të trajtojnë probleme që kanë të bëjnë më lëvizjet sociale, ndryshimet mjedisore, shpronësimet, ndërtimi i infrastrukturës së re: banesa, shkolla, qendra shëndetësore e rrugë, ujësjellës dhe kanalizime, gjithçka që do t’i duhet komunitetit për t’u lidhur me njëri-tjetrin dhe për të ndërtuar.

Në këtë fazë të studimit do të duhet të ketë ekipe në terren që do të realizojnë matje të sakta, të informohen banorë për procedurat në vazhdim dhe të jetë e mundur të arrihet në rezultate, që në fund do të vendosin nëse duhet ecur përpara me ndërtimin e Skavicës apo procesi duhet të ndalet.

Mbulimi i shpenzimeve të fazës së parë do të mbulohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, ashtu siç është bërë deri më tani. Sa herë që ka dalë në skenë “Skavica”, KESH ka harxhuara para për studime fizibiliteti, herë me fonde nga jashtë dhe herë me fondet e veta.

Në fillim të vitit Komisioni Europian është tërhequr nga mbështetja për Skavicën. Pas negociatave të qeverisë shqiptare me kompaninë Bechtel në fund të vitit të kaluar, drejtori i WBIF (Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor) i dërgoi një letër drejtorit të Bankës Europiane të Investimeve, për dijeni edhe ambasadorit të BE në Shqipëri, ku njoftonin tërheqjen dhe kërkonin transparencë mbi marrëveshjen.

Deri më sot qeveria nuk ka lënë asnjë shteg të hapur se Skavica mund të mos ndërtohet. Ajo e ka bërë të qartë përmes ministres Balluku dhe zyrtarëve të tjerë se ky proces duhet të ecë përpara; madje është nënkuptuar se kush është kundër, është kundër “interesave të Shqipërisë”. Me fjalë të tjera, kush kundërshton dhe kush nuk është dakord, nuk është gjë tjetër veçse antishqiptar.

Ky është një qëndrim krejt dashakeq i përfaqësuesve të qeverisë. Kjo ka nxjerrë në pah arrogancën e qeverisjes, si dhe ka ngritur në nivelet më të larta përçmimin dhe fyerjen që u bëhet banorëve të luginës së Drinit. Sikur të mos mjaftonte kjo; ajo i mëshon argumentit se një nga avantazhet e ndërtimit të HEC është shpëtimi i fushës së nën Shkodrës; duke i trajtuar kështu në mënyrë të pabarabartë shtetasit e vet: ca duhen shpëtuar e ca duhen përmbytur e shpërngulur. Këta të fundit, madje, edhe si “antishqiptarë”.

Përpara tani janë 18 muaj që do të jenë të vështirë për banorët Dibrës, veçanërisht ata që kanë shtëpitë e pronat e tyre përgjatë luginës së Drinit. Dhe jo vetëm për ta. Janë muajt që duhet të tregojnë se sa janë të angazhuar për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre, për të mbrojtur shtëpitë dhe tokat e trashëguara brez pas brezi.

Deri më sot, përpjekjet për kundërshtimin e HEC Skavica kanë dështuar, pasi me përjashtim të pak zërave, zyrtarisht protestat i kanë udhëhequr individë që nuk kanë parë dot përtej “shtëpisë së tyre”. Nuk ka pasur një përpjekje për t’i bashkuar fuqitë dhe energjitë, argumentet dhe faktet që të vërtetojnë dëmin që HEC i Skavicës bën në Dibër. Këto dëme i di mirë gjithkush, madje i di mirë edhe qeveria. Situata ka rrjedhur e tillë sa çdo argument që sillet kundër ndërtimit të hidrocentralit, trajtohet me një indiferencë të plotë; sikur duan të thonë se “keni të drejtë, por ky është një projekt 50 vjeçar, kështu që nuk kemi se çfarë bëjmë”. Sepse, ç’ka është



Pamje nga protestat e banorëve, nëntor 2020.

e mirë për vendin, kërkon sakrificën tënde.

Por në qoftë se Skavica është një projekt 50 vjeçar, dëshirat për ta ndarë Dibrën në mes është një projekt shekullor i serbëve. Skavica e ndan Dibrën plotësisht dhe ky nuk është një trill në 3D, por një e vërtetë që kujt nuk do t’i dhembë sot, do t’i dhembë nesër.

Çuditërisht, qeveria nuk po flet tani as për variantet A dhe B, që marrin në konsiderate përmbytjet dhe shpërnguljet, por edhe zëra “të pavarur” specialistësh nuk kanë ngurruar të shprehin dëshirën për digën me nivel 485 metra, ajo që do ta dërgonte nivelin e liqenit deri në Maqedoninë e Veriut.

Tani është koha të kthehemi me këmbë në tokë. Është koha të bëhemi së bashku dhe të na udhëheqë arsyeja, bindja, dashuria dhe përkushtimi për vendin tonë.

Është koha të themi me plot gojën, pa droje, me të drejtën tonë dhe të Zotit, se me ndërtimin e Skavicës Dibra ndahet në dysh. Dibër nuk ka më, duam apo s’duam ne. Me ndarjen e një shekulli më parë, me ndarjet eksperimentale në emër të funksionimit të pushtetit lokal dhe me ndarjen fizike nga ujërat e liqenit; Dibra ka për të qenë vetëm një shprehje e historisë së Shqipërisë... Do të ketë Dibër të Madhe e Dibër të Vogël, Dibër në Lindje e Dibër në Perëndim; Dibër në Jug e Dibër në Veri; Dibër në Tiranë e Dibër në New York, por ajo njësia e vetme, unike, ajo Dibra në zemër të trojeve shqiptare nuk do të jetë më...

Është koha të kundërshtojmë me bindjen e plotë se ndërtimi i Skavicës nuk e shpëton fushën e nën Shkrodrës; por ajo përmbyt fushën e Dibrës. Skavica vërtet do të disiplinojë dhe do të rrisë kapacitetet e prodhimit, por ajo nuk do ta sigurojë dot se fusha e nën Shkodës nuk do të përmbytet më. Këtë e di edhe qeveria, e cila përmes ministres Balluku kishte thënë në kohën e miratimit të ligjit se “Skavica do të shpëtojë fushën e nën Shkodrës nga përmbytjet”, ndërsa tani flet për “minimizim të përmbytjet në zonën e nën Shkodrës”.

Skavica do të prishë ekosistemin; do të ndikojë në ndryshimin e klimës dhe rrjedhimisht do të ketë ndikim jo vetëm në shëndetin e banorëve apo në degët e tjera të bujqësisë dhe frutikulturës.

Skavica do të zhdukë fushën e Dibrës, do të nxisë lëvizjet apo shpërnguljet e popullsisë dhe do të krijojë probleme të pariparueshme sociale. Duhet të tregojmë se problemet e lëvizjes së popullsisë nuk do të prekin vetëm ata që u përmbyten shtëpitë, por edhe mijëra familje të tjera do të mbeten pa tokat e tyre - burime të vetme të jetesës në këto anë. Skavica nuk do na ndihmojë turizmin; përkundrazi. Qenia e saj kryesore si një rregullator për hidrocentralet e tjerë të kaskadës do të krijojë një brez të gjerë toke që do të përmbytet herë pas here dhe do ta prishë mjedisin.

Deri më tani qeveria ka pasur një vesh të shurdhër për të dëgjuar. Dëgjimi ka qenë gjëja më e lehtë, por nuk është e lehtë të dëgjosh ankesa apo kërkesat e atyre që do të shpërngulen nga trojet e tyre, ndaj është lënë për tani. Ka filluar periudha 18 mujore e studimit të kompanisë amerikane, kohë e cila duhet të jetë një përpjekje e përbashkët për të mbrojtur interesat e banorëve, për të rritur kërkesat e tyre dhe për të kërkuar një angazhim më të madh të qeverisë ndaj kërkesave të tyre.

Një peticion i banorëve drejtuar qeverisë, presidentit, ambasadës amerikane dhe kompanisë Bechtel është injoruar plotësisht. Fatkeqësisht, në këtë çështje nuk ka opozitë. Të gjithë janë bashkë, në dukje për të mbrojtur investimin e një kompanie amerikane. Tetë vite më parë, për interesat e tyre politike kompania amerikane nuk mori dot asnjë projekt infrastrukturor në Shqipëri, por tashmë është rikthyer dashuria e vjetër dhe në emër të investimeve amerikane po mbështetet një projekt që bie ndesh me interesat e banorëve të Dibrës.

Sot është koha të angazhohemi, të bëhemi bashkë dhe të kërkojmë më të mirën për interesat e banorëve të Dibrës. Nuk duhet të kemi asnjë droje për të qenë të hapur me të gjitha mundësitë për variantet e Skavicës, për t’u bërë më e mira për banorët dhe vendin.

Është koha që banorët të bëhen bashkë, jo vetëm për ta kundërshtuar, por edhe për të kërkuar më shumë investime në të gjitha fushat e ekonomisë, në mënyrë që edhe nëse vendoset të ndërtohet, banorët nuk duhet të shpërngulen. Ata duhet ta ringrejnë jetën e tyre rreth asaj toke dhe në ato troje. Braktisja e Dibrës nuk duhet të ndodhë.

Është koha të kërkojnë ngritjen e zërit të shoqërisë civile, mbështetjen nga organizatat mjedisore dhe ato që mbështesin liritë dhe të drejtat e njeriut. Nuk duhet të kemi fare droje ta krahasojmë rastin me Vjosën. Sepse nëse në Vjosë luftojmë të shpëtojmë natyrën e egër, për rastin e Skavicës po kërkojmë të mbrojmë njerëzit e gjallë. Duhet të flasim me median, e cila është e ndjeshme ndaj prishjes së ekosistemit nga makinat “of road”, por nuk shqetësohet për prishjen e jetës në mënyrë të drejtpërdrejtë për së paku 10 mijë banorë. Duhet të detyrojmë organet vendimmarrëse që përpara se të flasin për rritjen e prodhimit të energjisë dhe për përmbytjet e fushës së Shkodrës, pa folur më parë për jetën e banorëve të Dibrës. Është koha të maksimalizojmë kërkesat dhe interesat tona, me qëllim që shpërngulja të mos ndodhë, për asnjë çmim.

Balluku: "Faza e parë përfshin kryesisht të gjithë punën përgatitore për sa i përket të gjitha studimeve që do të bëhen, duke nisur nga studimi ambiental, ai gjeologjik, ai teknik, social që është shumë i rëndësishëm dhe deri në përfundimin e kësaj faze, duke kaluar pastaj në fazën e dytë".

Qeveria ecën përpara me projektin e Skavicës, firmos me 'Bechtel' fazën e parë të ndërtimit

Nënshkruhet kontrata: Kompania amerikane "Bechtel" ka 18 muaj kohë për studimin gjeologjik, mjedisor, teknik e social

Qeveria shqiptare ka nisur fazën e parë për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, "një projekt me rëndësi të veçantë në sektorin elektro-energjetik shqiptar", siç e konsideron ajo.

Në prani të ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku dhe Justin Siberell, President Rajonal për Europën, Afrikën dhe Lindjen e Mesme të "Bechtel Infrastructure" është nënshkruar kontrata për fazën e parë të këtij projekti mes Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe kompanisë amerikane Bechtel.

"Është një kënaqësi të ndodhemi këtu sot dhe të materializojmë një projekt kaq të rëndësishëm për qeverinë shqiptare, por sigurisht mbi të gjitha për sektorin elektro-energjetik shqiptar. Kemi nisur prej kohësh një punë intensive dhe jemi munduar që t'i ruajmë të gjitha limitet kohore dhe afatet që kemi patur para nesh, pavarësisht situatës së vështirë të pandemisë edhe distancës që kemi pasur me njëri-tjetrin", tha në fillim të fjalës së saj ministrja Balluku.

Gjatë fjalës së saj Balluku thuri elozhe ndaj kompanisë amerikane, por edhe për skuadrat e punës së KESH dhe Ministrisë.

"Duke qenë se pala tjetër për realizimin e kësaj kontrate është një nga kompanitë amerikane më të mëdha dhe më të suksesshme në fushën e infrastrukturës, pra, kompania "Bechtel", por megjithatë, puna e mirë është bërë nga të gjithë skuadrat, si skuadra e KESH ashtu dhe "Bekhtel", dhe sigurisht edhe skuadra që koordinon, ajo e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".

"Këto kanë bërë që të arrijmë sot në një moment shumë të rëndësishëm, do ta quaja historik për sa i përket kësaj kontrate. Pra, firmosjen e kontratës për fazën e parë të ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës".

Sipas Ballukut, 'faza e parë përfshin kryesisht të gjithë punën përgatitore për sa i përket të gjitha studimeve që do të bëhen, duke nisur nga studimi ambiental, ai gjeologjik, ai teknik, social që është shumë i rëndësishëm dhe deri në përfundimin e kësaj faze, duke kaluar pastaj në fazën e dytë".

Në fjalën e ministres Balluku nuk ka asnjë dyshim se puna për ndërtimin e Skavicës do të vazhdojë. Gjatë fjalës së saj lë të kuptohet se procedura e fazës së parë është vetëm një formalitet, që do të arrijë në rezultatet dhe përfundimet e dëshiruara prej qeverisë.

"Në këtë fazë kemi 18 muaj në dispozicion, të cilat do të shërbejnë për të gjitha ekipet për të bashkëpunuar, për të koordinuar dhe për të prodhuar materialet, të cilat sapo kam përmendur dhe më pas me të gjithë shpresën e mirë, që brenda këtyre 18 muajve do jetë koha e duhur pavarësisht se volumi i kësaj pune është gjigant, por ne do t'ia dalim që brenda 18 muajve që të dorëzojmë një produkt të mirë, i cili më pas do të na hapë rrugën për të kaluar në fazën e dytë dhe për të firmosur atë kontratë, e cila është kontrata e ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës".

Gjatë fjalës së saj, Ministrja Balluku iu drejtua edhe publikut, me dëshirën e mirë që ai të kuptojë se kundërshtimet ndaj këtij projekti janë të kota dhe se përfitimet që vijnë janë më të mëdha dhe më të rëndësishme.

"Do të desha të thoja disa elementë të rëndësishëm, më tepër për publikun, për të kuptuar edhe njëherë pse ky projekt është kaq i rëndësishëm. Shpeshherë më ndodh që më pyesin cila është arsyeja që Skavica është ndryshe nga hidrocentralet e tjerë? Apo çfarë presim nga Skavica? Skavica është ndryshe nga hidrocentralet e tjerë të kaskadës së Drinit, për arsyen sepse është hidrocentrali, i cili do të luajë rolin e një rregullatori për hidrocentralet ekzistuese. Pra, jo vetëm do të rrisë me 20 për qind prodhimin vendas të energjisë elektrikë të prodhuar nga hidrocentralet në Republikën e Shqipërisë, por nga ana tjetër do të optimizojë dhe do të rrisë kapacitetet prodhuese dhe të hidrocentraleve ekzistuese sot në Kaskadën e Drinit".



Foto nga nënshkrimi i kontratës së fazës së parë për ndërtimin e HEC Skavica. Foto: MEI

Ashtu si edhe në të kaluarën, kur flet për Skavicën, qeveria e ka mendjen te fusha e nën Shkodrës dhe nuk flet asnjë fjalë për fushën e Dibrës.

"Një element shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me ndërtimin e këtij hidrocentrali dhe me gjithë projektin, që ka qenë një projekt, siç ne e quajmë shpesh një ëndërr në sirtar të çdo qeverie, është minimizimi i përmbytjeve në fushën e nën Shkodrës. Pra, me ndërtimin e këtij hidrocentrali, me basenin që krijohet dhe të gjithë optimizimin e kësaj kaskade, ajo që ne do të ndjekim menjëherë do të jetë minimizimi i këtyre përmbytjeve dhe kontrolli i të gjithë derdhjeve i periudhës së shirave, pra, që përkon nga vjeshta deri në pranverë", tha ministrja Balluku.

Ministrja e Infrastrukturës u kujdes të thurte elozhe për Bechtel si dhe të përcjellë mesazhin se kjo kompani është zgjedhur në bashkëpunim me qeverinë amerikane, dhe si e tillë ajo do të dijë t'u japë zgjidhje problemeve sociale që do të dalin në zonë.

"Gjithashtu, çfarë është e rëndësishme të thuhet, - vazhdoi në fjalën e saj Balluku, - është se që në fillimet tona, kur jemi ulur me Bechtel, ne kemi qenë shumë të qartë dhe ata e kanë mirëkuptuar shqetësimin tonë, për sa i përket të gjithë impaktit social që ky projekt do të ketë në zonë. Bechtel është zgjedhur nga qeveria shqiptare edhe nga qeveria amerikane edhe për një arsye tjetër, për shkak të eksperiencës të pëlqyer që ka pasur në menaxhimin e projekteve të mëdha, infrastrukturore, por që padyshim krijoi një impakt social. Bechtel e ka këtë eksperiencë, është një nga kompanitë që di të menaxhojë më mirë se kushdo të gjithë raportin me grupet e interesit që ndodhen në zonat ku ndërtohen këto projekte, kështu që ne jemi besimplotë që gjithçka do të zgjidhet në të mirë të banorëve të zonës dhe padyshim në të mirë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, për sa i përket pra sistemit elektro-energjetik dhe, pa asnjë dyshim, edhe në të mirë të të gjithë rajonit" - përfundoi Balluku.

Justin Siberell, President Rajonal për Europën, Afrikën dhe Lindjen e Mesme të "Bechtel Infrastructure", gjatë fjalës së tij tha se "ne të Bechtel jemi shumë të kënaqur që bashkëpunojmë me qeverinë e Shqipërisë në këtë projekt historik dhe të rëndësishëm".

"HEC i Skavicës do të sjellë të mira domethënëse për Shqipërinë. Përfshirë këtu 210 MWh të shtuar të energjisë së pastër të ripërsëritshme dhe vetëmjaftueshmëri të prodhimit të energjisë për Shqipërinë dhe kontrollin e përmbytjeve sezonale", tha Siberell.

"Me marrëveshjen e sotme ne menjëherë do të fillojmë punët e hershme për të mbështetur këtë projekt. Kjo do të përfshijë projektin e detajuar, hetimin dhe studimin gjeoteknik, rrugët paraprake të ndërtimit dhe përfundimin e vlerësimit të ndikimit social dhe mjedisor në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare", theksoi Siberell.

Nënshkrimi i kontratës së fazës së parë për ndërtimin e HEC Skavica u bë nga Drejtori i KESH, Ergys Verdho për palën shqiptare dhe Andrew Patterson, Drejtues Global i Business Development dhe Manaxher i Projekteve të Mëdha për Bechtel Infrastructure.

Verdho, në një postim në Facebook e cilësoi hidrocentralin e Skavicës si "një ëndërr të mbetur pezull që nga koha e projektimit të kaskadës së lumit Drin në vitet '60".

"Në funksion të rritjes së kapaciteteve gjeneruese, të cilat do t'i shërbejnë interesave të KESH, firmosëm sot me kompaninë Bechtel kontratën për fazën e parë të projektit më ambicioz të Qeverisë Shqiptare, projekt i cili do ta shndërrojë në lider të padiskutueshëm në sektorin elektro-energjetik në rajon si edhe eksportues të energjisë elektrike. Ky Hidrocentral do jetë një rregullator si në gjenerim, ashtu dhe në konservim të rezervës hidrike", shkruan drejtori i KESH.

Nga Zyra e saj në Londër Bechtel publikoi lajmin e marrëveshjes në faqen e saj në Internet.

"Bechtel është i kënaqur që u zgjodh si partner në ndërtimin e digës së Skavicës. Ne e dimë që ky është një projekt i rëndësishëm kombëtar dhe shpresojmë të punojmë me KESH si partner dhe të angazhojmë kompani lokale, një zinxhir furnizimi dhe njerëz në vend për të arritur përfitimet e menjëhershme dhe afatgjata ekonomike që vijnë me ndërtimin e një vepre të kësaj madhësie", citohet Andrew Patterson, menaxher i projekteve të mëdha të Bechtel.

"SKAVICA", NJË HISTORIK I DËSHTIMEVE QË NGA VITI 2005

Projektet me ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës kanë qenë vazhdimisht në qendër të qeverisë shqiptare.

Në vitin 2005 qeveria shqiptare dështoi t'ia jepte hidrocentralin një kompanie italiane. Në fund të vitit 2008 gjashtë kompani morën pjesë në një tender për marrjen me koncension të saj, por tenderi dështoi dhe qeveria nuk njoftoi për shkaqet e dështimit. Pas kësaj, në vitin 2013 qeveria shqiptare shpalli ambicien për ta ndërtuar vetë hidrocentralin. Në vitin 2014, pas ardhjes në qeveri të Partisë Socialiste, pati tentativa për t'ia dhënë hidrocentralin disa kompanive kineze të njohura në këtë fushë, por edhe në këtë drejtim pati dështime. KESH në këto kohë bëri publike ambiciet e saj për të ndërtuar dy hidrocentrale mbi Drin, një Skavicë në kuota të ulëta dhe HEC e Katundit të Ri. Në fund të vitit 2015 qeveria shqiptare i dha një kompanie turke bonus për ndërtimin e HEC të Katundit të Ri, por ky zhvillim pati reagime të ashpra edhe në parlament në fillim të vitit 2016. Damian Gjiknuri, ish-ministër i Energjisë në atë kohë, mbrojti variantin me dy diga.

"Vlera që pretendohet për shpronësimet janë të tilla që projektin e bëjnë të pamundur. Njerëzit atje do të privohen nga çdo lloj mënyre jetese për të ardhmen, duke kërkuar një zhvendosje dhe kompensim. Vlera e tokës mund të shkojë shumë lart dhe projekti shkon në kuadrin e disa miliardë dollarëve, që për mua pastaj bëhet utopi", - thoshte në atë kohë Damian Gjiknuri, ministër i Energjisë dhe Industrisë, gjatë një takimi me donatorë.

Skavica u rikthye sërish, këtë herë pa zhurmë në Samitin e Triestes më 12 korrik 2017, ku Shqipëria përfitoi mbështetje për zhvillimin e hidrocentralit. Ky lajm u mbajt i fshehtë nga qeveria në atë kohë.

Por rezultatet e Samitit të Triestes filluan të dalin në fillim të vitit të kaluar, kur kryeministri Rama shprehu angazhimin për ta ndërtuar Skavicën me 100% financim shtetëror. Në atë kohë, drejtori i KESH Benet Beci, bëri publike planet për dy opsionet e Skavicës, me një dhe dy diga.

Por në tetor 2020, qeveria shqiptare nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë amerikane Bechtel për ndërtimin e Skavicës. Marrëveshja ngjalli reagime dhe protesta, me gjithë aktin normativ në fuqi që ndalonte tubimet. Dy nga drejtuesit e shoqatës që kundërshtojnë Skavicën mbajnë akoma një gjobë prej 5 milionë lekësh.

Pas marrëveshjes me Bechtel, Komisioni Evropian që kishte dhënë mbështetje për zhvillimin e projekteve, u tërhoq, duke i kërkuar qeverisë shqiptare të bënte transparente marrëveshjen me kompaninë amerikane.

Qeveria shqiptare në mars të këtij viti miratoi në parlament ligjin e posaçëm që i hap udhë ndërtimit të Skavicës nga Bechtel. Ligji u miratua në parlament me 93 vota, vetëm 3 kundër.

Pas nënshkrimit të kontratës së fazës së parë, Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi ka bërë thirrje për protesta.

B.Karoshi

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**



BUJTINA E JUFKAVE
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **agro_zerja@yahoo.com**



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**



KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**



BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

"Destinacion" udhëton në Peshkopi, tokën e Kastriotëve

Vendet turistike në zonën e Dibrës

Ndalesën e parë e bën në urën e Topojanit, në të majtë të saj na presin djemtë e 1001 aventurave, të cilët bëjnë gati gomonet për rafting.

"Lugina e Drinit është e përshtatshme, për të gjitha moshat që të bëjnë rafting. Ne e kemi zgjedhur këtë luginë për bukuritë mahnitëse dhe për adrenalinë që të jep. Sot nisëm sezonin dhe i ftojmë të gjithë turistët të vijnë të vizitojnë Dibrën,"-thotë Edmir Truka, themelues i Qendrës së Aventurave.

Në breg, takojmë peshkatarë nga Kosova të cilët kanë hedhur grepat. Prej vitesh ata vijnë pikërisht nga këto anë dhe ndjehen si në shtëpi.

"Unë vij prej Prizreni dhe kam 15 vjet që vij për të peshkuar në këtë zonë. Peshku që gjuajmë është trofta dhe krapi. Më pëlqen shumë zona e Dibrës dhe banorët e saj,"- shprehet Qenan Shishko, peshkatari nga Prizreni.

Një nga xhamitë më të bukura mesjetare të Dibrës e gjejmë në fshatin Burim të Dibrës. Objekti është shpallur monument kulture që në vitin 1970 dhe imami i xhamisë së Allajbegisë rrëfen më shumë detaje rreth saj.

"Ndërtuesi i kësaj xhamie është një komandant i kohës, i cili u vendos në këto toka fushore dhe ka ndërtuar këtë xhami. Kjo xhami është më e vjetra në Dibër dhe ndër më të vjetrat në Shqipëri,"- tregon z. Xhili për Destinacion në Euronews Albania.

Në Dibër vizitojmë kalanë e Grezhdanit e shpallur monument kulture në vitin 1963. Kalaja ka ende të ruajtura fragmente muresh ilire dhe mendohet se është ndërtuar në shekullin e III-IV pas krishtit.

Vazhdojmë udhëtimin tonë në qytetin e Peshkopisë, i cili quhet ndryshe qyteti i blirëve.



Aty takojmë studiuesin Haki Përnezha, i cili na flet për toponimin e emrit Dibër dhe jetesën e dibranëve.

"Në këtë zonë gjenden shkrime në gurë dhe automatikisht këto shkrime në gurë çojnë historinë e kësaj treve nga 2 mijë deri 10 mijë vjet para Krishtit. Shumë studiues e lidhin prejardhjen e emrit Dibër me një fis që quheshin doberë. Po këta studiues na thonë që fjala 'Dibër' vjen deri në ditët e sotme nga prezenca e këtij fisi,"-thotë Haki Përnezha, studiues.

Në Peshkopi takojmë edhe një mjeshtër të veglave muzikore membranofon. Rahimi na tregon me pasion për punën e tij.

"Kam qenë 10 vjeç dhe kam pasur shumë pasion t'i bija veglave muzikore. Unë e kam mësuar daullen nga një shok që vinte në fshat, i cili ishte muzikant. Kam 40 vjet që e bëj këtë punë, pra i bie lodrës dhe e prodhoj prej 40 vitesh. Unë jam i vetmi që prodhoj lodra në Shqipëri,"- tregon Rahmi Çaushi, artizan veglash membranofon.

Vizitën e fundit e bëjmë në muzeun e qytetit ku ndodhen rreth 2000 objekte me mjaft vlera, disa prej të cilave janë shumë të rralla duke filluar nga ato arkeologjike, si vegla pune stralli, enë të ndryshme prej balte, armë zjarri, shpata, objekte personale të figurave historike dhe një pasuri të madhe etnografike, që nga objekte blegtorale, bujqësore, të kuzhinës dhe deri te veshjet e llojeve të ndryshme të krahinave të Dibrës.

"Vera në Dibër", veprimtari që synojnë të mbajnë gjallë dashurinë për vendin

Pas një viti të mbyllur tërësisht për dibranët jashtë Dibrës së Madhe, ky vit pritet të ketë një rikthim të tyre në vendlindje, pas lehtësimit të masave anti-covid.

Me këtë rast, Shoqata Atdhetare "Dibra" në New York, në bashkëpunim me Komunën Dibër e Madhe dhe Klubin Bjeshktar & Çiklist "Dibra", kanë hartuar një kalendar veprimtarishë të përbashkëta gjatë sezonit veror 2021.

Turi i veprimtarive nisi më 4 korrik, në një turne pink-pongu, ku morën pjesë shumë admirues të këtij sporti, mes të cilëve edhe veteranët Xheladin Pjeça dhe Ylber Daci.

Vendin e parë në këtë veprimtari e zuri Mentor Mela, ndërsa të dytin dhe të tretin, përkatësisht Shpend Erbeli dhe Arbër Ambari.

Veprimtaria tjetër e radhës është më 18 korrik, e cila quhet "DibraTriathlon", ku do të ketë gara në tre disiplina: not, vrap dhe çiklizëm. Më datat 24 e 31 korrik dhe 7 e 14 gusht do të ketë veprimtari me fokus "Të mësojmë të jetojmë së bashku", ku do të ndërthuren punime të përbashkëta të fëmijëve që vijnë nga SHBA, Europa, Shkupi, Prishtina e Tirana.

Në fund të këtij muaji, më 30 dhe 31 korrik do të organizohet një kampionat basketbolli "Street Ball", ndërsa më 1 gusht do të festohet 100-vjetori i Klubit Sportiv "Korabi".

Nga data 3 deri 7 gusht, për disa ditë me radhë do të organizohet një turne minifutbolli. Më 6 gusht do të mbahet në sheshin "Skënderbej" maratona me këngë popullore "Këngë moj". Në nga veprimtaritë e përvitshme do të jetë ecja në mal, me moton "E duam Dibrën", ku këtë vit destinacioni final është mali i Korabit.



Fituesit e turneut të parë të Ping-Pongut

Veprimtaritë e organizuara do të mbyllen me 20 gush me një turne tjetër tenisi.

Organizatorët, përmes këtyre veprimtarive, kanë qëllim që të gjithë dibranët të shohin mundësinë që këtë sezon veror të kalojnë në Dibër dhe përmes veprimtarive të përbashkëta të njihen më shumë me njëritjetrin, të shkëmbejnë përvojën, miqësinë dhe përmes këtyre veprimtarive të synojnë një rigjallërim të jetës sociale dhe ekonomike në qytetin e Dibrës së Madhe.

Për më shumë informacione mund të ndiqni në Facebook njoftimet e herëpashershme që nxjerr Shoqata Atdhetare "Dibra" me qendër në New Tork. (facebook.com/shoqataatdhetaredibra)

ide

"Rruga e Arbërit tashmë është realitet me dalje në Luginën e Drinit të Zi. Gjithashtu, Rruga e Kombit është një realitet tjetër në veri të Luginës së Drinit të Zi, ku bashkohen dy Drinat. Aeroporti Zayed - Flatra e Veriut, Kukës tashmë një tjetër realitet, që kërkon domosdo korridorin përgjatë luginës së Drinit të Zi - Ohër Por, sipas tij, edhe Hidrocentrali i Skavicës do të jetë shpejt një në Luginën e Drinit të Zi.

Prezantohet nisma "Rruga Lidhja e Prizrenit", një lidhje e re mes Dibrës e Kukësit

Rruga e Rinisë" shpejt do të tretet në fundin e ujërave të ujëmbledhësit të HC-Skavica, ndaj ne po kërkojmë ta ringjallim atë, si një rrugë të standardeve bashkëkohore, përmes projekt-idesë "Rruga Lidhja e Prizrenit.



Më 16 qershor 2021, në mjediset e Pallatit të Kulturës u mbajt një tubim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit lokal, qytetarëve dhe anëtarë të shoqërisë civile, me qëllim prezantimin e nismës "Rruga Lidhja e Prizrenit".

Kjo nismë, e ideuar nga Hysen Uka dhe e mbështetur nga anëtarët e shoqatës, ka nisur shumë vite më parë, por shkëndijën e parë e ka dhënë në maj 2019, në Muzeun Historik Kombëtar, dy vite më parë, kur shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë organizoi konferencën shkencore me temë "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës".

Idenë z. Uka e prezantoi gjatë përshëndetjes që mbajti në atë takim, ndërsa më 16 qershor e prezantoi më të detajuar.

E zgjodhëm 16 qershorin të rivëmë në lëvizje nismën, edhe në nderim të 75 vjetorit të fillimit të aksionit Kombëtar të Rinisë, për ndërtimin e Rrugës Kukës-Peshkopi, si shtegu i parë për të futur dritë zhvillimi në "Luginën e Errët" të Drinit të Zi, - tha në fillim të prezantimit Hysen Uka.

Rruga e Rinisë" shpejt do të tretet në fundin e ujërave të ujëmbledhësit të HC-Skavica, ndaj ne po kërkojmë ta ringjallim atë, si një rrugë të standardeve bashkëkohore, përmes projekt-idesë "Rruga Lidhja e Prizrenit.

Duke pasur parasysh realitetet e reja në vend, tha ai, fakti që Rruga e Arbërit po merr formë dhe po vihet në funksion aeroporti i Kukësit, është e nevojshme një lidhje e re infrastrukturore mes Dibrës dhe Kukësit, mes fushëgropës së Korçës dhe fushëgropës së Prizrenit.

Duke folur për ndërtimin e Rrugës së Rinisë, Uka tha se ajo është ndërtuar me teknik ndërtimi të prapambetur dhe me mjete thuajse primitive. Për hartimin dhe zbatimin e projektit inxhiniero-teknik të saj, ka pasur dyshime se është sabotuar, duke kaluar në terrene të pastudiuara e të vështira.

Gjithashtu, ai theksoi se edhe lidhja aktuale Peshkopi-Kukës është përshtatje e rrugëve të kooperativave dhe më pas të rrugëve për qëllime ushtarake - të fortifikimit të vijës kufitare.

Duke cituar studiuesin italian Eugenio Vaina La Pava, i cili në librin e tij "Shqipëria që lind", shkruan se "Lugina e thellë e Drinit të Zi nga bashkimi me Drinin e Bardhë deri në liqenin e Ohrit përbën një rajon më të errët e më pak të njohur të të gjithë Shqipërisë: e mbyllur mes dy vargmalesh të rëndësishëm, e banuar nga dibranët krenar me famë...rrallëherë ka qenë përshkuar nga udhëtarët evropianë".

Gjatë prezantimit të idesë, Hysen Uka tha se tashmë janë krijuar realitete të reja ekonomike në rajon.

"Rruga e Arbërit tashmë është realitet me dalje në Luginën e Drinit të Zi. Gjithashtu, Rruga e Kombit është një realitet tjetër në veri të Luginës së Drinit të Zi, ku bashkohen dy Drinat. Aeroporti Zayed - Flatra e Veriut, Kukës tashmë një tjetër realitet, që kërkon domosdo korridorin përgjatë luginës së Drinit të Zi - Ohër Por, sipas tij, edhe Hidrocentrali i Skavicës do të jetë shpejt një në Luginën e Drinit të Zi.

Duke u ndalur te hidrocentrali i Skavicës, ai theksoi se duhet të kërkojmë më shumë përgjegjësi për investitorin dhe qeverinë shqiptare.

"Ka edhe një realitet tjetër me ndërtimin e HC- Skavicës - Rruga e Rinisë, ende në inventarin e rrugëve nacionale, përmbytet, ndaj duhet të kërkojmë si komunitet kompensimin alternativ te saj", theksoi Uka.

"Qeverisë dhe investitorit u bie përgjegjësia dhe detyrimi të shmangin këtë pasojë, duke ndërtuar segmentin rrugor alternativ, Dovolan - Kastriot - Qafë Draj - Skavicë - Domaj - Gabricë - Aeroporti Zayed, Flatra e Veriut".

"Realitetet e reja të krijuara në hyrje – dalje e Luginës së Drinit të Zi, (Dibër e Madhe- Kukës), kërkojnë rivlerësim e planifikim strategjik, ide e projekte komplekse që t'u përgjigjen këtyre realiteteve, veprime të reja për një Strategji të re Zhvillimore të luginës së Drinit të Zi", vuri në duke Hysen Uka.

"Nuk mund dy gjerdan të artë, si Rruga e Kombit dhe Rruga e Arbërit, të komunikojnë midis tyre me një "gjalm rrugor", të kategorisë së kohës të Luftës së Parë Botërore", theksoi ai.

"Në këtë kontekst realitetesh lindi nisma, për ndërtimin e rrugës Lidhja e Prizrenit, nisma sensibilizuese, për ndërtimin e segmentit bashkues të Rrugës së Arbërit - aeroportit Flatra e Veriut - Rrugës së Kombit, përgjatë Luginës rrugës "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", rrugë e kategorisë C2, e të njëjtës kategori me Rrugën e Arbërit".

"Ndërtimi i Rrugës Lidhja e Prizrenit do të bënte që Rruga e Arbërit të mos mbetej fundore me daljen në Bllatë (Maqellarë), por të futej në rrjetin rrugor kombëtar e ndërkombëtar.

"Do të hapë lëvizje e qarkullim të dyanshëm (hyrje-dalje) luginën e mbyllur të Drinit të Zi, Tiranë - Dibër - Kukës, si dhe Ohër - Strugë - Dibër - Kukës Prizren dhe anasjelltas Prizren Kukës - Dibër - Tiranë apo Dibër- Strugë – Ohër".

Në fund të paraqitjes së tij, ai theksoi se "duhet të organizohemi me një qëndrim, duhet të kërkojmë nga qeveria e investitori të vlerësojë me ekspertizë nismën e komunitetit mbarëdibran, dhe në kuadër të investimit madhor HC Skavica, në paketë me veprën, të futet edhe ndërtimi i rrugës Lidhja e Prizrenit dhe projekte tjera urbanizuese".

"Ndërtimi i Rrugës Lidhja e Prizrenit do të bënte që Rruga e Arbërit të mos mbetej fundore me daljen në Bllatë (Maqellarë), por të futej në rrjetin rrugor kombëtar e ndërkombëtar. Do të hapë lëvizje e qarkullim të dyanshëm (hyrje-dalje) luginën e mbyllur të Drinit të Zi, Tiranë - Dibër - Kukës, si dhe Ohër - Strugë - Dibër - Kukës Prizren dhe anasjelltas Prizren Kukës - Dibër - Tiranë apo Dibër- Strugë – Ohër".

Përfaqësuesja e prefekturës, znj. Donika Hysenaj dhe kryetari i bashkisë së Dibrës në detyrë, z. Shkëlqim Murrja e mbështetën idenë dhe u treguan të gatshëm që ta përçojnë dhe ta zhvillojnë më tej në konsultim me institucionet qeveritare.

Ndërsa përfaqësues të Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi u shprehën kundër nismës. "Ne jemi kundër çdo nisme që mbështet ndërtimin e Skavicës", thanë ata në takim.

Një qëndrim të tillë kanë mbajtur edhe anëtarë të shoqatës në rrjetet sociale.

"Ka një keqkuptim të madh, herë pa dashje dhe herë e qëllimshme, tha për gazetën Hysen Uka. Unë e kam shprehur qëndrimin tim "pro" ndërtimit të Skavicës, siç kam shprehur qëndrimin se nuk mund të ketë asnjë vendim pa miratimin e banorëve. Pra, ndërtohet ose jo Skavica, propozimi im nuk ka lidhje.

Ajo që dua të theksoj është se lidhja e Rrugës së Arbërit me Aeroportin Zayd- Flatra e Veriut dhe Rrugën e Kombit, përmes Rrugës Lidhja e Prizrenit, tashmë është një domosdoshmëri. E pse të mos jetë aeroporti Flatrat e Veriut edhe i Dibrës?! Pse të mos kyçet Rruga e Arbrit me Rrugën e Kosovës? Kukësi tashmë është një nyje e rëndësishme e infrastrukturës, me rrugën e Kombit dhe aeroportin, dhe rruga Lidhja e Prizrenit kyçet në këtë nyje. Banorët e Luginës së Drinit fitojnë një hapje dhe lëvizshmëri optimale drejt veriut dhe Kosovës".

"Fakti që qeveria shqiptare është e angazhuar për ndërtimin e Skavicës, është një realitet i ri, me të cilin duhet të përballemi. Është një mundësi për të zgjedhur mes Dibrës dhe largimit prej saj. Është një mundësi që jo vetëm të kërkojmë ndërtimin e Rrugës Lidhja e Prizrenit", por të kërkojmë edhe projekte të tjera me qëllim mosbraktisjen e Dibrës. Është koha për të vrarë mendjen për ide e projekte, jo për të sulmuar idetë e njëri-tjetrit" - thotë Hysen Uka.

Ai thotë se ka qenë në Zalldardhë, në Reç, në Draj Reç dhe atje ka takuar njerëz që janë gati të venë kushte në çdo lloj marrëveshje për Skavicën, me qëllim ndërtimin e Rrugës Lidhja e Prizrenit. Njerëzit duan të ndërtojnë jetën këtu, jo të marrin 5 lekë nga shpronësimet dhe të largohen.

Hysen Uka ka qenë ideatori i parë i Rrugës së Arbërit dhe përvoja në këtë lobim i ka treguar se çfarë njerëzit duan, është e arritshme.

"Unë them të mbledhim mendje, siç e mblodhëm për Rrugën e Arbërit, të kapim momentin e të mos humbim edhe 25 vite të tjera, por kam frikë se sa ta bëjmë mend ne, dibranët, do të mbyllet kuvendi, e mendja pas kuvendit nuk vlen".

Korresp. Rr.A.

Në qytetin e Bulqizës, gratë rraskapiten duke mbledhur krom, për t'u paguar vetëm disa euro në ditë.

Gratë shqiptare që mbledhin krom **përballen me shfrytëzim**

Nga **FJORI SINORUKA** | BIRN
EmailPinterestFacebookTwitterMore



Galeritë e minierës në qytetin e Bulqizës. Foto: BIRN.

Vjollca Gjelleshi mbylli një kapitull të vështirë gjashtë vjet më parë kur vendosi ta ndërronte çekiçin e saj për një biznes të vogël në të cilin ajo shet këpucë të përdorura.

Gjelleshi kishte kaluar 14 vjet duke punuar në minierat e qytetit të saj të lindjes, Bulqizë, në verilindje të Shqipërisë, gjysmën e kësaj kohe duke ndarë kromin nga guri dhe duke e ngarkuar atë në kova.

"Është punë për burra", tha Gjelleshi, por në Bulqizë kjo është një punë që zakonisht u bie për pjesë grave, shpesh pa ndonjë kontratë zyrtare pune. "Gratë këtu janë për të ardhur keq", tha ajo.

Për shumë gra të Bulqizës, mbledhja e kromit është e vetmja punë e disponueshme. Qyteti ka një histori të gjatë përsa i takon minierave, por ka fituar më shumë vëmendje vitet e fundit për kushtet e vështira me të cilat përballen minatorët dhe kërkesat e tyre për ndryshim.

Muajin e kaluar, në internet qarkulloi një video ku duken gra shqiptare që punojnë në minierat e kromit në kushte të vështira, duke rritur shqetësimet në lidhje me shfrytëzimin në punë.

Ato shesin kromin deri në tre lekë për kilogram, afërsisht 0,02 euro. Ndonjëherë vetë kompanitë minerare ofrojnë një punë të tillë, duke paguar midis tetë dhe 12 euro në ditë, por rrallë këtyre grave u ofrohet një kontratë zyrtare që mbulon sigurimet shoqërore.

Gjelleshi filloi të punonte në minierë, para se të lëvizte jashtë për të mbledhur krom.

"Kur miniera u mbyll, u detyrova të punoja në stoqe guri jashtë saj", tha ajo. "Vajza



Vjollca Gjelleshi në Bulqizë. Foto: BIRN

ime u rrit kështu që i duheshin para për shkollën. Ishte shumë e vështirë të punoje në gurore."

"I mbaj mend ato vite. O Zot i madh! Edhe sot më dhemb shpina."

ASNJË MUNDËSI TJETËR

Miniera e kromit në Bulqizë nisi punën në vitin 1948 nën regjimin e atëhershëm komunist të Shqipërisë. Shteti filloi një proces privatizimi pas vitit 2000 dhe një sërë kompanish tani kanë në pronësi pjesë të ndryshme të kompleksit, më e madhja midis tyre Albchrome, pjesë e Balfin Group, një nga kompanitë më të mëdha në vend.

Miniera është burimi kryesor i të ardhurave për familje të shumta në zonën e varfëruar.

Fatmire Ndreu, një nënë 40-vjeçare me tre fëmijëve, u pushua së fundmi nga një kompani lokale minierash e quajtur Valteri Grand shpk pas një mosmarrëveshje mbi pagën. Ajo punoi për katër vjet në minierë.

"Në fillim punonim pa figuracione", tha ajo. "Pastaj, pasi një minator vdiq, ata na siguruan për disa muaj dhe pastaj i hoqën përsëri figuracionet. Pas kësa nuk na paguan më figuracione, na ulën pagën nga 1,500 lekë në 1,000 lekë në ditë – tetë orë punë."

Kompania nuk iu përgjigj një kërkese për koment.

Puna ishte e vështirë, tha Ndreu, por ajo nuk kishte asnjë mundësi tjetër.

"Puna ka shumë lodhje. Nuk është e vështirë, por jashtëzakonisht e vështirë", tha Ndreu për BIRN. "Kjo është punë për burrat, por halli na detyroi të shkonim të punonim atje, për të nxjerrë bukën e fëmijëve."

Në vitin 2019, OJQ-ja me qendër në Tiranë Aleanca Gjinore për Zhvillim, QAGJZH, zbuloi se diskriminimi me bazë gjinore në punë është i përhapur, por i nën-raportuar në Shqipëri.

"Të dhënat sugjerojnë se shumica e personave që kanë qenë subjekt i diskriminimit me bazë gjinore nuk e kanë raportuar atë në institucionet përgjegjëse", tha QAGJZH në një raport.

"Pavarësisht nga mungesa e të dhënave zyrtare, të dhënat e sondazhit dhe intervistat sugjerojnë se diskriminimi me bazë gjinore në Shqipëri ndikon ndjeshëm në punësimin e grave".

"Gratë më shumë se burrat duket se përballen me shkelje të të drejtave të punës për sa i përket kontratave, kompensimit për punën e tyre jashtë orarit, të drejtave të punës dhe të drejtën për leje me pagesë", tha raporti.

LIGJI SHPËRFILLET

Ines Leskaj, kreu i Rrjetit të Fuqizimit të Grave në Shqipëri me qendër në Tiranë, një organizatë e cila përqendrohet në të drejtat e grave, tha se gratë e Bulqizës përballen jo vetëm me diskriminim, por edhe me shfrytëzim.

"Së pari, mungesa e kontratave", tha ajo për BIRN. "Së dyti, kushtet e punës, sepse nuk ka kushte fare, madje ka mungesë sigurie në punë. Dhe së treti, pagesa jashtëzakonisht e ulët, e cila është përsëri shfrytëzim."

Arta Mandro, një profesoreshë e së drejtës familjare në Universitetin e Tiranës dhe një eksperte për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, tha se problemi nuk ishte ligji, por dështimi i autoriteteve për t'u siguruar që ligji po respektohet.

"Ka institucione dhe duhet parë se si adresohet ky problem nga ana e tyre", tha Mandro për BIRN. "Këto janë aktivitete që tejkalojnë trajtimin njerëzor në disa mënyra dhe shkelin ligjin, nëse kryhen pa kontrata

"Gratë më shumë se burrat duket se përballen me shkelje të të drejtave të punës për sa i përket kontratave, kompensimit për punën e tyre jashtë orarit, të drejtave të punës dhe të drejtën për leje me pagesë", tha raporti.



Qyteti i Bulqizës dhe minierat e tij në sfond. Foto: BIRN.

ose sigurime. Kush e shfrytëzon këtë punë, duhet të hetohet dhe të ndërmerren veprime."

Eneida Mjeshtri, një përfaqësuese e Qendrës për të Drejtat në Punë, një organizatë me qendër në Tiranë, tha se gratë në Bulqizë nuk fitojnë as pagën minimale të ligjshme.

"Është e nevojshme të vëzhgohet mënyra e kryerjes së pagesës sepse ka shumë të ngjarë që këta punonjës paguhen me para në dorë dhe jo përmes një banke, e cila heq provën e vetme të ekzistencës së marrëdhënies së punës midis tyre dhe punëdhënësit, në kushtet kur midis palëve nuk është lidhur asnjë kontratë", tha Mjeshtri.

Sa i përket kushteve të punës, Mjeshtri tha se puna kryhej pa mjete dhe veshje të përshtatshme, apo vlerësim të rrezikut.

Ndreu tha se asaj iu kërkua të kryente punë të rënda deri në muajin e shtatë të shtatzënisë dhe u desh të kthehej në punë kur fëmija mbushi tre muaj.

"Isha e detyruar të kthehesha në punë sepse më duhen para që të ushqej fëmijët", tha ajo. "E lashë punën kur pronari na uli pagën."

Marrë nga reporter.al

kujtime

Mësuesi atdhetar dhe demokrat Sami Gonxhja sipas kujtimeve të të birit, prof. as. D. HYQMET GONXHJA

Kush ishte Sami Gonxhja, autori i muzikës **"Marshi i Djelmënisë dibrane"**

Sami Gonxhe lindi në vitin 1893 në qytetin e Dibrës së Madhe. Babai tij, Hafëz Raif Gonxhja, ka qenë një hoxhë erudit, ndërsa nëna e tij, Habibja, ishte bijë e latifondistit Ismail Kurt Aga Dovolani (Dagleri).

Sami Gonxhja kreu në vitin 1910 shkollën e mesme të përgjithshme në qytetin e Manastirit. Ashtu si edhe babai i tij zotëronte plotësisht gjuhën turke, arabe dhe persiane.

Veprimtaria arsimore: Fil pas shkollës së mesme e deri sa doli në pension, në vitin 1951, për mbi 40 vjet u aktivizua krejtësisht në fushën e mësuesisë. Ai ishte në grupin e parë të mësuesve dibranë që ka kontribuar në hapjen e shkollave të ciklit të ulët: në Zerqan, në Homesh, në qytetin e Peshkopisë dhe në Prezë. S. Gonxhja është mësuesi i parë në shkollën fillore të Ibës (Tiranë) në Arbanë (Tiranë) dhe Mollagjesh (Elbasan).

Në periudhën 1940-1942 ai dha kontributin e tij si mësues në shkollat e para fillore përkatësisht në fshatin Muhur dhe Sohodoll të Peshkopisë.

Në periudhën 1942-1945 ai shkriu të gjitha energjitë e veta si mësues shembullor në shkollat fillore të porsakrijuara në qytetin e Dibrës së Madhe prej të cilës ishte larguar familjarisht si muhaxhir pas pushtimit Sllavo-Serb të vitit 1913. Sami Gonxhja ka dhënë ndihmesën e tij si mësues edhe në shkollat fillore të kryeqytetit: J. Vreto, Kristoforidhi, shkolla e Kuqe, Kongresi i Lushnjës, Shkolla tek Rr. e pishës (Tani Tefta Tashko) dhe në Yzberish.

Veprimtaria politiko-shoqërore: Mësuesi S. Gonxhja ka qenë i ndjeshëm edhe për sa i përket rrymave social-politike të kohës. I frymëzuar nga qëllimet iluministe të Lëvizjes "Bashkimi" të udhëhequr nga Avni Rustemi, ai bëhet një veprimtar i shquar duke arritur të kryejë edhe detyrën e kryetarit të Degës Bashkimi për qarkun e Dibrës deri kur u përmbys qeveria e Nolit në Dhjetor 1924.

I akuzuar fillimisht, për tentativë kundra jetës së presidentit A. Zogu (1926) dënimi kapital i propozuar nga prokurori për mungesë faktesh, u kthye në burgim 6 mujor dhe me heqjen e të drejtës për të dhënë mësim në shkollat laike për 3 vjet. Gjatë kësaj periudhe (deri në vitin 1928) ai dha mësim në shkollën e Medresesë së Lartë në Tiranë.

Sami Gonxhja gjatë periudhës 1929-1939 arriti të reflektojë dhe të vlerësojë si mjaft pozitive regjimin e qeverisë Mbretërore për ndërtimin e shtetit të ri shqiptar, zhvillimin e arsimit dhe edukimin kombëtar.

Në kohën e pushtimit fashist ai mbajti qëndrim. Duke qenë nëpunës vetëm për një vit (1939-1940), në Institutin Femëror Pedagogjik, shfaqi haptas pikëpamjet e veta kundër pushtimit italian. Dhe ndëshkimi nuk vonoi: në shkurt të vitit 1940 S. Gonxhja transferohet familjarisht si mësues në fshatin Muhurr të Peshkopisë ndërsa në vitin 1941-1942 punoi si mësues në Sohodoll. Në periudhën qershor 1942 – gusht 1945, ai transferohet në qytetin e Dibrës së Madhe gjithnjë me detyrën e mësuesit për të dhënë kontributin në shkollat e para që u hapën në këtë qytet.

Duke pranuar propozimin e nipit të vet, dëshmorit Shaban Jegeni (i pushkatuar në Prishtinë) S. Gonxhja vuri në dispozicion shtëpinë e tij në Tiranë ku u themelua celula e parë e Grave Antifashiste të Shqipërisë (fundi i vitit 1941).

Në periudhën kur ishte mësues në qytetin e Dibrës së Madhe shtëpia e tij shërbeu si bazë e sigurt ku depozitoheshin dhe përcilleshin veshmbathje e municione në drejtim të çetave partizane të Dibrës edhe pse ishte i paralajmëruar që të hiqte dorë nga bindjet e tij antifashiste. Për këto qëndrime zgjidhet kryetar i frontit antifashist të qytetit të Dibrës së Madhe, detyrë që e kreu deri në mes të vitit 1945, kur dha dorëheqjen për t'u kthyer familjarisht në Tiranë.

Dorëheqja e Sami Gonxhes u paraqit kinse për arsye moshe dhe për t'u rikthyer në Tiranë ku kishte edhe shtëpinë e tij. Në të vërtetë, kjo dorëheqje ishte pasojë e pakënaqësisë dhe zhgënjimit të thellë që pati për masat shtypëse e ndërmarra nga pushteti maqedonas kundër shqiptarëve që banonin në trojet e veta në këtë republikë.

Këto masa represive të sllavo-maqedonasve, S. Gonxhja i pa me sytë e tij dhe i dëgjoi me dhimbje të madhe ankesat e të lebetiturat e burrave dhe grave shqiptare të Kërçovës, Gostivarit, Tetovës etj., kur po vazhdonte rrugën për të marrë pjesë në Kongresin e 2 Antifashist të Maqedonisë në Shkup (nëntor 1944) si anëtar dhe flamurmbajtës i delegacionit dibran që e kryesonte kryetari i



qarkut të Dibrës së Madhe – patrioti dhe "gjenerali me tirqe" Aqif Lleshi. Më kujtohet kur në shtator 1944 në shtëpinë tonë na erdhi për vizitë "Mësuesi i Populllit" (atëherë n/kolonel partizan) Qamil Guranjaku, koleg i babait dhe ish mësuesi im i edukatës fizike, para vitit 1939, në "Shkollën e Kuqe" të Tiranës.

Të them të drejtën, unë si veprimtar i rinisë antifashiste, e ndjeva veten disi ngushtë, kur im atë me kurajo qytetare, nisi t'i tregojë ish mësuesit tim (që ishte dërguar enkas nga Tirana për t'u informuar mbi situatën në Dibër dhe në trojet etnike shqiptare të Maqedonisë) për ato çka kishte parë e dëgjuar si më sipër. Gjatë gjithë këtij rrëfimi Q. Guranjaku mbajti shënime dhe i premtoi tim eti se për këto do të njoftonte Qendrën në Tiranë. E shënova këtë kujtim se të vije në dyshim dhe të flisje kaq hapur kundra miqësisë "vëllazërore" të popullit shqiptar dh atij jugosllav sidomos në vitin 1944 deri në vitin 1948 të burgosnin si "armik e shovinist antijugosllav".

Zhgënjimi i tij i dytë ishte kur pjesëtarë të familjes së tij u persekutuan egërsisht nga regjimi diktatorial i P.P.SH. Kështu, motra e tij, Ismete Llanai (Gonxhja) u burgos dhe u torturua tmerrësisht në qelitë e Degës së Brendshme të Burrelit derisa u çmend sepse nuk dha informacionin për vendndodhjen e bashkëshortit të saj të arratisur, oficerit akademist Xhemal Llanaj, i cili në vitin 1946 u vra nga forcat e Sigurimit të Shtetit. Po ashtu edhe vëllai i tij, Tahsim Gonxhja ish antifashist i orëve të para dhe i internuar për 2 vjet në ishullin Ustika (Siçeli) u burgos dy herë gjoja për agjitacion kundër pushtetit popullor i cili megjithëse kishte mbaruar shkollën tregtare të Vlorës dhe dinte dy gjuhë të huaja (italisht dhe Anglisht) u detyrua të punonte vetëm me punë krahu deri sa doli në pension.

Sqarojmë se S. Gonxhja ka kompozuar 10 këngë patriotike dhe rreshtore (pa nota) kryesisht për nxënësit e shkollave nga të cilat mbijetoj vetëm kënga: Marshi i djelmënisë dibrane me tekst të mësuesit të popullit Haki Sharofi dhe orkestrim të muzikantit tenderuar dibran profesor Isa Shehu. Ky marsh që i dedikohej fitores të luftëtarëve dibranë kundër pushtuesve serbë në Lan të Lurës së Dibrës u ndalua të këndohej në kohën e monizmit si këngë "shoviniste", ndërsa tash këndohet lirisht në të gjitha veprimtaritë festive.

Lidhur në "Marshim e Djelmënisë Dibranë" më duhet të kujtoj një takim interesant të rastësishëm që kemi patur me një personalitet të shquar ushtarak të Luftës Partizane.


Ndërsa në një ditë qershor të vitit 1947, unë dhe babai im sapo kishim kaluar Shkollën e Kuqe në rrugën Qemal Stafa, papritmas fare pranë nesh, frenoi një "xhips" ushtarak. Me shpejtësi zbriti nga xhipi si një gjeneral topolak truplidhur por shumë simpatik, i cili me mirësjellje, me dialekt verior, iu drejtua tim eti:

- Me falni, në mos u gatofsha, a jeni ju ish-mësuesi im z. Sami Gonxhja, në shkollën fillore? (S'më kujtohet shkolla që përmendi gjenerali).

- Po, u gjegj im atë, disi me ndrojtje. Unë jam mësuesi Sami Gonxhja, por më vjen keq, që mua nuk po më kujtoheni, sepse nga duart e mia kanë kaluar shumë brezni nxënësish...

- Pa më thoni, "shoku", gjeneral, po juve si quheni?

- Unë quhem Gjin Marku, safi djalë Mirdite – u gjegj gjenerali, dhe vazhdoi më tutje. – Z. Sami. S'ka rëndësi se a më mbani apo s'më mbani mend. Rëndësi ka fakti se unë ish nxënësi juaj në klasën e katërt dhe njëherësh trazovaç i bankës së fundit... për të cilën, gjithsesi ju kërkoj ndjesë (tha me të qeshur gjenerali) mbaj mend ato këngët rreshtore që na i keni mësuar ju ku ndër më e pëlqyera prej



Pak muaj më parë, dy këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi dhe Kastriot Tusha, risollën në një version bashkëkohor "Marshin e Djelmërisë Dibranë".

Ky marsh është shkruar dhe kënduar nga Haki Sharofi në vitin 1921, me rastin e fitores së dibranëve kundër pushtuesve serbë në Lanë-Lurë dhe muzika është shkruar nga Sami Gonxhe.

Orkestrimi i ri i këngës është bërë nga prof. dr. Isak Shehu, pedagog në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve dhe regjistrimi i saj është bërë në studion e kompozitorit Klodian Qafoku.

Realizimi i këngës nga tenorët Arif Vladi dhe Kastriot Tusha është mbështetur nga Ministria e Kulturës, shoqata Bashkësia Dibrane, bashkia e Dibrës dhe Komuna e Dibrës së Madhe si dhe nga kompanitë Lura Group (Dodë Doçi), Bruçi sh.p.k (Faik Bruçi) dhe R&T Group (Renis Tershana). Video është realizuar nga AS Productions, kamera nga Adnan Elezi dhe Neki Feta, operator zëri Arben Zeqja dhe montazhi nga Geri Shehu.

Redaksia vendosi të ribotojë një shkrim rreth kësaj këngë, botuar në mars të vitit 2014 nga prof. as.dr. Hyqmet Gonxhe, i biri i atdhetarit Sami Gonxhe. Videoklipin e ri të këngës e gjeni këtu: https://www.youtube.com/watch?v=Eln_j58Ails

meje dhe bashkëmoshatarët e mi ka qenë "Marshi i djelmënisë Dibrane". Z. Sami – vazhdoi fjalën e tij, gjeneral mirditor: A e ke bezdi që ta këndojmë së bashku këtë marsh luftarak që më ka frymëzuar edhe në luftën partizane?

- Po, me gjithë qejf – u gjej im atë. Dhe që të tre nisëm të këndonim me zë të ulët këtë marsh pa u bërë merak për kalimtarët e rastit të cilët po habiteshin duke parë një gjeneral dhe dy civilë që po këndonin këtë "marsh" luftarak në mes të rrugës?!

Duke kujtuar këtë episod, si unë ashtu edhe ima atë nuk na shkonte ndërmend që ky gjeneral trim e atdhetar mirditor do të binte pas dy vitesh viktimë e draprit gjakatar në dorën e Makbethit Shqiptar.

Do të më bënte vinte shumë mirë që marshi i Djelmënisë Dibrane të këndohet si qëmoti, veçanërisht në shkollat 9-vjeçare të qarkut të Dibrës.

"MARSHI I DJELMËNISË DIBRANE",
Autor i tekstit "Mësuesi i Populllit" Haki Sharofi

Drin o Lum i Gjanë
Drin o lum i gjanë, plaku i malësisë!
A ke me j'a lënë Dibrën Serbisë?
Kurrë nuk durohet kjo rrobni,
Dibra e Mojsiut asht shqipëni
Refreni
Çohi; burrë, çohi
Gjithë me besa besë,
Për Dibrën luftoni
Me të madhe shpresë!
Lurë, o vend i nalt, vend i trimërisë!
Aty u bënë fjalët, besa e lirisë:
Dibra do shpëtue, vend i Kastriotit
Dibrani lirue, si ka qenë motit
Çohi, burra, çohi
.....
Bregut t'Drinit krisi topi, gjëmoi dheu
Dibranin luftë detyrën e kreu,
Syni s'iu tremb kurrë, armikun përzu
Dhe vet mbeti burrë, Dibrën e shpëton.
Çohi, burra, çohi
Gjithë me besë besë!
Dhe lirinë festoni
Me të madhen shpresë!...
Dibra historike, me lufta me valë,
Dera e Kastriotit gjinit t'and ka dalë,
Ke pasun kreshnikë, po ke dhe sot,
Që për Shqipërinë gjakun s'kursen dot.

Çohi, burra, çohi...

Jeta dhe puna e familjes Keshi në Majtarë të Maqellarës, një shembull për të gjithë

Në bahçen e Kapllan Keshit...

Nga **OSMAN XHILI**

Fisi Keshi në Majtarë është nga më të mëdhenjtë e këtij fshati. Ata kanë qenë historikisht të lidhur me bujqësinë dhe blegtorinë, duke fituar admirimin dhe respektin e shokëve e miqve. Por, jo vetëm kaq, por të paktën tre drejtorë shkollash janë prej këtij fisi, pa përmendur mësues të shumtë, në degë të ndryshme të dijes e shkencës. Ndoshta do të shkruajmë më shumë për këto gjëra, kur të mendohet një historik për fisin, apo fshatin e sot do të ndalemi te njëra nga këto familje.

Kapllan Keshi ishte një nga burrat e shquar të këtij fisi. Dhe pse ishin kohë të vështira e shpesh me zi buke, Kapllani diti ta mbajë familjen në kushte krejt normale, ta edukojë atë me ndjenjën e punës, por dhe me besimin te Krijuesi. Ai kishte bujqësinë, jo vetëm mjet jetese, por dhe pasion e kënaqësi. Familja e tij i mbillte vetë bimët në shpore apo shtretër të ngrohtë. Pak i duheshin për vete, pasi shumicën e tregtonte tek fermerët e tjerë. Një natë para pazarit të së dielës, vaditeshin pak bimët, shkuleshin me kujdes, lidheshin bukur në dorëza, si fjongo me lëkurën e shelgut apo të verrinit, dhe ambalazhoheshin në kosha.

Kapllani i dëgjonte me kujdes fjalët e më të moshuarve, pasi ajo ishte vetë eksperienca që do ti shërbente në të ardhmen. Ai nuk kishte kosha të tij, që asaj kohe përdoreshin aq shumë dhe i kërkonte tek një komshi. I kërkoi njëherë dhe dy, kurse të tretën komshiu nuk ia dha. "Hajde me mua", - i tha komshiu më i madh në moshë. Shkuan tek një përrua, plot me pemë e filiza të rinj. Zgjodhën disa prej tyre dhe mbushën një krah. Komshiu e mësoi djaloshin e ri si të vepronte. Nuk ishte zgjidhje që ai të mbetej gjithë jetën duke kërkuar koshat, apo veglat e të tjerëve. Lypsej që ai të mësonte vetë se si ti bënte ato. Ngulën në tokë disa shkopinj më të trashë në formë pak a shumë rrethore. Me të tjerat më të holla u shkonin rrotull, duke i ndërthurur bukur dhe në fund i bënë nja dy kapëse të bukura. Kapllani e kishte thurur koshin e parë, nën mbikëqyrjen e komshiut dhe të dytin e bëri krejt vetëm. Dukej i mrekulluar kur i shihte ata kosha të rinj, që tashmë ishin të tijat e nuk ishte më nevoja të kërkonte te të tjerët. Në fillim e mori pakëz inat komshiun, kur nuk ja dha koshat, por më pas e kishte kuptuar qëllimin, duke marrë një leksion që nuk do ta harronte kurrë. Nëse donte që të merrej e ti përkushtohej bujqësisë, ai duhej të kishte mjetet e tija të punës.

Bahçja e Kapllan Keshit ishte e madhe, që nga shtëpia e tyre pranë rrugës e deri në përrua poshtë. Të gjitha llojet e pemëve e të varieteteve ndodheshin aty. Në ato kohëra kur mungonin frigoriferët, Kapllani kishte teknikat e veta të ruajtjes. Veshulëve të rrushit u vinte një kokërr rrushi te bishti, në mënyrë që të ushqehej për një kohë sa më të gjatë. Mollët bio e të paspërkatura me ndonjë lloj helmi, vileshin dhe futeshin në kashtë, deri në mbarim të pranverës. Një aromë e mrekullueshme e zbulonte vendndodhjen e tyre që dhjetëra metra larg. Gjatë rronin dhe ftonjtë e mëdhenj që zbuteshin gjithë dimrit, kurse arat nuk kishin nevojë për ndonjë trajtim të veçantë. Të gjitha këto servireshin për miq, shokë e dashamirë, për të sëmurë, që u shkonte mendja për ndonjë frut jo të stinës dhe që i dukej se do ti bënte derman.



Mjalti do të ishte gjithmonë i bollshëm në familjen e tyre. Mbi njëzetë koshere bletësh, ashtu primitive, siç ishin në atë kohë, do të ishin gjithnjë prezente, duke e ëmbëlsuar sadopak jetën e vështirë të asaj kohe.

Kapllan Keshi, që dinte të menaxhojë aq mirë familjen e tij, ashtu do të dinte të bënte dhe rolin e kryetarit të këshillit në fshatin e tij. I zgjuar dhe autoritar, ai dinte të zgjidhë probleme, mosmarrëveshje, të paqtojë e të bashkojë njerëzit e fshatit.





Djali i tij, Nuriu, nuk ishte i dhënë shumë pas bujqësisë, si i jati. Ai ishte më i dhënë pas ndërtimit dhe shumë kohë u angazhua me restaurimin e monumenteve të kulturës. Megjithatë, ndoshta për hir të një tradite të vjetër, apo të lidhjes fort pas tokës, familja e tij bleu dhe 30 dynymë, krahas asaj ekzistuese. Nëse do ta konsideronim një makineri gjithë këtë sipërfaqe toke, i vetmi që mund ta vinte në lëvizje këtë, do të ishte Abduli, djali i madh i Nuriut. Ata janë tre vëllezër, por dy më të vegjlit, janë me gjithë familjet e tyre në Itali.

Abduli kishte qenë dhe vetë në Itali, jo pak kohë. Kishte shfaqur shumë cilësi në jetë, por që nuk kishin shumë lidhje me bujqësinë. Dy vjet kishte bërë kurs fizarmonike në Peshkopi, duke treguar një talent të veçantë. Në ushtri ishte veçuar si qitësi më i mirë i divizionit, në Meglushë të Shkodrës. Në Itali kishte mësuar mjaft mirë gjuhën italiane, si dhe profesionin e berberit.

Të gjitha këto i mblidhte dhe i bashkonte, sërish i ndante për të gjetur atë trajektore që duhej të ndiqte në jetë. Nuk di pse një zë i largët i thoshte që nuk duhej të braktiste bujqësinë, tokën që kishin dhe që kishin blerë, traditën e bukur të gjyshit Kapllan. Gjërat nuk do bëheshin menjëherë, por jeta do ta mësonte hap pas hapi se si të vepronte. Tek toka e blerë, aty anës së xhades që të çon te dogana e Bllatës ngritën një ndërtesë trekatëshe. Bahçja e vjetër, bashkë me shtëpinë e vjetër ishin rrënuar. Vetëm kujtimet e fëmijërisë kishin mbetur të paprekura, të ruajtura mrekullisht në një nga disqet e kujtesës. Rreth e rrotull vilës vuri pak pemë si fillim, sa për nevojat e familjes. Pak rrush, qershi, mollë e dardhë. Disa varietete të vjetra e rezistente shkoi e i mori te trojet e vjetra. Më pas numri i tyre rritej e rritej vazhdimisht.

Para tre vitesh Fondacioni "World Vision", me qendër në Peshkopi, solli mjaft fidanë lajthie për fermerët e rinj e të pasionuar. Një prej këtyre përfituesve ishte dhe Abduli, i cili mbolli katër dynymë lajthi, me varietetin italian "Tondo Romano". Fidanët u vunë në pranverën e vonë me shpresa të vakta zënje, por dhe njëfarë enigme se si do të ishin ato kur të rriteshin. Me një kujdes të veçantë në vaditje, punime e plehërime, pak nga pak blloku i mbjellë filloi të marrë fizionominë tipike dhe pak kokrra u ravijëzuan dhe u zhvilluan që në vitin e parë.

Frikërat e para u larguan. Zënia e fidanëve ishte e kënaqshme dhe lloji ishte vërtet, ashtu siç ishte premtuar. Tani, në vitin e tretë, Abduli synon t'i drejtohet dhe tregut me një sasi të vogël prodhimi, për tu rritur më pas vit pas viti, duke shtuar të ardhurat e familjes së tij. Klientela do të jetë e sigurt se lajthitë nuk kanë asnjë lloj trajtimi me plehra kimike, bile dhe trajtimi me pesticide është mjaft i reduktuar, afër nivelit zero.

Janë shtuar qershitë e mbjella, dardhat e rrushi, boronicat e aronjat, kivi, arrat e gështenjat. Madje dhe kulturën e kikirikut e eksperimentoi me shumë sukses. Abduli është bërë një shartues i mrekullueshëm. Mjafton ta shohë njëherë një punë, një veprim dhe nuk ka nevojë për herë të dytë. Sa herë që sheh diku një varietet të bukur peme, do të marrë kalema e sytha për ta pasur atë dhe te shtëpia e tij.

Dy lopë me prodhimtari të lartë qumështi, janë përherë në fermën e tij. Ata shoqërohen gjithnjë me dy viça, por shpesh bëhen dhe katër, pasi lopët e tij bëjnë dhe binjakë. Misër, jonxhë, elb dhe shumë produkte të tjera janë në dispozicion, që ata të mos bien nën 20 litra qumësht secila. Dhjetëra pula përfitojnë nga këto ushqime cilësore dhe shpesh miqtë kur përcillen nga kjo familje marrin me vete dhe një sasi vezësh krejt bio.

Kosheret primitive me mjaltin e mrekullueshëm i trazonin shpesh kujtimet e tij dhe një ditë, jo më larg se tre vjet të shkuara, vendosi ta përtërijë traditën. Mori vetëm dy koshere si fillim, dhuratë nga daja i nuses në Klos. Nëse do tregonte pasion, punë e mençuri, shifrat mund të shkonin në rritje. Nga dy në fillim, numri i koshereve ka shkuar në njëmbëdhjetë të tilla. Jo vetëm kaq, por ai është bërë një mjeshtër i vërtetë. Din të punojë me to, të ndërrojë mbretëresha e të prodhojë të reja, tu paraprijë sëmundjeve, me sa më pak preparate të dëmshme. Shpresojmë që parku i tij i bletëve të shtohet sa më shumë në të ardhmen, që dhe ne miqtë e tij të shijojmë e të përfitojmë vlerat kurative të mjaltit.

Abduli shihte në shumë vende të tjera, kur vila si e tij, kishte pranë dhe një serë të vogël. Ai vendosi që ta kishte dhe ai të tijën. Ai ishte mekanik, saldator i shkëlqyer, mekanizator për zetor e çdo pajisje tjetër. Përse të mos kishte perime, që nga marsi e deri në janar? Skuadroi një sipërfaqe prej 50 metër katror, futi tubat 50 cm në tokën e fortë, i mbushi tubat e trashë plastikë me beton



dhe një fije hekur, duke u dhënë qëndrueshmëri të lartë. Të gjitha kthimet e hekurit i bëri vetë, duke e siguruar serën nga era, bora e çdo shkak tjetër dëmtues. Kastravecat i nxori mjaft herët, kurse tani ka në prodhim specat, patëllxhanin, domaten e perime të tjera. Ai përdor vetëm plehun organik të fermës së tij dhe asnjë lloj spërkatje, duke siguruar vërtet një produkt bio, element që e ka të panegociushëm, jo vetëm për familjen e tij, por dhe për të tjerët.

Mendja e Abdulit përherë ka diçka për të shpikur. Një ditë mendoi se si motocapin ta adaptojë dhe për prashitje. Ç'farë paska japonezi, që të jetë më i zgjuar se ne? I vuri nja dy rrota, seç i bëri dhe ca marifete të tjera dhe e vuri në provë eksperimentin. Vetëm në gjysmë ore prashiti dy dynym misër, kur do ti duheshin të paktën dy ditë punë, bashkë me familjen. Nuk harxhoi më shumë se një litër benzinë me motocapin e tij ekonomik.

Shkolla nëntëvjeçare e Majtarës,nuk është shumë larg nga shtëpia dhe pronat e tij. Banjot e kësaj shkolle nuk janë në formatin e duhur dhe ne si komunitet kemi menduar që ti bëjmë ato me parametra bashkëkohore. Që të ndodhi kjo, krahas investimit monetar, duhet dhe uji i rrjedhshëm të jetë i pranishëm. Abduli e afron bujarisht ujin që do të dalë nga një pus i hapur në tokën e tij dhe me vetërrjedhje do të shkojë drejt tek shkolla, për nevojat e saj. Sa mirësi e sa sevape të përfituara. Gjithë ato nxënës e mësues do t'i lëshojnë Abdulit dhe familjes së tij urime pa fund, që do t'ju burojë nga zemra, siç do burojë nga toka uji i pusit të tij.

Ai rregullon pa problem elektro-shtëpiaket e familjes dhe të miqve të tij, duke fituar vlerësimet maksimale të shoqërisë. Pas shkollimit të mesëm bujqësor, diku nga vitet nëntëdhjetë, Abduli mbaroi dhe juridikun, part time. Ka punuar ca kohë si jurist në ndërmarrjen pyjore, kurse tani punon në një agjenci sigurimi të automjeteve. Abduli eksploron udhëve të jetës, çan me vendosmëri në kanionet e saj, i dobishëm për familjen dhe për njerëzit që e rrethojnë. Me siguri, që dhe gjysh Kapllani ndihet i qetë e i kënaqur, nga nipi që po përcjell më lart e më larg veprën e tij.

turizëm

Nga një barakë druri në një pikë turistike në breg të Drinit – biznesi që rritet nga puna dhe dashuria e familjes së Shaban Beçës

Resorti "Beça" në Podgorcë, një biznes që rritet pak nga pak **në shërbim të turizmit**

Nga **OSMAN XHILI**





Shaban Beça nga Potgorca, buzë Drinit, gati po mbush 70 vjet, ku 50 prej tyre i ka punë. Kështu ishte gjithë jeta e tij, energjike, e vrullshme, dinamike, si një përrua malor, i mbushur plot nga reshjet pranverore.

Në vitin e largët 1972 mbaroi teknikumin e minierave, por nuk rendi në kërkim mineralesh. Arsye të ndryshme e detyruan të shkojë pranë familjes dhe punoi për një dekadë në S.M.T në e asaj kohe. Punoi me traktor dhe me kombanjë, plugoi toka e korri grurin e shëndetshëm, derisa një ditë pësoi një aksident. Dëmtoi këmbën dhe nuk mundej më të vazhdonte në këtë profesion të vështirë.

Tregtia dhe pse me plot probleme e vështirësi, iu duk më e lehtë, të paktën fizikisht. Mbaroi një kurs tregtie në Shkodër dhe viti 1984 e gjeti si shitës dyqani në fshatin e tij, në Potgorcë. Në të njëjtën kohë bënte dhe detyrën e kryetarit të këshillit për fshatin dhe antar i këshillit të bashkuar. Kështu vazhdoi deri në vitin 1990, viti ndarës i dy epokave të shoqërisë shqiptare. Njerëzit fluturuan si gjethet e vjeshtës. Askush nuk e dinte si mund të organizohej në epokën e re që po agonte.

Shabani punoi dhe pak kohë me tregëti dhe pastaj ndërroi mendje. U mor me bujqësi e blektori. Familja e tij dispononte pak tokë dhe ajo ishte shumë pjellore. Mbolli shalqin e bostan, lakër e perime dhe fitonte mjaftueshëm. Më pas, ishte ndër të parët e Maqëllarës, që mbolli bostanore, duke përdorur plasmasin e zi, në një sipërfaqe prej dhjetë dynymësh. Bujqësia ecte paralel me blektorinë. Katër krerë lopë dhe 50 të imta do të ishin gjithmonë prezente në familjen e tij. Të gjitha këto krijonin goxha të ardhura dhe pse kërkonin shumë mund e sakrifica.

Pas punës së lodhshme të ditës, sidomos në muajt e verës, Shabani lahej në ujrat e Drinit, që i kishte fare pranë. Lahej e "shullahej" në diell. Kështu kishte bërë që i vogël dhe të gjithë banorët e këtij fshati të vogël shquheshin si notarë të mëdhenj. Një ditë qëndroi më gjatë në breg. Kishte marrë dhe pak ushqim me vete, dhe pse shtëpinë nuk e kishte larg. U ul nën hijen e disa pemëve, që po hidhnin shtat në breg të lumit. Shabani ishte kujdesur që të mos i dëmtonte njeri, pasi ishin në territorin e tij. Mbaroi së ngrëni dhe mendoi se aty mund të ngrinte një restorant të vogël e të bukur e njerëzit të vinin aty për një pushim të shkurtër, apo më të gjatë, të pinin ndonjë kafe e të konsumonin pak ushqim. E dinte që do ti duheshin shumë para për tavolina e karrige, për guzhinën e vendqëndrimet e klientelës. Por, ai shpesh kishte guxuar në jetë dhe ja kishte dalë mbanë. Kishte provuar disa profesione dhe në të gjitha kishte treguar aftësi.



Madje, kjo do të ishte një lloj tregëtie a biznesi dhe ai kishte punuar shumë vite në këtë drejtim.

Një barakë prej druri, që e bleu në Maqëllarë, ishte si guzhina e tij e parë. Ca trungje druri do të shërbenin si tavolina e karrige. Bëri disa kolibe, që



i veshi me thupra, kurse mbulimin e tyre e bëri me kashtë thekri. Thjeshtë dhe bukur. Njerëzit ndiheshin rehat aty dhe u dukej vetja si në antikitet. Çdo ditë kishte një ndryshim pozitiv në resortin që hidhte shtat. U hapën dy kanale, që sillnin ujë për freskim dhe u veshën ato me gurë të bukur. U ndërtua një hark dekorativ, u rritën dhe u shtuan pemë të tilla si plepa, shelgje, akacie dhe verrinj. Lule dhe zëmbakë e shtuan akoma hijeshinë dhe kënaqësinë e qëndrimit aty. Shpesh herë, në periudhën e verës, resorti i familjes Beça detyrohet të presë një numër të jashtëzakonshëm njerëzish, që mund të shkojë deri në 200 veta. Një pjesë e tyre janë dhe turistë të huaj, të cilët qëndrojnë një apo disa net dhe ndjejnë siguri e rehati në këtë zonë të bukur. Dhe në këto raste stafi arrin ti përballojë në kërkesat e tyre dhe të gjithë të dalin të kënaqur nga qëndrimi aty.

Familja Beça ka një minifermë në dispozicion të vetes së saj dhe pushuesve të shumtë. Tetë lopë, një sasi qingjash, si dhe një dynym me patate e perime e bëjnë akoma më bio ushqimin dhe sjellin akoma më shumë të ardhura në buxhetin e familjes. Diku nga viti 2007 Shabani mendoi të verë dhe një sasi koshere bletësh. Punët shkuan për mbarë dhe nga 14 që kishte në fillim, tani janë dhjetëfishuar. Vetë Shabani u shërben atyre, por dhe bashkëshortja e tij është shumë e aftë në këtë drejtim. Dihet që bleta ka mjaft shërbime dhe Shabani thotë se ajo është më e rëndë se delja.

Habitesh se si funksionojnë gjërat në këtë familje, ku secili i din dhe i përmbush më së miri detyrat e tij, tamam si një koshere bletësh, që i përmendëm në fillim. Tashmë, familja e Shabanit është shtuar ndjeshëm. Safeti është djali i tij i madh dhe është dora e djathtë e babait. Pasi kreu një kurs për gatim e pica në Maqedoni, shumë vite më parë, tani drejton guzhinën, ku punojnë gjashtë persona, që të gjithë njerëz të familjes. Djali i tij, Ledioni shkoi në Tiranë dhe u specializua për guzhinën në përgjithësi e gatimet e detit.Të gjithë këtij stafi i shtohen dhe katër kamarierë, që e çojnë në dhjetë numrin e të punësuarve.

Një gamë e gjërë shërbimesh dhe asortimentesh afrohen nga guzhina. Mish qingji e keci, të pjekur në furrë, apo në zgarë, pulë fshati me jufka ose me qull, gatime deti, si dhe ëmbëlsira të traditës, ku mbizotërojnë hallva dhe sheqerparja.

Shabani dhe familja e tij bënin këto investime, por një frikë, që sa vinte e rritej, u trazonte



nganjëherë dhe gjumin. Verës, lumi rridhte i qetë dhe pa ndonjë problem, porse dimrit e pranverës ai egërsohej dhe merrte përpara gjithçka. Nuk kursente as tokën pjellore dhe drunjtë, që i shkulte pa mëshirë. Fare mirë një ditë ai mund ta vinte përpara gjithë resortin, me karrige, tavolina, kolibe e ndërtesa e ta hidhte në det. Shabani kishte bërë ca investime për tu mbrojtur me gurë e rrjeta, por ata ishin të mjaftueshme. Vetë shteti ndërhyri fuqishëm, duke e shmangur rrezikun përfundimisht. Gurë të rëndë që vinin nga Bulqiza, rrjeta teli të mbushura me këto gurë, u vendosën në një gjatësi prej qindra metrash. U shpenzuan mbi një milion euro, për një periudhë gati trevjeçare dhe në gjithëgjatësinë e digës u vendosën panele, ose dhëmbë mbrojtës. Përfitoi jo vetëm Shabani dhe resorti turistik, por gjithë fshati ndihet falenderues.

Një element shumë i rëndësishëm në ndihmë të këtij aktiviteti, padyshim që do të ishte dhe rruga. Një linjë ishte ajo që vinte nga fshati i Allajbegisë, por duhej dhe një tjetër, që do të vinte nga ura e Topojanit. Ishte një investim personal i familjes, nga e cila përfituan jo vetëm ata, por i gjithë fshati. E gjitha kjo kushtoi mbi dhjetë milion lekë, por çdo vit duhet nga një mijë euro për ta mirëmbajtur. Kjo të kujton se nga investimi i dikujt, shpesh përfitojnë dhe të tjerët, ndaj nuk duhet të jemi ziliqarë e cmirëxhinj.

Projekte të reja shpresohet të realizohen në të ardhmen. Një bujtinë trekatshe, do të ngrejë shtat, fare pranë resortit, duke mundësuar qëndrime më të gjata, si të banorëve vendas, ashtu dhe turistëve të huaj. Ajo pritet të ketë 16 dhoma, që të gjitha me kushte speciale, që i nevojiten një pushuesi. Pjesë tjetër e projektit do të jetë dhe një urë me funksion të dyfishtë, për kalim njerëzish, por dhe e shoqëruar me dy tavolina të mëdha ngrënje. Veç këtyre duhet shtuar një park lojrash për fëmijë, pasi dhe ata e kanë të drejtën e tyre për tu argëtuar e kënaqur sa më shumë.

Shaban Beça ka qenë e mbetet një menaxher me vlera, jo vetëm për familjen, por më gjërë akoma. E përmendëm që për gjashtë vite kreu dhe detyrën e kryetarit të këshillit, deri në vitet nëntëdhjetë. Para tetë vitesh banorët e fshatit i'a besuan sërish këtë detyrë dhe Shabani nuk i ka zhgënjyer. Fshati nuk kishte xhami dhe para dy vitesh, falë përpjekjeve të tij, u mundësua një objekt i tillë, shumë i bukur, tamam në qendër të fshatit. Iftari promovues me shumë pjesëmarrës u mundësua nga vetë familja Beça, Zoti i shpërbleftë me mirësi. Po kështu u mundësua restaurimi i çezmës publike të fshatit, që sjell ujë të bollshëm. Shabani dëshiron që të shtojë dhe një gabinë elektrike, që do të lehtësonte disi ngarkesën që ka ajo ekzistuese, kur nevojat e banorëve për energji janë rritur mjaft.

Rruga e Arbërit është shumë afër fshatit të Potgorcës. Shabani e sheh si një mundësi mjaft të mirë lidhjen e fshatit me këtë rrugë kaq të rëndësishme, që do të ndikonte mjaft në zhvillime pozitive për banorët. Të gjitha këto përpjekje e realizime e kanë rritur ndjeshëm autoritetin e tij dhe në këtë prag 70 vjetori i urojmë jetë të lumtur, duke i shtuar vlera jo vetëm familjes së tij, por dhe komunitetit, që ai përfaqson.

Udhëtim në Dibër,
më 21.06.2021

shënime udhëtimi

Mendja dhe dora e dibranit *gjallonte në çdo lëndinë, fushë, skutë e kodër* **me pemëtari e bujqësi**

Nga Agron GJEDIA

Më 21.06.2021, për arsye pune, udhëtova për herë të parë për në Dibër e ky ishte një udhëtim që me të vërtetë e hetova vetëm në vend, që u kishte munguar udhëtimeve të mia nëpër atdhe.

Pavarësisht shokëve dhe miqve të shumtë që i kam nga Dibra, nga dje e pashë se prej tyre nuk kisha pasë marrë asnjë gjë prej gjërave, për ta krijuar përshtypjen time të konsoliduar, sikurse e krijova në një ditë udhëtimi për në atë qytet, i cili dukej që nuk ishte lëshuar dore, por e ruante finesën e vet të patjetërsuar e të "pakaçumitur" nga kaçubeti i tranzicionit shqiptar.

Ndonëse gjatë vajtjes për në vend, më përfshiu përhumbja në soditjen e çdo gjëje, e para së gjithash ajo që më lidhte me atë vend ku shkoja për herë të parë, rasti i vëllait tim të ndjerë, i cili e kishte mbaruar ushtrinë në Dibër, por edhe pleqtë e mi të ndjerë, të cilët kishin shkuar disa herë në llixhat e atij qyteti.

Bile, babai im, për herë të fundit ka dalë nga shtëpia e tij për në llixha, për të mos u kthyer më, sepse nga aty shkoi në vend-lindje, ku mbeti pa pikë-shpirti, duke qenë shëndoshë e mirë.

E s'mund ta lë pa e thënë se këto kujtime, së paku më shoqëruan nga Mati ose Klosi, për në Dibër, por edhe më "thartësuan" muskujt e nofullave dhe m'i mveshën sytë.

Për mua, jo vetëm luginat e po ashtu e gjithë "gropa" e Dibrës e rrethuar me male, u prezantuan mbresëlënëse e piktoreske, por edhe vet qyteti i Peshkopisë, pavarësisht nga ndikimet e tranzicionit, ishte dinjitoz, e që në të parë dukej mikpritës.

Që në të parë kishte gjurmë efektive të disa artizanateve që i jepnin qytetit vlerat e tradicionales, të cilat modernia, jo vetëm se nuk mundet t'i zëvendësojnë vetëm në vlerat praktike, por edhe ato morale të tradicionales.

Në monizëm kishim dëgjuar për "Lej Fenin", e Dibrës, Servet Kosiqin, por pavarësisht hiperbolizimit të atij personazhi në të vërtetë real, shembulli i tij dukej sot e kësaj dite se kishte pasë dhe ka një bazë të gjerë në ato treva, sepse mendja dhe dora e gjallë e dibranit gjallonte në çdo lëndinë fushe, bregore, skutë e kodër me pemëtari e bujqësi.

Udhëtimi im i parë ra në "stinën' e qershive, të cilat dukeshin me bollëk ne treg, qoshe, rrugë, e kudo në arka, duke i tregtuar, e kjo do të mbetet si opinion për mua, por e di se aty janë të përmendur për mollët, kumbullat, dardhat e shumë e shumë prodhime të tjera.

Gjatë kohës në dispozicion, me qëllim për t'u kthyer prapë për në Tiranë, vizitova Muzeun e atij rrethi, i cili për fat ishte ruajtur dhe kishte se çfarë të shihje në pavionin e arkeologjisë, historisë dhe etnografisë, por me sa dukej qartë, që para vitit 1990 nuk kishte pasur dhe nuk kishte ndonjë investim.

Në pavionin e arkeologjisë gjendeshin objekte (fragmente enësh, sëpata guri, vorba mesjetare etj.), që datojnë nga periudha e Neolitit të hershëm deri në Mesjetë, të gjetura në vendbanimet si: Çetush, Burim, Çidhën, Topojan, Grazhdan, etj.

Në këtë pavion, me mjaft interes, ishte një objekt arkeologjik, Pitos shek. III-II p.e.s-Grazhdan, përkrenare Ilire e shek.IV-II p.e.s Draj-Reç, vorba mesjetare shek. XII-XIII në Kishën e Pesjakës, etj.

Kurse në pavionin historik të atij muzeu, ishte pasqyruar në vija të përgjithshme historia e Dibrës, luftërat, jeta politike, si dhe disa nga figurat që kanë lënë gjurmë jo vetëm në atë trevë, por në historinë e mbarë popullit shqiptar, si: Seid Najdeni, Iljaz Pashë Qoku, Dom Nikoll Kaçorri, Vehbi Dibra Agolli, Bajram Curri, Elez Isufi, Haxhi Lleshi etj.



Në pavionin historik të atij muzeu, ishte pasqyruar në vija të përgjithshme historia e Dibrës, luftërat, jeta politike, si dhe disa nga figurat që kanë lënë gjurmë jo vetëm në atë trevë, por në historinë e mbarë popullit shqiptar, si: Seid Najdeni, Iljaz Pashë Qoku, Dom Nikoll Kaçorri, Vehbi Dibra Agolli, Bajram Curri, Elez Isufi, Haxhi Lleshi...





Pavioni etnografik ishtë pavioni më i madh që ka ai muze, i ndarë në tre dhoma, sikurse janë oda e miqve, oda e veshjeve, oda e enëve dhe veglave të punës, një holl i madh, të cilat ishin të pajisura me shumë objekte.

Në mënyrë të veçantë vëmendjen time e tërhoqi oda e miqve, e cila ishte e pajisur në mënyrë të kënaqshme, por që me pak përpjekje, mundej që ta kalonte stadin e improvizimit, duke i bërë një organizim të sipërfaqes së saj dhe vendosjes së objekteve, sikurse ka qenë në mënyrën funksionale te saj.

Pas vizitës së atij muzeu, e cila pa "përtesë" e me çiltërsi malësore më krijoi mundësinë e gjuhës së përbashkët e të njohjeve të reja në qytetin e Peshkopisë, kafja nën hijen e pishave dhe aromën e luleve të blinit, në prezencë të z.Haki Përnezha, studiues, ish - Kryetar i Komunës, anëtar aktiv i Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", drejtuesja e Muzeut zj.Morena Ruçi, punonjësja e Muzeut, Anisa Hajrullahi, Miranda Troci Derti, poete, Xhuljano L Derti, (një i ri i cili ishte i interesuar për historinë), krijoi atmosferën e një debati informues për të veçantat e zonave tona respektive, dokeve, traditave, zakoneve.

Ajo kafe për mua ishte jo vetëm një mikpritje bujarie, por edhe tregues i mungesës së hezitimit, afrimitetit e mungesës së kompleksëve për t'u ulur në mes veti me një gjuhë të përbashkët e të thjeshtë komunikimi të sinqertë, si vëllezër dhe motra, të cilëve na u dha mundësia të njihemi në mes veti.

M'u dha rasti dhe asistova në momentin kur z. Haki Përnezha ia dorëzoi Muzeut një objekt qeramik, i cili duhet "lexuar" nga specialistët e fushës për përmbajtjen dhe rëndësinë e tij.

Nuk hezitova që të heq paralele në mes asaj që pashë në atë Muze dhe Muzeut në vendlindjen time Tropojë, i cili, edhe pse ishte i dyti në Shqipëri, me një përfaqësim edhe për Kosovën, u piketua për t'u shkatërruar nga armiqtë e popullit tonë dhe u bë pluhur e gjithë ajo pasuri eksponentësh, por pa i hyrë gjembi në këmbë as sot e kësaj dite.



Kurse nga aty e mbrapa, ai rreth i "sunduar" nga mediokër e injorantë lidhur me historinë dhe trashëgiminë e popullit tonë, nuk kanë bërë përpjekjen më të vogël për ta rimëkëmbur atë Muze.

Ky ishte një rast për ta mësuar rrugën për në Peshkopi e ta vijoj për atje rast pas rasti.

Këshilli Bashkiak i Bulqizës nderon
dy mjekët e njohur

Alma Cani *dhe* Edmond Puca
marrin titullin "Qytetar Nderi" të Bulqizës

Nga **SAKIP CAMI**

Këshilli Bashkiak i Bulqizës ka nderuar me titullin "Qytetar nderi" dy mjekët e njohur, Alma Cani dhe Edmond Puca, për kontributin e tyre në fushën e mjekësisë, kryesisht gjatë periudhës së pandemisë.

Dhënia e titujve të nderit u krye në dy ceremoni të ndara, në prani të personaliteteve të ndryshme, anëtarëve të këshillit bashkiak, miqve dhe familjarëve.

Ceremonia e dhënies së titullit për Dr. Edmond Puca u zhvillua më 5 qershor 2021. Titulli "Qytetar nderi" iu dha mjekut Puca me motivacionin "Për veprimtari të shquar në fushën e mjekësisë, veçanërisht në atë të sëmundjeve infektive dhe për kontribut të çmuar profesional në përballimin e situatës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19".

Gjatë ceremonisë, kryetari i bashkisë Lefter Alla tha se "Dr.Puca shquhet për një karrierë të gjatë në sektorin e shëndetësisë, duke kontribuar sa në angazhimin profesional në ndihmë të pacientëve nëpër spitale, po aq edhe për produktin shkencor që ka ofruar në këtë drejtim. Ai tashmë është nga emrat e njohur të mjekësisë shqiptare, ku përmes pjesëmarrjeve në konferenca shkencore, kombëtare e ndërkombëtare, publikimeve të shumta në periodike vendase dhe të huaja, ka arritur të përfaqësojë denjësisht shkencën shqiptare".

Gjatë fjalës së tij, Alla tha se "Dr.Mondi, me punën dhe përkushtimin e tij është kthyer në një pikë motivimi për shumë të rinj bulqizakë. Është detyra jonë të vlerësojmë dhe promovojmë siç duhet kapacitetet intelektuale të bashkive, qoftë për t'u dhënë atyre vlerësimin e merituar, po ashtu edhe për të zhvilluar vizionin e brezave drejt arritjes së suksesit. Shembulli i dr.Mondit është nga rastet e veçanta për të treguar se për më të mirët gjithmonë ka perspektivë. Nuk mjafton të lindësh dhe rritesh në qendër të metropoleve për të qenë i suksesshëm në jetë. Mjafton vullneti dhe dëshira e mirë për të punuar dhe ecur përpara, dhe suksesi do të jetë i garantuar për gjithkënd."

Ceremonia për dhënien e titullit mjekes së njohur Alma Cani u zhvillua më 20 qershor në pallatin e Kulturës së Bulqizës. Në ceremoninë e organizuar merrnin pjesë shumë emrave të njohur nga arti, kultura, media, politika, akademia dhe shumë të afërmve e kolegëve të saj.



Dr.Alma Cani, mori titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin "Për veprimtari të shquar në fushën e mjekësisë, veçanërisht në atë të sëmundjeve infektive dhe për kontribut të çmuar profesional në përballimin e situatës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19".

Pjesëmarrësit në takim, mes të cilëve edhe aktori i njohur i humorit, Agron Llakaj, ndanë me të pranishmit mbështetjen që Dr.Cani u kishte dhënë gjatë periudhës kur kishin qenë të infektuar me Covid-19. Të tjerë emra si Tritan Shehu, Ardit Gjebrea, Inva Mula, Zala Çela, Manjola Nallbani etj., përmes video-mesazheve vlerësuan kontributin dhe mbështetjen e Dr.Canit gjatë përballimit me sëmundjen.

Lefter Alla: Dr. Alma Cani është vlerë jo vetëm për Bulqizën, por për të gjithë Shqipërinë. Aftësitë e saj profesionale, të bëra bashkë me humanizmin që e karakterizon atë, u kthyen në shpresë dhe shërim për gjithkënd që iu drejtua qendrave spitalore ku ajo angazhohej, kryesisht në Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi"

Dr.Mondi, me punën dhe përkushtimin e tij është kthyer në një pikë motivimi për shumë të rinj bulqizakë. Shembulli i dr.Mondit është nga rastet e veçanta për të treguar se për më të mirët gjithmonë ka perspektivë. Mjafton vullneti dhe dëshira e mirë për të punuar dhe ecur përpara dhe suksesi do të jetë i garantuar...

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Bashkisë Bulqizë z.Lefter Alla e vlerësoi figurën e Dr.Canit si një vlerë jo vetëm për Bulqizën, por për të gjithë Shqipërinë. "Aftësitë e saj profesionale, të bëra bashkë me humanizmin që e karakterizon atë, u kthyen në shpresë dhe shërim për gjithkënd që iu drejtua qendrave spitalore ku ajo angazhohej, kryesisht në reanimacionin pranë klinikës së kirurgjisë në Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi.", tha ai.

Kryetari i Bashkisë, Lefter Alla vlerësoi, gjithashtu, edhe figurën e babait të saj, mjekun e njohur Dr.Mehdi Cani.

"E sigurisht, nuk mund të ndodhte ndryshe, kur doktoreshë Alma ishte edukuar nga



dy prindër të mrekullueshëm, nga një baba si Mehdi Cami, i cili dha kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e qendrës shëndetësore në Bulqizë që në vitet 1950-1960, e që më pas arriti të hapte dhe organizonte edhe pavijonet e pediatrisë, kirurgjisë, infektivit e tjerë. Mirënjohje të thellë edhe për Dr.Mehdiun, i cili edhe sot e kësaj dite kujtohet si një nga mjekët më të mirë që kemi pasur në qytetin tonë, por edhe në Peshkopi ku shërbeu për vite me radhë", tha në fjalën e tij kryetari i bashkisë së Bulqizës.

Alma Cani dhe Edmond Puca, gjatë përshëndetjeve të tyre në ceremonitë përkatëse e titullin "Qytetar Nderi" si më të rëndësishmin që kanë marrë gjatë karrierës së tyre. Teksa falënderuan Këshillin Bashkiak Bulqizë, kryetarin e bashkisë dhe të pranishmit në ceremoni, ata u shprehën se ky titull do të shërbejë si një burim motivimi për t'iu përkushtuar edhe më shumë profesionit të tyre, në përpjekje për të shpëtuar sa më shumë jetë njerëzish.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Na ndiqni:
RRUGA E ARBËRIT
https://www.facebook.com/gazeteerajonitteDibres
ose
www.rrugaearberit.com

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.

Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.


IBAN (ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Djemtë e "Black Drin Adventure" ofrojnë edhe destinacione të tjera turistike në Dibër, që përfshijnë edhe udhëtime në mal, duke bërë të mundur vizita në më shumë se 23 vende turistike dhe më shumë se 34 destinacione.

reportazh

Rafting në Dri, një risi e turizmit në Dibër **plot surpriza dhe adrenalinë**

Nga **BUJAR KAROSHI**





Një shëtitje në lumin Drin nuk është vetëm një mundësi turistike, por edhe një kureshtje e madhe. Drini nuk është i njohur për sportin e ri të rafting-ut, por një grup djemsh nga Dibra kanë mbi 6 vite që e kanë futur këtë sport si një tërheqje të re për turistët, si një argëtim plot surpriza dhe adrenalinë.

Edi Truka, udhëheqësi i guidës, së bashku me guidat e tjera, Blerim Haliti dhe Orges Cara, janë duke përgatitur gomonet dhe mjetet e nevojshme për një udhëtim sa më të sigurt. Rafting-u në Dri lejon udhëtimin edhe të fëmijëve, por gjithmonë të shoqëruar nga prindërit dhe brenda numrit që mund të mbajë një gomone.

Nisja e udhëtimit tonë do të jetë pranë Urës së Topojanit, te Restorant "Drini". Para nisjes mund të provoni mjaltin e freskët të restoranti, mund të pini një kafe ose mund të shihni peshkatarët që kanë hedhur grepat e tyre. Para nisjes guidat verifikojnë veshjet e posaçme për udhëtimin, si dhe japin këshillat për përdorimin e lopatave të ujit...

"Kur të them 'e majta para', e djathta duhet t'u japë lopatave pas, dhe e kundërta, kur të them e "djathta para", e majta duhet t'u japë lopatave pas". Duket sikur është një lojë fjalësh, por Blerimi e "ngre" pak zërin: "Ju lutem, mos qeshni, vëmendjen këtu..."

Nuk është aq e vështirë sa kujton: është një gjë e thjeshtë kur ke vendosur këmbët në gomone në vendin e duhur dhe kur lopatën e mban i sigurt në dorë. Një provë në fillim për t'u mësuar me komandat "para", "e majta" dhe "e djathta" dhe gomonia merr udhë...

Lugina e Drinit është e paeksploruar. Edhe banorët e këtyre anëve kanë parë pjesë-pjesë këtë luginë, sipas afërsisë së fshatit të tyre, por jo të tërën.

Rreth 8 km do të ecim gjatë rrjedhës së lumit dhe udhëtimi do të zgjasë afërsisht tre orë, në varësi të qëndrimeve gjatë rrugës dhe nivelit të ujit.

Ne nuk kemi shumë fat këtë ditë qershori, pasi Drini ka pak ujë dhe kjo do të thotë që duhet "t'u japim lopatave". Një erë e lehtë që nisi nga fundi i udhëtimit kërkonte më shumë energji për ta çuar gomonen përpara.

Gjatë udhëtimit mund të shohim një natyrë të egër, dushqet që kanë filluar të harlisen si dhe rosa të egra, çafka gri apo edhe skifterin dhe shqiponjën, të cilat e ndjekin udhëtimin tonë nga lart. Vende-vende, aty ku lumi krijon thellësi, mund të shohim edhe peshqit e vegjël. Por bien në sy edhe plehrat dhe mbetjet urbane që vijnë nga përrenjtë anës lumit.

"Vitin e kaluar kemi bërë një aksion për pastrimin e mbetjeve, por përrenjtë sjellin akoma, duke e prishur peizazhin vende-vende" - thotë Edi Truka. Ai nuk harron të theksojë rëndësinë e madhe për ruajtjen e ekosistemit dhe ndalimin e vrasjes së peshqve me dinamit.

"Veprimtaritë me rafting në lumin Drin i Zi janë një mundësi e mirë për të mbështetur të rinjtë e Dibrës t'i përkushtohen dhe të shfrytëzojnë zhvillimin e qëndrueshëm që të ofron bukuria e zonës. Por, fatkeqësisht, përtej bukurisë përrallore, plasjet me dinamit, në mes të ditës, për të peshkuar na indinjojnë".

Organizata që ai përfaqëson, "North Green Association" ka ndërmarrë "Ndal Dinamit" dhe në bashkëpunim me pushtetin lokal, shoqërinë civile dhe organet e rendit po përpiqen të ndalojnë gjuetinë e paligjshme. Për këtë arsye ata kanë krijuar edhe hashtagun #dinamitndal dhe #unejamDriniiZi, në mënyrë që të përfshijnë banorët në këtë projekt dhe të identifikojnë sa më shpejt shkelësit e ligjit dhe dhunuesit e natyrës.



Gjatë udhëtimit mund të shohim një natyrë të egër, dushqet që kanë filluar të harlisen si dhe rosa të egra, çafka gri apo edhe skifterin dhe shqiponjën, të cilat e ndjekin udhëtimin tonë nga lart. Vende-vende, aty ku lumi krijon thellësi, mund të shohim edhe peshqit e vegjël.

Veprimtaritë me rafting në lumin Drin i Zi janë një mundësi e mirë për të mbështetur të rinjtë e Dibrës t'i përkushtohen dhe të shfrytëzojnë zhvillimin e qëndrueshëm që të ofron bukuria e zonës.

Ndalesa e parë është në Gradec. Lumi aty bie pak në një pjerrtësi mes gurësh dhe krijon dallgë, gjë që e rrisin adrenalinën. Ndërsa ne kemi mundësi të bëjmë fotografi, të lahemi në lumë dhe të shijojmë ndryshimin mes lumit të qetë si valë dhe valëve të rrëmbyeshme. Guida jonë inspekton terrenin për një kalim të sigurt. Ata vendosin drejtimin nga do të mbajë gomonia dhe se si ana e majtë dhe e djathtë do të duhet t'u japë lopatave. Aty edhe ne i japim të drejtë Blerimit në fillim të udhëtimit, që e ngrinte pak zërin dhe kërkonte vëmendje.

Megjithëse me pak ujë, valët kalojnë lehtë. Disa dallgë ngrihen lart dhe nuk shpëton kush pa u lagur. Guida jonë, Blerimi, që qëndron në fund të varkës, ka punën më të vështirë. Grupi i turistëve e kanë mendjen te adrenalina që të japin përplasjet, ndërsa ai mendon për sigurinë tonë.

Pas kalimit të Gradecit përpara kemi kanione të thella, ura të vjetra që lidhin fshatrat dhe mbeturina të ujësjellësit të prishur, që dikur lidhte fshatrat mes tyre.

KALAJA E GRAZHDANIT

Para ndalesës së Gradecit mund të shohësh rrënojat e kalasë së Grazhdanit. Ajo është shpallur Monument Kulture që në vitin 1963 dhe shtrihet në një terren të rrafshët, duke zënë një sipërfaqe prej 34 ha.

"Kalaja ndodhet në veri të pellgut të Dibrës, thuajse në mesin e rrugës që lidh qytetin e Peshkopisë dhe atë të Dibrës, përkatësisht në distancat lineare jugore dhe veriore 11 dhe 10 km. Ajo është vendosur në fushën e fshatit homonim, në perëndim të malit të Deshatit, midis përroit të Kamenicës në veri dhe atij të Bresnicës në jug.

Muri lindor i kalasë kalon disa metra në lindje të rrugës nacionale, ndërsa ai perëndimor i afrohet bregut të djathtë të Drinit të Zi deri afër 2 km. Kalaja e Grazhdanit shtrihet në të gjithë këtë hapësirë, midis kuotave 550 – 593m, në një terren fushor në lindje dhe të pjerrët në perëndim.

Ajo ka një pozitë të rëndësishme strateg-



Guida jonë, Edi Truka dhe Blerim Haliti, inspektojnë terrenin për një kalim të sigurt. Ata vendosin drejtimin nga do të mbajë gomonia dhe se si ana e majtë dhe e djathtë do të duhet t'u japë lopatave....





Bimësia e egër brigjeve të Drinit...

turizëm

Një ndalesë më e gjatë dhe e përhershme është te Kanioni i Fluturave. Aty mund të pihet një kafe, një gotë raki, mund të shihen shumëllojshmëri fluturash, si dhe mund të ngjitesh mbi urën e rikonstruktuar për foto të bukura dhe peizazhe fantastike.

jike në kontroll të rrugës së Drinit të Zi, që e lidh atë me dy arteriet më të rëndësishme transballkanike të periudhës romake: via Egnatian në Jug dhe atë të Lissus – Naissus në veri. Rëndësia e kësaj pozite rritet edhe nga fakti se ajo ndodhet në pikëtakimin e provincave të Epirit të Ri, Macedonia Secunda, Prevalitanisë dhe Dardanisë. Kalaja e Grazhdanit është monumenti më i madh sipërfaqësor i rajonit të Dibrës dhe castrumi më i madh në Shqipëri e ndër më të mëdhatë në rajon. Për përmasat e saj ballkanike e mesdhetare dhe pozitën qendrore në luginën e Drinit të Zi, ajo ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve, mes të cilëve gjeologu dhe gjeografi francez A. Boué, sipas të cilit Grazhdani zinte një vend qendror në sistemin rrugor ndërkrahinor. J. G. Hahn mund të konsiderohet si studiuesi i parë serioz i kalasë së Grazhdanit. Që në vitin 1863 ai shënonte se territori kur është ndërtuar kjo kala njihet me emrin "shehër" dhe mendon se aty duhet të ketë pasur një "qytet të rëndësishëm dhe të lashtë", i cili ishte rrënuar përdhunisht dhe nuk ishte rindërtuar përsëri në të njëjtin vend. Shënime interesante mbi këtë kala ka lënë edhe konsulli rus në Shkodër, I. S. Jastrebov. Sipas tij, kalaja e Grazhdanit nuk ka qenë as qytet e as kala, por "një koloni e vjetër romake në rrugën Egnatia për në veri". Ai mendon se në periudhën romake "Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave", por beson se " si çdo qytet romak ishte rrënuar plotësisht nga Atila".

Informacionet e mësipërme rreth Kalasë janë citime nga një studim i prof. Adem Bungurit, botuar në vitin 2009, por dy guidat lokale në Dibër, Grehans Uka dhe Orges Cara, flasin jo vetëm për Kalanë e Grazhdanit, por edhe për kalatë e tjera në Dibër, për historinë e Kastriotëve, etj. Ata janë trajnuar nga organizata të ndryshme joqeveritare për të njohur vendet historike dhe monumentet natyrore, për t'u përcjellë turistëve informacion të saktë dhe të shkurtër, pa i bezdisur me hollësi.

Rëndësia historike e kalasë së Grazhdanit i ka nxitur thesarkërkuesit që t'i dëmtojnë muret e saj. Ajo shihet me sy të lirë gjatë vozitjes dhe përpjekjet për të ndaluar fenomenin, por çon në dëmtime të sajteve arkeologjike jo vetëm në Kalanë e Grazhdanit, por të të gjitha vendeve ku populli njeh një kala të vjetër apo një kishë.

NJË NDALESË TE KANIONI I FLUTURAVE

Gjatë udhëtimit, ndërsa i afrohesh Luznisë, shihet në majë të një kodre kulla e rrënuar e Elez Murrës, një udhëheqësi popullor i rezistencës antiturke. Një projekt për të rindërtuar kullën, në një mënyrë që të ndërthurë historinë me turizmin, mund ta kthente zonën në një pikë të rëndësishme turistike, ashtu siç është kthyer tashmë "Kanioni i Fluturave".


Një ndalesë më e gjatë dhe e përhershme është te Kanioni i Fluturave. Aty mund të pihet një kafe, një gotë raki, mund të shihen shumëllojshmëri fluturash, si dhe mund të ngjitesh mbi urën e rikonstruktuar për foto të bukura dhe peizazhe fantastike.

Ura ka qenë e dëmtuar vitet e fundit. Dikur ka funksionuar për lidhjen e fshatrave në dy anët e lumit, Pejkë dhe Hotesh, ndërsa këtë vit është rikonstruktuar falë një projekti ndërkufitar të organizatës "Cross-Border Biking", me qëllim ringjalljen e turizmit malor dhe ecjes me biçikleta. Kjo urë tashmë është funksionale jo vetëm për turistët apo të pasionuarit e





Guida jonë, Blerim Haliti, që qëndron në fund të varkës, ka punën më të vështirë. Grupi i turistëve e kanë mendjen te adrenalina që të japin përplasjet, ndërsa ai mendon për sigurinë tonë.



Gjatë udhëtimit, shihet në majë të një kodre kulla e rrënuar e Elez Murrës, një udhëheqësi popullor i rezistencës antiturke. Një projekt për të rindërtuar kullën, në një mënyrë që të ndërthurë historinë me turizmin, mund ta kthente zonën në një pikë të rëndësishme turistike



Rëndësia historike e kalasë së Grazhdanit i ka nxitur thesarkërkuesit që t'i dëmtojnë muret e saj...





Qetësi te "Kanioni i Fluturave"...

udhëtimeve me biçikleta, por do t'u shërbejë drejtpërdrejt rreth 4500 banorëve në dy anët e lumit.

Pasi lë pas Kanionin e Fluturave, udhëtimi po shkon drejt fundit. Deri te ndalesa në Luzni ka akoma shumë për të parë: kryesisht një natyrë të paprekur, vende-vende me lëndina të bukura, me pyjet e dushkut që po rigjallërohen dhe me bimësi të dendur e të egër anës lumit.

"Mund të vazhdohej më gjatë, por deri këtu është e mjaftueshme për ata që duan ta provojnë këtë sport ujor".

Edi Truka tregon se kanë kryer një vëzhgim gjatë gjithë rrjedhës së Drinit dhe një guidë e re mund të jetë udhëtimi nga Zall Dardha deri në Skavicë, të cilët janë duke bërë përgatitjet e fundit dhe së shpejti edhe ky udhëtim do të shtohet në listat e guidave të rafting-ut.

SI TË PËRGATITENI PËR UDHËTIMIN

Që të realizoni dëshirën tuaj për rafting në Dri, mjafton të jeni mbi 6 vjeç. Grupet fillojnë nga 6 persona deri në 10, por në qoftë se shoqëria juaj nuk është aq, mos u demoralizoni. Ka të tjerë si ju që, duke rezervuar, bëheni grupe të ndryshme për më shumë shoqëri dhe adrenalinë.

Nëse mendoni se bie shi, mos e anuloni rezervimin. Shiu i verës vetëm i shton emocionet e udhëtimit.

Nuk duhet të keni frikë: guida njihet zyrtarisht nga Federata Shqiptare e Rafting. Kanë një licensë profesionale dhe kanë kaluar provimet rigoroze të marrjes së licencës, si dhe kanë njohuri të përsosur për çdo rast.

Siguria juaj është prioriteti kryesor i guidave të "Black Drin Adventure". Me mbi 6 vjet përvojë në organizimin e aktiviteteve në natyrë dhe sporteve ekstreme në Qarkun e Dibrës, siguria dhe cilësia janë gjithmonë të parat.

Kini parasysh se pajisjet tuaja elektronike do të lagen në qoftë se i mbani për të bërë video dhe fotografi. Nëse nuk keni mundësi t'i siguroni kundër lagies, guidat do të kujdesen për celularët tuaj dhe do të sigurohen që ju të keni foto dhe video si kujtim.

Ju duhet të kujdeseni për veshjet personale të nevojshme për një zbritje rafting. Duhet të keni rroba banje ose pantallona të shkurtra, atlete ose veshje të përshtatshme për sportet ujore, këmishë ose bluzë me mëngë të gjata, peshqir dhe ndërresa. Një person nga guida do t'ua sjellë çantën tuaj në pikën e zbritjes.

Guidat do t'ju ofrojnë xhaketë shpëtimi dhe kaskë mbrojtëse, sigurisht të pastruara dhe të dezinfektuara, për një udhëtim të qetë dhe të sigurt.

Çmimet e rafting-ut nisin nga 35 euro/ personi; ndërsa ofrohen edhe guida të plota 2-ditore me udhëtim nga Tirana dhe kthim, qëndrimi në hotel, ushqim, rafting dhe veprimtari të tjera për një çmim që nis nga 96 euro.

Djemtë e "Black Drin Adventure" ofrojnë edhe destinacione të tjera turistike në Dibër, që përfshijnë edhe udhëtime në mal, duke bërë të mundur vizita në më shumë se 23 vende turistike dhe më shumë se 34 destinacione.

©Fotot dhe teksti: B.Karoshi

cyan magenta yelloë black

Shënim i autorit për botimin e dytë të vëllimit poetik
'Aty te portat Skée'

"Aty te portat Skée" është një libër ku janë strukur të gjitha imazhet, tropet dhe figurat e veprave të mia

Aty te portat Skée *është libri im i parë, i botuar para 25 vjetësh nga shtëpia botuese "Onufri", që asokohe ishte në Elbasan. Me të nis rishtaria e rrugëtimit tim letrar. Më 1996, kur doli libri, unë isha student i institutit të letërsisë botërore "A. M. Gorki". Librin e botuar ma dërgoi botuesi, z. Bujar Hudhri, në Moskë, me anë të Olga Kollpakovës, ish-atashe e kulturës në ambasadën ruse në Tiranë. Nuk mund ta harroj kurrë atë emocion, një përzierje midis gëzimit të madh, shqetësimit, parehatisë, madje edhe njëfarë frike. Mezi prita të shkëputesha për t'u mbyllur në dhomë. E kam lexuar i përqendruar, duke u dridhur si në ethe deri në vargun e fundit. Kur mbylla kapakun, thashë me vete: "Po, ky është libri im!" Nuk mund ta banalizoj me asgjë tjetër të krahasueshme atë ndjenjë galdimi e lehtësimi njëherësh.*

Vëllimi përmbledh krijimet e mia poetike të periudhës 1990-1994, një fazë kur unë kisha kapërcyer sprovat e hershme dhe të mundimshme me vargjet në kërkim të një forme shprehëse sa më individuale. Mund të jenë grisur disa libra, dorëshkrime të mëparshme, për të mbërritur te ky vëllim. Kisha botuar disa cikle poezish në shtypin letrar qendror nga viti 1989 e në vijim. Kisha fituar disa çmime poetike kombëtare, disa konkurse, ndër to konkursin letrar prestigjioz "Migjeni". Periudha e shkrimit të këtyre poezive ka qenë koha e përmbysjeve epokale, e rënies së diktaturës, që për mua dhe shoqërinë e poetëve të grupimit letrar "E përshtatshme" në Fakultetin Filologjik ishte, para së gjithash, koha e shijimit të lirisë krijuese. Tani, pas çerek shekulli, duke rilexuar poezitë e këtij vëllimi nga lartësia e sotme, kuptoj se nuk do t'i kisha shkruar më mirë. Ndaj ribotimi nuk paraqet asnjë ndryshim me versionin e botimit të parë origjinal, me përjashtim të një korrektimi të kujdesshëm. Kuptoj, gjithashtu, se poeti mund të mësojë shumëçka nga kultura, libri, universitetet dhe teoritë, por shqisa e natyrshme e poetit nuk përftohet në rrugën e njohjeve e të dijeve akademike. Ajo ose është e lindur dhe farkëton imazhet në kudhrën e përvojave të brendshme, ose, në mungesë të kësaj dhuntie, do të shpiket një natyrë e dytë, vetëmashtrimi, duke u rrokullisur nga imitimi në epigonizëm. Unë besoj se poeti mëson nga vetvetja, duke "shkepur mish" nga vetja, ose, siç e thotë O. Mandelshtami në një varg: "Vetë jam dhe lule, vetë dhe kopshtar."

Titulli i vëllimit është një metaforë, siç janë rëndom titujt e librave poetikë. Në poemën e Homerit, Iliada, portat Skée janë portat kryesore të Trojës, bri të cilave gjendej Kulla e madhe, prej nga hapej pamja në fushën e luftës para qytetit dhe në det. Nga kjo kullë pleqtë trojanë kundronin luftëtarët akej, ndërsa Helena i jepte shpjegime Priamit për heronjtë që ajo i njihte. Te portat Skée Hektori ndahet me të shoqen Andromakën dhe të birin Astianaksin përpara se të niset në fushë të betejës.

Besoj se me bërthamën e kësaj metafore shumëplanëshe në titullin e të parit libër kam dashur të bëj një besatim solemn me veten, për hir të gjësë më të çmuar që më kishte mbajtur gjallë gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës dhe së cilës i qeshë përkushtuar: letërsisë.

Ky libër ka një rëndësi thelbësore për krijimtarinë time. Ai është një këllëf ku janë strukur të gjitha imazhet, tropet dhe figurat e veprave të mia të mëvonshme në poezi e në prozë.

Agron Tufa



Harmonika rozë

Kilikosa veten
dhe qava i lehtësuar,
i privuar rëndë
nga bota e mishit.
Nëpër brimat e harmonikës rozë
hyn e del shenjtërisht
fryma ime e artë:
e thurur me art të hollë,
e freskuar dhe e dridhshme,
e kulluar në filtrin
prej mushkërish gjethesh –
ajo ngjall një muzikë prekëse
që të përpëlitet si flutur e shituar
në zgavrën e pazbuluar të ngazëllimit.
Po mjaft!
Manteli i Centaurit u tund
tek digjet në shenjë lamtumire.
Në shkrumbin e tij trazo
se ke për të gjetur
eshtrat e frymës sime të artë,
pa të cilën s'kanë për t'u pjekur
frutat e kurmit tënd –
sajuar zjarresh tinëzare…

Stinë keqardhjeje

Keqardhja erdhi me varkë dhe lundër
pirate,
rrodhi vjeshtë e përgjakur ijëve,
e papërcaktuar në shifra romake
gjithë lëngata për borën e re.
Hëna shkrin kujtesë në pika gjaku të
ndryshkur pyjeve.
Nuk dëgjohet më briri,
as skërmitja që zvetënon
zemrën e pjekur të bishave bojëhiri.
Angullima vjen e largët,
e stërvitur në parandjenjë.
Kapërcej hijen dhe shkund këpucët me
borë mbi një prag të huaj.
Dreqi më çon të shtyj dashuri si fantazmë
me nusen e tjetrit gjinxehtë në të errët.
Natë dhe gjinj dhe stinë keqardhjeje.
N'at fshat të trishtuar: borë dhe vetmi.
Pendimi godet pingul herë-herë
misterin e verbër dhe aerobinë.
Keqardhja vjen si shtjellë,
si pjalm i hidhur që era e çon
me lundër të zjarrtë në lukthin e tharë:
taksën do ta marrë
taksën do ta marrë
dhe s'do na e kthejë më kurrë
kurmin prej drite të ngjirur,
ashtu të shpërndarë sallatë nëpër dhera.

Sonet

N'errësirë shtrihej gruaja, shtrati,
sakrilegji…
Shtrati, sakrilegji, gruaja lakuriq…
Tej feksnin çarçafët me bardhësi qefini,
bardhësi qefini që t'i vriste sytë.
Që të vriste sytë dhe të kallte frikë
në palcë e në eshtra si zhavorr i thatë:
gruaja që dihat, unë me veshët pipëz,
mund ta shihnim fundin shkaras nga një kamë.
Nga një kamë e gjatë si tërbim, si shpagë,
dhe të dy fishek për në ferr pastaj,
por "Ai" vonon, epshi çohet valë,
më rrëzon pa frymë mbi sisët e saj –
po me veshët pipëz, sikur vjedh thesarin,
sikur shtie në dorë botën skaj më skaj.

Aty te portat Skée

Portat e qytetërimit tënd do të hapen
me deshtë që përposh fshehin dashnorë.
Tejçohet dhe imuniteti i prekjes me sy
nga heqja dorë e prekjes me dorë.

Elegji

Po afrohet njeriu: siluetë e pikëlluar, ku i le
trokun e ëndrrave dhe thyerjet e shpatave?
Po afrohet një hije e përmbytur nga barra
e fatit
me dimensione horizontesh. Një nga një
aviten keqardhjet fqinje me kundërmime
shirash
dhe dritë të djegura në film.
Pllanga të përgjakura gjethesh flijohen mbi supe
si spaleta të bronzta.
O ti i prirur si pakkush në shpresë! Po
zbrazet
planeti ynë i moçëm,
me vrunduj gjaku e morali,
e gjarpërusha pikëlimtare
kanoset mbi fatet e verbra –
mbi qenien tënde të thërrmueshme,
kalli i pjekur loti.
Oh, le të flijohet,
le të flijohet sonte në vaj për të gjithë
aorta e kaltër e hënës!

Pikturat e tua

Të të dua ty (me ndikim)
tinëzisht duke ndier
pengun e një feste të fshehtë
pezulluar qyshkur…
Të gjitha kushtet sekrete të ndjenjës
piqen në muzg dhe marrin dhenë.
Vijnë mbrëmje bote
me këngë inferiore.
Vdes toka me mua
nën këmbët e tua
dhe digjet e bie
e shkrin ndër yje
fytyra jote –
e fundit Bastije.
Të të dua ty:
pikë në plan të përmbysur.
Simetria pasqyrohet femër mbi gremisjen time.
Nëndheshëm uturin qeliza,
tym nxjerrin damarët… shiko
si t'i mbështjell gjumi fletë-fletë
gjinjtë elektrikë me llërë e me seks.
Me fantazi gjeniale gjithë-gjithë
je e raportuar
lakër kaçurrele,
me rrënjë të përjetshme në mish të munduar.
Ka dhe mëngjes
sa për t'u dalluar niveli i neverisë
në lartësinë e detyrës.
Të të dua ty (teknikisht)
e mos të ta shoh
formën e vagëlluar që humbet
në rrjetën e karkalecave gri:
ata që kthejnë nga perspektiva
lajmërojnë gosti të mbaruar,
të tjerë nga retrospektiva
edhe shijen ia kanë harruar.
Dashuria ime kridhet pingul me ngulm e
ide fikse
në trafikun e rënduar të gjakrave bojëhiri.

Këngë

Do të të shpërndaj
gjithkund në kudo.
Dëlirma pak barrën moj mëma natyrë!
Hamall i ngarkuar
me një dashuri të rëndë –
ah, me një dashuri të rëndë,
veshur me lecka të dhimbjes
dhe këngë,
me leckat e dhimbjes dhe këngë.
Bagazhi i egër dhe gjunjët hollakë,
ah, gjunjët hollakë
tek dridhen, thembrat rrasen përtokë,
thellohen në tokë.
Si anije tokësore lundroj pa shpresë
me zemër të ngrënë,
ngado në kudo
të shpie, tek zbres,
me tokën e vdekshme nën këmbë…

Kuajt e ëndërrt

Kush i lëndoi kuajt e kuq në harbim
tokës së ardhur të marsit?
Tutje, perëndimi
ia qëlloi ligsht zemrës sime
të gjitha pikat e vdekshme.
Trokimë e hingëllima
u pinë pa gjurmë
në sfungjerin e gjirit tënd.
E megjithatë,
i pashë, për besë, kalëruesit
që behën nën pasione vetëtimash.
Zigzag elektrik,
gjarpër verbues
në segmentin e platitur të horizontit
përzhitën trëndafilin e pjekur
me qumështin radioaktiv të verës.
Më shungullojnë veshët
nga ai kalërim i ëndërrt
dhe si flatrat e shkrehura
të fluturës së vrarë – sytë e mi mjerojnë
patkoin e skuqur të zemrës
shqelmuar në sprint…

Jashtë

Ngrihesh në mëngjes
dhe kujtohesh se nuk e di ku e ke lënë
syrin.
Njërin harron se e ke lënë në shpinë
e tjetri ka pikuar nga çezma në heshtje.
Pastaj kujtohesh se vetëm je zgjuar
dhe gjithçka ka qenë një ndodhi pa
qerpikë.
Piqen kushtet
dhe respekti vërshon si katarakt
mbi kafkën e shkuar.
Të duket se gjithmonë
ke kositur jonxhë e
një flijim i butë plot aromë klorofili
lëron pandehmat e tua bujqësore.
Fëmijëri lucide,
e ndodhur rregullisht dhe pa pendesë,
si gjithë gjërat e dobishme, pa të cilat
s'do të ekzistonin elipset dhe metafizika,
fluturimet dhe rëniet, humbjet
e anijeve liburne
në kurmin e squllët dhe praktik të burrit…
Harresa e tashme me harrimin e shkuar
aq bukur përputhen!

recensë

Shtëpia botuese "Onufri" në Tiranë boton librin e ri me tregime të shkrimtarit Eqrem Basha, "Hije në grila".

Hani i udhëtarëve planetarë

Nga **ALI ALIU**
Akademik



ISBN: 978-9928-313-60-7 / Çmimi: 800 lekë / 174 faqe

Hani, strehë në hapësirë dhe kohë pa fund, për udhëtarë që kalojnë pranë njëri-tjetrit pa ditur kurrë për njëri-tjetrin, shkëmbejnë postaqinë e njëri-tjetrit, pa dëgjuar fatin, stuhinë, dramën, tragjedinë a gëzimin e kërkuar; para se të zhytet në gjumë të thellë, provon të kapë kuptimin e ndonjë belbëzimi jerm dhe asgjë më shumë...

Poet, tregimtar, romancier, eseist, autor skenarësh për film e TV, njohës i gjuhës dhe i letërsisë frënge, nga e cila përktheu dhjetëra drama, klasike e moderne, romane, ese...; që nga fillimet i ushtron paralelisht poezinë dhe prozën; realiteti që e përfshin brenda tre llojeve letrare është konsistent dhe unik, në përmbajtje, në kohë, në hapësirë; ndjesia, perceptimi, artikulimi artistik i botës përreth është veçantia e parë e krijimtarisë letrare të Bashës; ritmi i botimeve i maturuar, – çdo 2-3 vjet me nga një libër, pa bujë, pa paralajmërime e paslajmërime; konstant si në jetë, si në letërsi, si në format dhe veshjet narrative, që nga botimet e para në poezi dhe tregime, këtu e 50 e më shumë vite; artin e vet e sjell me gjuhë plotësisht dalluese, në kuptim të drejtpërdrejtë të fjalës, të veçantë në letërsinë bashkëkohore të shqipes; groteskore, përqeshëse (qesh e ngjesh...), me tis të hollë, elegant absurdi; me optikë narrative të përthyer, të zhvendosur të botës, të përditshmërisë konkrete, gjithë nuancime të holla, estetikisht perfekte; gjithë duke ia lënë të hapur dritaren lexuesit që optikën zhvendosëse narrative ta kthejë në kënd real dhe ta shohë si në dritë të diellit hapësirën ku lëvizin personazhet, botën tonë përreth, të përditshmen, sidomos atë, pjesën e kontaminuar, agresiven dhe depresiven...

Gjithë në këtë rrafsh, skrupuloziteti mimetik i Bashës, qoftë i mbështetur në traditën narrative, poetikën lirike romanore dhe tregimtare dhe trendeve të saj; besueshmëri perfekte mes faktit dhe trillit, mes të thënës dhe të fshehurës, mes shtesës dhe shkurtesës, mes vënies dhe fshirjes së thojzave – e kisha me shaka dhe seriozisht, mes buzëqeshjeve ironike dhe refleksit brengosës, detajeve dhe tërësisë...

Çfarësia që e rrethon autorin ndërsa, përditshmëria e trazuar, ajo më acaruesja përballë, ka vlerat e lënduara, jo rrallë të kthyera kokëposhtë; shkelja pa skrupull e tyre nga një etje për pushtet – (etja për pushtet është më shqetësuesja, më e liga etje e njerëzimit...), që nga derivojnë etjet e tjera, – pushteti i lekut, pushteti i postit, pushteti i shthurjes së moralit dhe deri te agresiviteti, brutaliteti, injoranca, dhuna, kriminaliteti...; aq sheshit dhe të ushtruara thuaja publikisht në hapësirën tonë ballkanike... Këtë ngarkesë bartin në strajcat e tyre personazhet e shumtë të Bashës, që në fillimet krijuese të tij, gjithë me substancë të pasuruar edhe në tregimet e librit që kemi përpara; i gjen, tërë spektrin shtresor të njerëzve, që nga rruga, kafeneja, zyra, sheshi, tregu e kudo shfaqen personazhet që, me veshje, sjellje, gjuhë, e begatojnë prozën me rrëfim fare të veçantë, rrëfim që e identifikon autorin që në pasusin e parë të tregimit....; me përjashtim vetëm të një tregimi, ai që qëndron më vete, përjashta katër cikleve me nga katër tregime të vëllimit *Hije në grila*, me titull *Vetëm një natë*, e që mua vazhdimisht më tingëllon si Hani, tregim për hanin....

Tek 15 tregimet e vëllimit *Hije në grila* hasim situata, personazhe, bëma të pangjashme dhe që gjithandej kanë veshje nuancash të holla, sa të absurdit, sa neurotike ditore, sa komike deri përtej kufirit, në prag grotesk, sa dëshpëruese e dramatike, sa agresive e tjetërsuese, derdhur në një shtrat unik, rrëfim të identifikueshëm qartë të Bashës; sipas një kodi narrativ zhvendosës, së jashtmi, sipas një optike që rrëfimin, imazhin, detajin, sjelljen e personazhit të zhvendosur perspektivash të shumëfishta, të lëvizshme, rrëshqitëse thuaja përmbysëse; te të gjitha zhvendosjet autori u lë një shteg të lehtë lexuesve, për t'i sjellë ato në normalitet, – përmes buzëqeshjeve fiktive, diskrete, apo të pashfaqura qartësisht; të gjitha këto shenja dalluese, spektër nuancash të kësaj poetike narrative, mund t'u shkojë si mbulesë e mundshme kodi grotesk; edhe situatat më përsmadhuese si shfaqje, si imazh i kësaj optike narrative dhe sipas këtij kodi narrativ, autori artikulon rrëfim me nëntekst që penetron thellësive të gjenezës, të rrënjëve, të botës, të realitetit të përmbysur, të prapë; këtë ngarkesë bartin personazhet, këto dromca refuzimi të prapësive përreth, këtë shqetësim, acarim të fshehur pas veshjes gjysmë loje e gjysmë prej vërteti, gjysmë argëtimi e gjysmë dëshpërimi, indiferentizmi dhe gjysmë këmbënguljeje për të nxjerrë sheshit ligësinë, për ta anatemuar të shëmtuarën në hapësirën tonë, në qenien tonë; këtë ngarkesë kanë, me përjashtim të tregimit *Vetëm një natë*, siç e përmenda edhe më sipër...

Është një natë dhe që shtrihet pafund, epokë; është një njeri që vjen dhe ikën brenda një universi njerëzor; është një han, një strehë sa për një dremkë nga udhëtimi planetar dhe për të vazhduar tutje; pa zë, pa rrëfim, pa lënë gjurmë, as emër, as moshë, as nga, as ku – strehë udhëtimesh universeve; janë udhëtarë që i zë stuhia natën dhe shfaqen te porta e hanit si të ardhur visesh mitike dhe hanxhiu, me fener të ngritur, sa për t'i treguar shkallët mysafirit, hapësirën ndriçuar nga një kërcu që digjet në oxhak, pranë të cilit, në një krah, fle thellë një planetar si ky, që shtrihet mbi postaqinë në krahun tjetër të oxhakut...

Hani, strehë në hapësirë dhe kohë pa fund, për udhëtarë që kalojnë pranë njëri-tjetrit pa ditur kurrë për njëri-tjetrin, shkëmbejnë postaqinë e njëri-tjetrit, pa dëgjuar fatin, stuhinë, dramën, tragjedinë a gëzimin e kërkuar; para se të zhytet në gjumë të thellë, provon të kapë kuptimin e ndonjë belbëzimi jerm dhe asgjë më shumë; le të gjejë lexuesi, në këtë tregim perfekt për hanin, edhe hiret, cenet e një hani modern, fanarë dhe oxhaqe, tallaganë mysafirësh, – nishane të hanit shqiptar, ballkanik, njerëzor...; është përulja e hanxhiut para hallexhiut enigma, ngarkuar mistere, mbuluar tallaganë dhe collniku ngarkuar në shpinë thellësive të natës, gjëmime bubullitëse stuhish, sa të prehen në strehë gjithësie, një sy gjumë për të përtërirë qëndresën përballë sfidave të reja, të pafund; dhe rrëfimi i njohur, sqimtar, perfekt i Eqrem Bashës; dhe përshkrimi i ambientit, – jo dekor pasiv por gjallëri që të fton ta ndjesh funksionin e çdo detaji, që nga kapërcimi i pragut të hanit, deri tek mbështetja e kokës tek një shtrojë e forte; i tillë edhe oxhaku i futur thellë në gropë, flakë pak, që lëshon dritë me ndërprerje, vetëm aty rrotull, sa për të shquar të domosdoshmen; njësoj edhe dy kamaret mbi oxhak, zgavra terri, dhe, "takimi" mes dy mysafirëve, dy qenieve planetësh të largëta, kurrë të parë, që stuhitë e natës pafund i bëjnë bashkë, në gjumë gjejnë njëri-tjetrin, në gjumë tretin në humbëtirë; dy udhëtarë pa emër, pa adresë, pa cak, pa zë, pa gjurmë që s'arrinë të shohin as fytyrën e njëri-tjetrit, pos vetëm gërhitjen apo ndonjë frazë jerm.. kaq, artikuluar polifoni që s'harrohet...

I ardhuri, digjet të zbrazet, t'i rrëfejë tjetrit diç nga collniku që sa s'po pëlcet, atij të shtrirë në krahun tjetër të oxhakut, me shpresë, bindje se ai edhe në gjumë dëgjon, regjistron; dhe vetëm gërhitje bashkëbisede, thurje e rrjedhës, kohë e hapësirë që s'ka fund, kohëhapësirë tejpërtej, këndej e andej; ndërsa, kurrë, as takim, as bisedë, as arritje, as nisje, as nga as ku...; thjeshtë një tregim për hanin njerëzor, të përjetshëm që të ndjell dehje përsiatëse, bredhje hapësirash planetare; për hanin, strehë takimi-mostakimi mes njeriut dhe njeriut, atij dhe zotit, pa mundur të gjejnë përgjigjen as nga dhe as për ku; njeriu enigma, i njohuri i panjohuri i përhershëm.....

Rruga e Arbërit nr. 178

libër i ri

Autori në këtë libër ka përshkruar luftërat e popullit dibran dhe atij shqiptar kundër serbëve dhe të gjithë pushtuesve...

"Mos ma prekni lumin tim", një rrëfim për luftërat, eksodet dhe epidemitë e viteve 1912 – 1920

Nga **AHMET PRENÇI**

Kur publicisti dhe studiuesi Sakip Cami ma besoi recensën e librit të tij "Mos ma prekni lumin tim", unë e lexova me shumë ëndje dorëshkrimin. Gjatë leximit mendja u arratis në udhëtimin e atyre viteve, 100 vite më parë dhe, kuptova se si disa ngjarje të historisë përsëriten, për fajin e shoqërisë, ose jo të saj.

Autori është ndodhur historikisht në buzë të lumit të Drinit të Zi. Ai është i lidhur pazgjidhshmërisht me historitë dhe kujtimet e këtij lumi. Që në titull ai ngre zërin ashtu si gjyshërit tanë që u ngritën dhe morën armët kundër Serbisë që donte të na pushtonte tokën tonë dhe të na grabiste lumin tone. Ky lumë dhe kjo tokë është vetë historia dhe jeta jonë.

Nëpërmjet një rrëfimi herë popullor, herë letrar e historik, autori në këtë libër ka përshkruar luftërat e popullit dibran dhe atij shqiptar kundër serbëve dhe të gjithë pushtuesve, luftën e parë ballkanike, luftën e dytë ballkanike, luftën e parë botërore, luftën e vitit 1920, luftë e gërshetuar me epidemitë dhe pandeminë botërore 1918 – 1920 si dhe me eksodet më të tmerrshme të dibranëve të qytetit të Dibrës së madhe drejt Tiranës, Elbasanit e Durrësit.

Ky rrëfim shtrihet në shtratin e një romani historik. Personazh kryesor në këtë vepër është populli me qëndresën e tij. Brenda këtij personazhi lartojnë majat e maleve dhe prijësit e krahinave të Dibrës, Lumës, Steblevës dhe më tej të Koplikut, Vlorës etj.

Ishin jo pak, por nandë vjet luftë me krajlët pushtues 1912 – 1921 derisa më në fund pushtuesit u zbrapsën matanë kufirit të vitit 1913. Lidhja e Kombeve pranoi Shqipërinë anëtare të saj. Në këto nandë vjet nuk mjaftoi vetëm pushtuesi, por u shfaq edhe flama, një flamë vrastare që në nivel botëror vrau miliona njerëz, edhe më shumë se lufta e parë botërore. Kur armiqtë e Shqipërisë nuk arritën ta mposhtnin popullin e Dibrës së madhe, e detyruan me forcë atë që të linte trojet në vitet 1913 dhe 1920 e të largohej, por përsëri nuk e mposhtën. Dibranët mbijetuan në Dibër dhe mbijetuan në Tiranë, bile edhe më të fortë dhe më vitalë.

Libri fillon me ngjarjet e nëntorit 1912, kur në Vlorë shpallej pavarësia ndërsa Dibrën e sulmoi Serbia. Dibra i kreu me suksese të dy detyrat ndaj atdheut; përcolli delegatët për në Vlorë dhe u vu përballë pushtuesit serb, duke mos e lejuar atë të merrte territore.

Na paraqitet mjaft interesante në libër,prit-ja nga dibranët e Mehmet Dërrallës dhe Isa Boletinit. Shoqërimi i tyre ishte një traditë e spikatur, një protokoll unikal, që për nga ana ushtarake do ta kishte zili çdo ushtri e polici dhe, për nga mikpritja e jashtëzakonshme njihet gjerësisht veçantia e Dibrës.

Përshkrimet për lumin e Drinit të Zi dhe të qytetit të Dibrës janë përshkrime që do i admironte çdo kineast që do të dëshironte të bënte një film epik të këtyre ngjarjeve.

Lufta në Lumë dhe në Dibër, na paraqitet e pandarë në libër, ashtu siç ka ndodhur në të vërtetë ku lumjanë e dibranë me heroizmin e vet epik kanë përballuar së bashku betejat heroike në mbrojtje të vatanit. Po kështu një vend të veçantë në këtë vepër zë vend lufta e Grykës së Vogël që ndodhi në dhjetor 1912 – janar 1913, zgjati 19 ditë dhe 19 net dhe na jepte përshkruar deri në detaje.

Me shumë rëndësi historike është lufta që dibranët zhvilluan në ndihmë të Shkodrës në



luftë me Malin e Zi. Gjashtë muaj luftime të viteve 1912 – 1913, na paraqitet një tjetër epope e lavdishme që autori, i mbështetur në gjurmimet historike dhe kumtin popullor e ka përshkruar në mënyrë të hollësishme.

Eksodi i viteve 1912 – 1913 i banorëve të qytetit të Dibrës së Madhe u shoqërua me dhunë masive nga serbët që pothuajse e zbrazën të gjithë qytetin. Kjo në këtë libër paraqitet me hollësi si një kronikë tragjike që shkrimtari Haki Stërmilli në shënimet e tij e ka përshkruan qytetin si një thertore njerëzish.

Libri trajton edhe tema të tjera si lufta për pushtet, vizitën e Esat Pashë Toptanit në Dibër në vitin 1914 dhe përcjelljen e tij andej nga kishte ardhur. Esati kërkonte ndihmë për të ardhur në pushtet, ndërsa populli i Dibrës përballej me zinë e bukës.

Viti 1915 përmbledh shumë vrasje politike të drejtuesve të luftës së popullit dibran si atë të Hoxhë Moglicës, që u varros për së gjalli duke thënë: "Në këtë vend ku unë po bi/ ka qenë, asht dhe do të jetë Shqipni." Vrasja e Mersim Demës, që njihej si mbreti i maleve edhe nga Princ Vidi, ishte një tjetër vrasje misterioze e kohës. Vrasja nga serbët e Elez Koçit, prijësit të Gollobordës sepse nuk u bindej atyre dhe mbronte tokën amtare ishte një tjetër ngjarje që tronditi lëvizjen atdhetare të kohës. Po në vitin 1915 vritet në pabesi Hoxhë Hazis Efendi Lila nga Stebleva, delegat i Kongresit të Manastirit dhe të Dibrës, i shkolluar në Francë, që kishte si devizë:"ta bëjmë popullin tonë më të pasur dhe më të lumtur njëlloj si kombet e qytetëruara" duke e dëshiruar atë si Franca ku edhe studioi.

Që të gjithë myslimanë e të krishterë, përpara se të jemi të tillë, jemi shqiptarë, deklaronte ortodoksi nga Klenja e Gollobordës Vasil Pleushku dhe transportonte abetaret që sillte nga Stambolli e Bukureshti Hazis Lila e Hasan Moglica. Sapo e diktuan serbo – bullgarët e vranë dhe ja zhdukën kufomën.

Libri është i ndarë edhe me ngjarje edhe me vitet e zhvillimit të tyre. Në vitin 1916 trajtohet lufta me bullgarët gjatë luftës së parë botërore si dhe lufta me kolerën. Në vitin 1917 austro – hungarezët apo nemcet siç i quante populli u përfshinë edhe ato në reprezalje të popullsisë saqë populli ka lënë shprehjen: "koha e nemces, mos ardhtë kurrë"

Ky rrëfim shtrihet në shtratin e një romani historik. Personazh kryesor në këtë vepër është populli me qëndresën e tij. Brenda këtij personazhi lartojnë majat e maleve dhe prijësit e krahinave të Dibrës, Lumës, Steblevës dhe më tej të Koplikut, Vlorës etj.

E veçanta e këtij libri është paraqitja edhe e luftërave të njëpasnjëshme, edhe e eksodeve e shpërnguljeve masive të zhvilluara, edhe e epidemive të zisë së bukës që ishin shoqëruese gjatë këtyre nandë viteve. Mbijetesa e popullit ka qenë dhe mbetet karakteristika kryesore e tij ndër breza

Viti 1918 është viti i mbarimit të luftës së parë botërore. Ato që la pa vrarë e zhdukur lufta, i zhduku një flamë vrastare, siç ishte gripi spanjoll. Autori tregon një ngjarje drithëruese të jetuar, ku gjyshes së tij i vdiqën shtatë fëmijët e saj brenda një jave ajo mbeti me duar në gji.

Edhe viti 1919 është vit lufte, pasi serbët nuk duan të largohen. Ata kanë vendosur karakollet e tyre brenda kufijve të vitit 1913 dhe kërkojnë të zotërojnë tre qafat, Qafë Buall, Qafë Murë dhe Qafë Mërkurth. Flama vrastare e gripit spanjoll vazhdon. Njëkohësisht vazhdon edhe eksodi i brendshëm nga fshatrat buzë kufirit, buzë Drinit të Zi për në thellësi në Katër Grykët e Dibrës.

Viti 1920 është viti i Shqipërisë në luftë. Lufton Vlora ndaj italianëve, Kopliku ndaj malaziasve dhe Dibra ndaj serbve. Në Dibër luftohet që nga Luma në Steblevë.

Në Dibër zhvillohet Kuvendi i Arrasit dhe dibranët marrin një vendim të rëndësishëm që të vetëçlirohen, që të luftojnë dhe t'i detyrojnë serbët që të zbrapsen nga trojet e tyre. Dhe kështu ndodhi. Luftëtarët dibranë të komanduar nga Elez Isufi dhe Isuf Xhelili i zbrapsën serbët tej kufirit. Në betejën e Salbastrës ra si hero Osman Paci, që e mbuloi me gjoksin e tij mitralozin armik. Shembuj të tillë ka edhe të tjerë. Heroizmi masiv nuk përshkruhet.

E veçanta e këtij libri është paraqitja edhe e luftërave të njëpasnjëshme, edhe e eksodeve e shpërnguljeve masive të zhvilluara, edhe e epidemive e zisë së bukës që ishin shoqëruese gjatë këtyre nandë viteve. Mbijetesa e popullit ka qenë dhe mbetet karakteristika kryesore e tij ndër breza dhe ky është edhe shqetësimi i autorit që këto përpjekje titanike të popullit tonë t'i transmetohen brezave të rinj. Kanë kaluar 100 vjet, por duken si 100 ditë për ata që nuk harrojnë. Të ecim përpara, por të mos e harrojmë të kaluarën tonë të lavdishme. Ky është mesazhi kryesor që transmeton ky libër me vlera letrare dhe historike.

Autori ka bërë një punë të jashtëzakonshme duke na sjellë në vëmendje udhëtimin titanik të të parëve, sakrificën dhe heroizmin, traditën dhe qëndresën heroike të paraardhësve tanë. Ky libër është një manual memoristik që duhet të lexohet nga secili dhe të zë një vend nderi në çdo bibliotekë.

TREGIME KANUNORE

JETA

Nga **XHAFER MARTINI**

Dy burra lidhën miqësi të ngushtë me njëri–tjetrin. Nuk kishin dhënë as kishin marrë, as gjak nuk kishin pirë. Ajo ishte një afri zemrash e shpirtërash, që është lidhja më e fortë. Njëri prej tyre, ai më i moshuari, u sëmurë rëndë. I ra "tak– fak", si thuhet. Ishte duke shetitur në bahçe, kur u këput dhe ra në tokë, sikur ta kishte prerë një shpatë e padukshme. Zuri dyshekun dhe nuk u ngrit më. E kuptoi se vdekjen e kishte afër, prandaj i çoi fjalë mikut. Ai, me ta marrë vesh, me vrap e në shtëpi të mikut.

– Më erdhi fundi, – tha i sëmuri. – Të thirra të të lë një amanet. Unë po vdes, por kjo ka për t'i ndodhur trupit tim, shpirti nuk ka për të vdekur, ai do të hyjë në një krijesë tjetër të Zotit, por që nuk do të jetë njeri. Jetova sa bëri emër Zoti. U kënaqa apo nuk u kënaqa me këtë jetë, për këtë nuk duhet folur, se kjo jetë është shumë e dashur. Njeriu, edhe sikur të jetojë midis thumbit dhe patkoit, nuk ngopet me jetë.

Si tha këto fjalë, u ngrit me mundim, duke u ndihmuar nga miku, dhe shkoi pranë dritares që vështronte nga bahçja me lloj – lloj drurësh frutorë. Ishte pranverë e vonë dhe vendi kishte një blerim të ndezur. Pemët kishin çelur të gjitha përnjëherë dhe kudo sundonte e bardha e kumbullave dhe e mollëve përzier me të verdhën e thanave dhe rozën e pjeshkëve.

– Shikon gjë në bahçe? – e pyeti i sëmuri mikun e vet.

– Një qen, – tha ai.

– Mbasi të vdes unë, ai qen do të bëjë pesë këlyshë. Njëri prej tyre do të jetë i zi dhe me pulla të bardha. Ky "Pullaliu" do të jem unë. Shpirti im tek ai do të hyjë. Mos më pyet nga e di. Këto gjëra duhen pranuar në mirëbesim. Ti ke detyrë, që, sa të lindë Pullaliu, ta vrasësh, se nuk dua të jetoj si qen. A ma jep fjalën se do ta bësh këtë?

– Do ta bëj, – tha prerë miku.

– Tashti je i lirë, or mik. Kaq qe amaneti. Mbas dy javësh do vish të më futësh në dhe.

Duke ecur rrugës për në shtëpi të vetë, miku i të sëmurit mendonte kështu: "Zoti nuk ta marrka shpirtin pa të marrë mendjen. I është rrënjosur se do të bëhet qen".

I sëmuri vdiq vërtet mbas dy javësh. Miku erdhi dhe qëndroi në mort deri në mbarim të ditës së tretë. Në shtëpi u harrua pas punëve dhe halleve të jetës. Amaneti që i pat lënë miku, nuk i doli nga mendja, por e quante marrëzi ... Po një ditë, ndërsa kalonte nëpër një livadh, i preu udhën si "me dashje" një qen me pesë këlysh përmbrapa. Njëri prej këlyshëve ishte krejt i zi dhe me pulla të bardha. Iu kujtua porosia e mikut të ngushtë dhe me vete tha se ai duhet të ishte "Pullaliu". Nxori thikën nga xhepi dhe po i afrohej ngadalë, me kujdes, Pullaliut. E kapi dhe, kur u mat t'i binte me thikë në zemër, Pullaliu i tha:

– Nuk ke të drejtë të ma marrësh jetën, prandaj hidhe atë thikë.

– Po a je filani ti? – e pyeti burri dhe i tregoi emrin e mikut të vetë.

– Po, po, bash ai jam.

– Më ke lënë amanet me të vra, po u bëre këlysh. Dhe ti je bërë këlysh.

– Nuk është kollaj me qenë mik besnik. Ti nuk e mbajte fjalën. Unë të pata thënë që Pullaliun ta vrasësh sapo të lindë. Në ato dy javët e para këlyshët nuk shikojnë dhe nuk e dinë ç'është jeta. Tani që i hapa sytë dhe pashë se sa e bukur është, dua të jetoj edhe si qen. Qentë e vështrojnë ndryshe jetën. Edhe për ta jeta qenka e dashur.

Miku futi thikën në xhep dhe iku në punë të vetë. "Dashka të jetojë edhe si qen!", mendoi.


analizë

Analiza e kompozicionit, gjuhës, stilit, mënyrave të ndryshme të procedimit artistik, veçorive të dhënies së personazheve etj., janë probleme që kritika letrare, po të ketë një të tillë, ka shumë për të thënë për prozën e këtij shkrimtari.

Kontribut në zhvillimin e novelistikës sonë

Nga **RAMAZAN BUCI**

Pas romanit "Kur vdiste Kanuni", shkrimtari dhe kulturologu shqiptar Xhafer Martini botoi vëllimin me novela. Këto novela të japin një kënaqësi të madhe kur i lexon. Po të shprehemi me gjuhën e popullit, do të thoshim se janë njera më e bukur se tjetra. Por, për mendimin tim, e pakrahasueshme me asnjë nga novelat e këtij vëllimi, një nga më të bukurat e letërsisë shqiptare, është ajo me titull "Korbin Kosta", që hap vëllimin. Ngjarja është e thjeshtë, por e shtjelluar shumë bukur, çdo gjë rrjedh natyrshëm, procedohet me thjeshtësi dhe vërtetësi, çka tregon se autori është një mjeshtër i madh i kompozicionit, ka ndjenjën e ruajtjes së masës, prandaj gjithçka që thonë e veprojnë personazhet e tij është e besueshme. Korbini është një djalosh i vogël, që nuk dihet se nga është dhe i kujt është. Ai, mbasi i vdiqën të dy prindërit, mbet në moshë fare të vogël në dorë të xhaxhallarëve, gratë e fëmijët e të cilëve e trajtonin keq. Për të shpëtuar nga ky keqtrajtim, ai ikën nga shtëpia, pa ndonjë drejtim të caktuar. Ec e ec dhe përfundon gjysmë i vdekur, në një fshat, pranë lokalit të Kosta Bregsanës dhe gruas së tij Lena, pleq të urtë dhe të mirë, por që Zoti nuk u ka dhënë fëmijë. Ata gëzohen që Zoti ua çoi si me porosi këtë djalë dhe e ushqejnë dhe e mbajnë sikur ta kishin pjellë të tyre. I rrethuar me ngrohtësi dhe dashuri, Korbini lulëzon si bari i ri në pranverë, lëshon shtat dhe bukuri dhe bëhet një djalosh shumë elegant që tërheq vëmendjen e të gjithëve. Ai ka flokë të kuq, shumë të bukur, që i lë të gjatë dhe ato i duken si krifë luani. Sytë i ka të kaltër, vështrimin të zgjuar dhe të ngulitur, herë me përkëdhelje dhe ëmbëlsi, herë me zymtësi dhe brengë. Në shikimin e tij, thotë autori, është edhe pëllumbi, edhe gjarpri, që alternohen sipas rastit dhe sipas rrethanave. Nuk ia fut kot autori kur nënvizon një gjë të tillë. Autori është edhe një studiues i thelluar dhe, siç duket, ka parasysh thënien e Martin Luter Kingut, që thotë: "Të kesh cilësinë e gjarpërit pa atë të pëllumbit, do të thotë të jesh i ftohtë, meskin dhe egosit; të kesh cilësinë e pëllumbit pa ato të gjarpit, do të thotë të jesh sentimental, anemik dhe i paqëndrueshëm": Autori i është përmbajtur kësaj linje në dhënien e personazhit të Korbinit. Korbini bëhet jo vetëm djalosh i bukur dhe elegant, por edhe i fortë, i qëndrueshëm, kurajoz, me vullnet të hekurt, me dëshirë për të ecur përpara. Ai e ngre ekonominë e Kosta Bregsanës jo vetë duke u kujdesur për lokalin, që e zgjeron dhe e pajis me të gjitha asortimentet, por mbjell edhe vreshta, ndërton kaiken për të lidhur dy krahinat që i ndante lumi, mbjell perime, rrit një kope me dhi dhe bëhet furnizuesi më i madh i qytetit me fruta, perime, mish, bimë mjekësore etj. Korbini karakterizohet nga një inteligjencë e jashtëzakonshme, mëson shpejt dhe nuk ka gjë që nuk kupton dhe nuk është në gjendje ta zgjidhë. Kosta Bregsana dhe Lena, që janë të lumtur me dhuratën e Zotit, duan ta bëjnë bir në shpirt, por kjo nuk është e lehtë dhe nuk varet prej tyre, sepse, sipas kanunit, Bregsanet që janë shumë, sa leshi qenit, i thonë që ai, meqë nuk i ka dhënë Zoti djalë, le të zgjedhë cilin djalë të dojë nga të gjithë Bregsanet dhe ta birësojë. Atë që e ka gjetur në rrugë, siç është Korbini, nuk ka të drejtë ta bëjë djalë në shpirt. Korbini, kur merr vesh brengën dhe hallin e Baba Kostës, siç i thërret, thotë t`ia lërë atij në dorë çështjet e birësimit dhe, me mjetet dhe marifetet që përdor, arrin t`i bind Bregsanet dhe bëhet djalë në shpirt i Kostës dhe i Lenës.



Pas romanit "Kur vdiste Kanuni", shkrimtari dhe kulturologu shqiptar Xhafer Martini botoi vëllimin me novela. Këto novela të japin një kënaqësi të madhe kur i lexon. Po të shprehemi me gjuhën e popullit, do të thoshim se janë njëra më e bukur se tjetra. Por, për mendimin tim, e pakrahasueshme me asnjë nga novelat e këtij vëllimi, një nga më të bukurat e letërsisë shqiptare, është ajo me titull "Korbin Kosta", që hap vëllimin. Ngjarja është e thjeshtë, por e shtjelluar shumë bukur, çdo gjë rrjedh natyrshëm, procedohet me thjeshtësi dhe vërtetësi, çka tregon se autori është një mjeshtër i madh i kompozicionit...

Kur gjithçka po shkonte mirë e bukur, kur Korbin Kosta Bregsana forcohej dhe zbukurohej, kur ekonomia e tyre merrte vetëm lart, ndodhi një ngjarje që u jep të gjithave rrokullimën...

Në një ditë të praruar vere, i pari i krahinës së Ndërmale, Verdin Kucbashi, shoqëruar nga trimat e tij dhe nga vajza Ujvara Kucbashi, me bukuri mahnitëse, rrugës për në qytet, ndalet për të pirë një kafe në lokalin e Kosta Bregsanës. I pret dhe u shërben Korbin Kosta, i bukur si një yll, me një dritë të praruar që buronte nga shpirti i tij. Ai i bëri kaq shumë përshtypje babait dhe të bijës sa ata u ndanë tepër të kënaqur dhe premtuan që, sa herë të bënin atë rrugë, do të kthenin dhe të pinin kafe në lokalin e tij, i cili ndrinte nga bukuria dhe pastërtia, si vetë i zoti.

Por Korbini që nga ajo ditë e humbi qetësinë. As nuk i hahej, as nuk i pihej, as vendi në vend nuk i rrihej. Shkoi në qytet mbas Ujvarës, por nuk mundi ta takonte. Mbas shumë përpjekjesh, mori vesh se ajo banonte në një vilë, në periferi të qytetit, rrethuar nga një bahçe e madhe me shumë pemë frutore dhe jofrutore, që nuk e linin as dritën e diellit për të depërtuar. Ai e takon Ujvarën në këtë bahçe, larg syve të njerëzve të tjerë...Se çfarë ndodh midis tyre, si rrjedh jeta e njërit dhe e tjetrit, si përfundon Korbini, nuk është mirë t`ia zbulojmë dhe t`ia tregojmë lexuesit. Për këtë duhet lexuar novela që të jep një kënaqësi të jashtëzakonshme. Novela lexohet me një frymë. Megjithëse ajo është e gjatë, mbi tetëdhjetë faqe, ti si lexues, ke frikë se po mbaron shpejt, se po të ikën nga dora. Të paktën këtë ndjenjë kam provuar unë, ndjenjë që nuk ma ka krijuar asnjë libër tjetër deri më sot.

Në novelën "Luna Kuna", tregohet dashuria e një beu të ri me shërbëtoren e shtëpisë së vet. Është një dashuri e thellë, e sinqertë, që nuk pyet për pengesa që krijohen nga hendeku klasor. Beu, nga ana e vetë, duke qenë edhe njeri i shkolluar, që ka parë botë me sy, nuk vuan nga këto paragjykime. Kështu, të paktën, shfaqet në fazën e parë të njohjes dhe të dashurisë së tij me Luna Kunën. Përkundrazi, Luna, megjithëse vajzë e re, pa përvojë jete, nuk i përgjigjet dashurisë së Kutulis beut, sepse ajo e di mirë se këto lloj dashurish nuk kanë kurrë fund të lumtur. Ajo i reziston shumë beut të bukur dhe të ditur, dhe, kur më në fund, edhe ajo fillon ta dashurojë, ky krisën dhe ikën nga shtëpia, i lodhur dhe i mërzitur nga jeta monotone në fshat. Luna Kuna vrapon pas tij, pa turp, ta kthejë nga rruga, duke i thënë se e dashuron. Ai, Kutulis beu, nuk kthen. E gënjen Lunën dhe i thotë se do të shkojë deri në qytet dhe në mbrëmje do të jetë aty, në shtëpi... Por ai kthehet mbas një viti...Tani Luna nuk është ajo që ka qenë. Ajo nuk mund t`i përgjigjet më dashurisë së Kutulis beut dhe jeta e saj përfundon në mënyrë tragjike. Kjo është si ngjarje, ose, më saktë, gjysma e saj, por rëndësi ka mënyra se si e ka dhënë atë autori, mënyra se si i alternon kohët, si i jep planet retrospektivë, si kalon nga e tashmja në të kaluarën dhe anasjelltas. Mbi të gjitha të bën për vete Luna Kuna, vajzë e thjeshtë, e varfër, por e bukur dhe me dinjitet. Ajo lartësohet duke rënë... Në fund fare, kur do të përfundojë në greminë, ajo ngrihet mbi të gjithë, mbi të gjithë shtresën e bejlerëve, edhe mbi më të mirin e tyre, Kutulis beun. Autori ka treguar shumë mjeshtri në dhënien me vërtetësi të njeriut të thjeshtë. Simpatia dhe dashuria e tij është për njeriun e thjeshtë, sadoqë asgjë nuk e bën hapur dhe në mënyrë deklarative. Autori ngrihet kundër moralit të kalbur dhe shtirjes. Ai kërkon të lulëzojë një rasat i ri njerëzor kur njeriu të mos vlerësohet nga prejardhja dhe nga pasuria, por nga cilësitë shpirtërore.


Tek novela "Bolsheviku i vogël" kemi po dashurinë e një të pasuri me një të varfër. Është dashuria e zotërisë me shërbëtoren, por që vështrohet nga një kënd krejt i ndryshëm. Bëhet fjalë për dashurinë e Elbës me Bep Koltranin. Bep Koltrani është i pasur, ai është pronar i një çifligu të madh. Ai është njeri i ditur dhe i kulturuar. Nuk ka prejardhje fisnike, por ka fisnikëri shpirtërore. Jeta e tij familjare është shumë e varfër, atë e ka martuar i ati me një vajzë beu, një bej shumë të fuqishëm, vetëm e vetëm për të forcuar pozitën shoqërore. Midis Bep Koltranit dhe Zonjës Kabashe, siç e quajnë gruan e tij, nuk ka lidhje shpirtërore. Zonja Kabashe ka mendjemadhësinë e klasës së bejlerëve të cilëve u përket. Ajo do që ta mbushë shtëpinë me shërbëtorë dhe shërbëtore, duke imituar të pasurit në vende të ndryshme të Evropës. Ajo e detyron të shoqin, Bepin, t`i gjejë një shërbëtorkë personale, që ta ujdisë dhe ta stolisë që të duket më e bukur se ç`është. Bepi e kundërshton një marrëzi të tillë, por, më në fund, detyrohet dhe ia gjen. Dhe shërbëtorka e re është një vajzë varfër, që, prej varfërisë, detyrohet ta lërë shkollën përgjysmë. Janë nga faqet më të bukura të novelës ato kur autori përshkruan udhëtimin e Bepit me shërbëtorkën për të shkuar në shtëpi. Rruga kalon brigjeve të lumit. Përshkrimet e natyrës janë me masë dhe shumë të bukura. Kudo ka harmoni dhe lumturi. Dy të rinjtë ecin në heshtje, ato sapo janë njohur. Nuk kanë ç`të thonë, për më tepër kur njëra është shërbëtorja dhe tjetri është zotëria. Po, megjithatë, thyhen klishetë, paragjykimet, thyhen të gjitha nga forca e dashurisë që buis ashtu në heshtje dhe rritet brenda tyre, pa e ndjerë, si rriten bimët dhe lulet. Autori, me gjithë se merret me përshkrimin e natyrës, tregon se harmonia dhe bukuria është tek këta, që ecin pranë njeri-tjetrit me një simpati të ndërsjellë, me një dirë që buron nga shpirtrat e të dyve. Autori di të zgjojë parandjenja. Ai e vë fantazinë e lexuesit në lëvizje. Ai e gjallëron përfytyrimin e lexuesit. Ky udhëtim, i dy njerëzve që sapo janë njohur, është diçka e thjeshtë, shumë e zakonshme në dukje. Por ka brenda tharmin e një gjëje të madhe. Kur Bepi shkon afër shtëpisë, shoqëruar nga Elba, shërbëtorë e shërbëtore, kush është gjallë në atë shtëpi, dalin për ta parë bukuroshen e re që afrohet me atë hapin sikur vallëzon. Vetëm zonja Kabashe që e ka kërkuar me aq ngulm, mbyllet në odën e saj dhe nuk del për ta parë. Për kë e more ti këtë?- e pyet ajo të shoqin, Bepin. Ai vë buzën në gaz me një ironi të lehtë dhe të hollë dhe i thotë se ajo ishte shërbëtorja e saj...Përse e quajnë dhe kush e quan Bep Koltranin "Bolesheviku i Vogël", si do të jenë marrëdhëniet e tij me të shoqen dhe rrethin e tij, si do të jenë marrëdhëniet e zonjës Kabashe me Elbën, shërbëtoren personale? Si do të jenë marrëdhënien e Bepit me Elbën? Si do të jetë fundi i tyre? Këtyre pyetjeve u përgjigjet novela, por gjithmonë në mënyrë shumë artistike, në mënyrë shumë të natyrshme.

Një novelë e bukur, që të sjellë kënaqësi është edhe "Balada e Drenushës". Jemi në vitin e fundit të sistemit diktatorial. Ai po shembet. Kjo ka filluar herët, por nuk ka qenë e dukshme për sytë e të gjithëve. Shkrimtari merret me një grup të vogël turistësh që vinë në vendin tonë për t`u ngjitur në male. Ata kanë nevojë për një shoqërues dhe për një përkthyes. Ua gjejnë dhe, më në fund, grupi i vogël, niset. Por nuk ngjiten dot në mal, se u del një pengesë tjetër...Një drenushë e sëmurë, që ka thyer këmbën...Drenusha bëhet, si të thuash, një personazh interesant. Rreth saj bashkohen dhe ndahen njerëzit. Dalin në pah botëkuptimet, interesat, prirjet, idealet, formimi shpirtëror i secilit. Drenusha bëhet, si të thuash, guri i provës për të gjithë personazhet e tjerë, që ndeshen me ashpërsi dhe egërsi...Duhet të jesh mjeshtër, që të japësh ndeshjen e dy botëve duke pasur parasysh vetëm një kafshë të sëmurë, e cila ngrihet në simbol... Një novelë tjetër është... Por ç`t`i përmendim të gjitha. Një shkrim kritik nuk ka një qëllim të analizojë secilën prej tyre, por të tregojë mënyrën e procedimit artistik të shkrimtarit.

Ky shkrim i imi është më shumë një shfaqje entuziazmi që buron nga leximi i parë i një libri të mirë. Duhet një lexim i dytë dhe thellim në prozën e këtij autori për të nxjerrë gjithë ato vlera dhe cilësi pozitive që mbart. Xhafer Martini është nga shkrimtarët e moshuar që sa vjen e bëhet më i ri në kuptimin jo vetëm të prodhimtarisë së madhe, por, në radhë të parë, për vlerat artistike që sjell. Analiza e kompozicionit, gjuhës, stilit, mënyrave të ndryshme të procedimit artistik, veçorive të dhënies së personazheve etj., janë probleme që kritika letrare, po të ketë një të tillë, ka shumë për të thënë për prozën e këtij shkrimtari.

Marrë nga libri "Përballë sfidave të kohës", botim i vitit 2019

Panoramë e historisë së Rremullit dhe të Matit, nga lashtësia deri më sot



Nga **QAZIM D. SHEHU**

Në bisedat e herëpas'hershme me Bajram Canametin, midis të tjerave, binte fjala për historinë dhe të kaluarën, prerjet e saj kohore dhe integritetin perms vazhdimësisë së saj. Bajrami shpjegonte me pasion këtë lidhje dhe me ekzaktësi fliste për njerëz, ngjarje, të cilat mbanin brenda një sharm trimëror dhe romantik.

Ai, me një kujtesë të admiruar, mbante mend emra të pafundmë nga fise të ndryshme, duke dhënë detaje të hollësishme për 'to e këto detaje ishin aq mbresëlënëse, sa shpesh arrin deri te bërthama e një poezie. Ky studiues i zellshëm, ca i njihte e për të tjerët kishte lexuar e sillte fakte të pakundërshtueshme. Kështu, bisedat bëheshin të këndshme, sugjestionuese. Ndenja bashkë me një njeri të rëndësishëm është gjithnjë një përfitim.

Bajrami, poet, studiues, publicist dhe njeri i kulturës, vjen me këtë libër me një prezantim dinjitoz, ku bie në sy faktologjia e pasur dhe interpretimi i besueshëm. Për të ardhur këtu, atij i është dashur një rrugë e gjatë, e mundimshme, por pasionante dhe mbresëlënëse.

Bajram Canameti i përket racës së atyre krijuesve që janë të heshtur e modestë, por që flasin me mirësinë e veprës së tyre, gjithnjë të mbrujtur nga dashuria për të vërtetën dhe për njerëzit, të përkushtuar ndaj leximit dhe dijes, duke sjellë një botëkuptim, si adhurim ndaj historisë dhe vlerave të trashëguara në shekuj.

Kjo është fryma që tejçohet fund e krye në këtë libër të ri, impresionues dhe ngulmues, pretencioz, për të shkuar gjer në thellësi të kohërave e shekujve dhe për të zbuluar tokën e begatë ku ushqehen këto rrënjë të identitetit dhe të rritjes, pavarësisht nga stuhitë që kanë shfryrë pezm e vrulle idhnake për ta gërryer këtë tokë.

Besimi se e kaluara e lavdishme e të parëve ende kërkon punë për ta zbuluar, se, sado të thuhen gjërat nga autorët e tjerë, ende mbetet për t`u thënë, e ka shtyrë Canametin të kërkojë dhe të rendisë gjithë ato fakte e të konkludojë në domethënie të forta, jashtë çdo mitizimi e panegjirizmi fals, sa për modë.

Duke ndjekur traditën e historianëve tanë, ai shkruan një histori totale për Rremullin, analizon lashtësinë, jetën historike, shoqërore-kulturore të kësaj krahine, duke vendosur në lupën e tij çdo gjë, jo nga frika se mund t`i shpëtojë, por se duhet thënë dhe se e di dhe përderisa e di (si rezultat i studimit), nuk ngurron ta thotë. Kjo traditë hijeshohet dhe merr vlerë te Bajrami, për të vijuar me faktin tjetër mbresëlënës se ai është kushëri i Arif Matit, (Matje Aref), profesorit të shquar në Francë, i cili bëri lidhjen shkencore nga pellazgët te shqiptarët.

Librin e tij, ku përzihen disa zhanre, (mund ta quajmë studim, disertacion për titull, monografi, poezi, rrëfimtarí e lirë, ngjyrosur me intonime poetike, një tërësi subjektesh të denja për ta zgjeruar frymëmarrjen në zinxhirë episodikë për novela e romane) mund ta kundrojmë pikë së pari si një manifest të shpirtit njerëzor, një dëshmi e kujtesës, nga zotësia për ta çprangosur nga harrimi historinë.

Rremulli është një fshat i pashkëputur nga Mati, nga historia e moçme e kësaj treve, rëndësia e së cilës nuk është e pakët, sepse në atë zonë lindi Principata e Arbërit, aty janë zhvilluar kuvende me rëndësi si: Kuvendi i Dukagjinit dhe i Lisit, aty është lindur heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti dhe, duke shfrytëzuar të dhëna nga Sami Frashëri dhe Hahn, Bajrami përmend një sërë qytetetsh që u ngritën, lulëzuan dhe u shkatërruan, si rezultat i luftrave me pushtuesin e huaj si: qyteti i Xibrit, Shkopetit, Komsisë, Albanoi, Laç-Bruçit, Lisit etj. E gjithë kjo përmendje nuk është pa rëndësi, sepse ajo dëshmon nervin qytetërues dhe zhvillimin urbanizues të kësaj treve.

Duke e parë Rremullin si vrullim malli dhe dëshmi krenarie, Bajram Canameti tenton dhe ia arrin me suksese të ndalet tek emri i tij, për të shpjeguar se nga vjen ky emër. Ai shpjegon se Romuli vinte nga komuniteti Alban, nga fisi Fugasi... Kjo natyrisht nuk është trill, po një e vërtetë historike se, nganjëherë, përkimi i emrave nuk është rastësi. Si vis arbëror, ai shpjegon rolin e tij si periferi, i lidhur me qendrat imperatorake të kohës, lidhjet e shumta, lëvizjet etj, duke përdorur teorinë e hulumtimit si model analizues përmes faktit. Autori e shtrin metodën e tij në bindjen vetëm përmes faktit dhe të referimeve historike, duke u përqëndruar në hapësirën e Remullit, më tepër si rrafsh historik dhe duke e përcjellë dinamikën e historisë në fushën e një debati, i cili sido që të hapet, i jep të drejtë autorit, varësisht prej referencave dhe faktologjisë, në kufinjtë e së vërtetës së pamohueshme.

Përcjellës i vemendshëm i kësaj dinamike historike, që përvijohet nga ngjarjet kulmore e ato që vijnë si plotësim i tyre, që nga njerëzit e rëndësishëm dhe figurat me peshë e deri te të zakonshmit, autori përmend një tërësi emrash, duke filluar nga mbretërit ilirë, figurat e Remullit, udhëheqësit e kryengritjeve për liri, Pleq e kadillarë e deri te njerëzit që patën pozita kyçe në Perandorinë Osmane, për të ardhur pastaj te fiset e Remullit si fiset Pepa, Stana, Bajlika, Rizvani, Përlekajt, Dervishajt, Hoxha, Palluçi, Ruka, Stafajt, Likajt, Shehu, Canameti etj, fise të përmendura, ku shquan tradita e atdhedashurisë, mikpritjes, dashurisë për jetën dhe shqiptarizimi i kulluar në ruajtjen e këtyre traditave. Autori shpjegon hollësisht origjinën e tyre, disa të ardhur nga Kelmendi, Dibra, Kosova, por dhe Gramshi, për arsye të ndryshme, por që gjetën në Rremull tokën e begatë të mirëseardhjes dhe të besës, çka flet për një hapësirë me dritën e bujarisë të shpirtit rremullak.

Këto fise, të dalluar nga njëri-tjetri, por absolutisht të përbashkët në fatin e tyre, përbëjnë atë kor historik, që përcjell frymën e kombit, ku fati dramatik u caktoi të mbanin në dorë më tepër shpatën sesa plugun, e megjithatë kurrë nuk u mungoi dashuria për punën, dijen, dritën, arsimin dhe prirjen e vazhdueshme perëndimore, në përkrahje të vlerave të larta të qytetërimit. Janë pikërisht këto fise, me pleqnarët dhe kuvendarët e tyre, që ngritën çetat e para antiosmane, që morën pjesë në luftën e Gjallishit më 1875, në Lidhjen e Prizrenit më 1878, apo në Kuvendin e Suçit më 1908, në luftën e Shkallës së Deshëve më 1913 dhe në betejen e Kakarriqit, për të ardhur pastaj në Shpalljen e Pavarësisë e deri te kryengritjet kundër garnizonit fashist në luftën e dytë botërore, sepse, siç pohon autori: "Për atdhe Rremulli çohej në këmbë me krahë vetëtimash, me rrufetë e zjarrta të qëndresës".

Përmes një qasjeje reale, Bajrami sjell emrat një për një të tyre, figurat më të rëndësishme, dëshmorët dhe luftëtarët e lirisë, origjinën e këtyre fiseve dhe kontributin e tyre jo të pakët në jetësimin e çeshtjes kombëtare.

Këtë qasje ai e bën me fluksin e informimit, po dhe të nënvizimit të atyre aspekteve që i bëjnë këto fise të ndihen të pasqyruara denjësisht në penën e studiuesit. Ai përmend figura të shquara të historisë kombëtare me origjinë nga Rremulli, si Gjergj Kuka, gjeneral i Skënderbeut; Gjon Gjergji, pjesëmarrës në Kuvendin e Dukagjinit; po nga Rremulli, Mehmet Hysen e Musafa Pasha, rremullakë; Mehmet Hyseni, valí, me origjinë nga fisi Canameti, Mehmet Aliu, themelues i dinastisë së Egjiptit, edhe ky rremullak, si dhe dinastia Gjika në Moldavi e Vllahi, me origjinë nga Macukulli dhe Dervish Hima me origjinë nga Klosi.

Duke e parë historinë si burim i vitalitetit të njeriut që mbart vlera të caktuara të qëndresës dhe të dashurisë për liri, Canameti arrin të na imponohet përmes një proze sa informuese aq edhe reflektive në shpalosjen e këtyre vlerave.

Argumenti njerëzor është argument më i pamohueshëm që e dëshmon këtë vitalitet dhe nga kjo premisë është nisur autori për të ndërtuar metodën e vet të pasqyrimit dhe të analizës. Zona e Remullit ka qenë një zonë tensionesh, jashtë çdo konflikti imagjinar, dhe ky tension ka ardhë për shkak të rrethanave ngushtuese historike, të imponuara nga dyndjet pushtuese dhe kërcënuese, që kanë dashur ta zhbëjnë etnitetin vendas të këtyre banorëve. Në kohëra të reja, edhe Rremulli u përfshi në proceset e tyre social-politike, kulturore, duke dëshmuar dashurinë për arsimin dhe kulturën.

Nga ky fshat i lashtë i Rremullit dolën mjaft kuadro drejtues: kryetarë bashkie, inxhinierë, mësues, sa, një familje (Canameti) kishte dhjetë mësues), poetë, artistë, ndër të cilët, mund të përmendim Esat Rukën, këngëtar i shquar, muzikolog; piktorin Tahir Tahiri, Van Gogun e peizazheve veriore; Ali Shehin, piktor, e të tjerë e të tjerë.

Por pas çlirimit, edhe në Rremull veproi kosorja e luftës së klasave, përçarja ideologjike si shafran lindor, e cila, megjithatë nuk mundi ta zhbënte burrërinë dhe genin ilirik të këtyre malësorëve të lirë, ndonëse solli dëme. Fiset fisnike të Matit, në përgjithësi, dhe të Rremullit, ditën ta ruajnë dinjitetin dhe të shpresonin te liria, e cila kishte qenë gjithnjë për 'ta një thirrje shekujsh që vinte si kushtrim gjenetik i të parëve.

Autori Canameti bën gjithashtu një përshkrim të shtrirjes së Rremullit, si një guiditim i arrirë gjeografik, duke shpalosur bukuritë natyrore të fshatit, po njëherit me nuancat e poetizimit të përshkrimit nuk i kalon kufinjtë e saktësisë dhe rri brenda tyre, pa shkuar në mjegullim poetizues. Si gjithnjë, brenda natyrës së tekstit studimor, edhe këtu asgjë nuk humbet nga saktësia dhe të bëjnë përshtypje toponimet, emrat e vendeve, të cilat, në shqiptimin e tyre, mbartin lashtësi e dëshmojnë emërtesat krejt shqip, që vijnë nga moçmëria e rrjedhës së tyre gojë më gojë, me ndonjë përjashtim. Kjo është një tjetër tregues i qëndresës etno-kulturore dhe i përcjelljes së tyre në kujtesën popullore për të mbetur ashtu, thjesht shqipe.

Edhe pse mikrotoponimia në Shqipëri ka qenë e rrezikuar nga emërtesat sllave, si rezultat i dyndjeve dhe invazioneve që dihen, në periudha të mugëta në histori, në Rremull vjen fakti i gëzueshëm, për të thënë se ato janë të pandjeshme, dëshmi e fortë e artikulimit shqiptarisht të emërtimeve gojë pas goje. Sheshi i Shën-Pjetrit, Kisha e Shën-Pjetrit, Arat nën Kishë, Nën Kisha, Kisha e Shën-Vlashit, Shën-Gjoni, Kodra e Shën-Gjergjit, Kisha e Shën-Gjergjit, Shën-Marku, Kodra e Shën-Markut, disa toponime që dëshmojnë katolicizmin e hershëm dhe toponime të tjera për emra njerëzish të ndryshëm.

Viset arbërore të Rremullit e të Matit jepen nga autori me një vështrim të kujdeshëm dhe të pasuruar me informacion bindës, deri shterues, çka tregon se autorit i është dashur punë e gjatë, e kujdeshme dhe rigoroze, duke na sjellë një panoramë të plotë që identifikohet dhe përmasohet perms një rrëfimi plot dashuri për vendlindjen, e cila nuk mund të mjaftonte, pa kompetencën dhe zotësinë autoriale. Si shkrimtar e poet që është, Bajrami nuk mund të rrijë pa përmendur edhe detaje që vijnë nga episode mbresëlënëse, siç është ai i Tahir Tahirit me Et`hem Barhamin, personalitet i kohës. Futja e episodeve me vlerë emocinuese si shenjë e kohës dhe e shpirtit njerëzor, i jep librit një timbër artistik, krijon një farë pauze dhe çlodhje leximore, pas analizave shkencore që kërkojnë vemendje dhe intesitet të saj.

Autori bën një ndërlidhje konceptuale midis kohës dhe njeriut, një raport i përcaktuar nga rrethana të ndryshme, herë të favorshme, herë jo. Dhe patjetër, nga ky raport, vjen natyrshëm edhe mesazhi bindës se, në këtë vendosje, trinomi krenari, qëndresë, vazhdimësi të pashkëputshme, është ai çelësi emblematik që ka hapur dyert e jetës për rremullakët dhe rri vetëm në këto përmasa. Në asnjë rresht, dhe pse përshkruhen momente të zymta, nuk ndihet apostrofa e pikëllimit apo e zhgënjimit, përkundrazi, tregohet në dritë të diellit gjallëria e jetës, e përshkuar nga limfa e patriotizmit dhe e qenësisë.

Libri i Bajram Canametit edhe pse ndahet në pjesë, funksionon në shijen e leximit si i tërë, sepse është shkruar me vetëdije shkencore, letrare, gjuhësore, artistike, në respekt të Remullit, të Matit, të traditave, të historisë, të burrave të mirë me vlera. Është një libër që krijon hapësira të gjera të pasqyrimit dhe njëkohësisht këto hapësira ai i shpalos dhe u heq mjegullën e kohërave, në saj të zotësisë së tij, larg të qenit i anshëm në pasqyrim, por i hapur, duke e parë Rremullin si pjesë të historisë së Matit, Matin si pjesë të historisë kombëtare dhe jo rrallë si promotor e zhvillues i ngjarjeve të mëdha me peshë për fatet e kombit. Në kuptimin shkencor, historik e narratorologjik të fjalës, autori i ndërton mirë tonalitetet e stilit të tij, që vijnë e rrjedhin nga një mendje e ditur dhe e një shpirti të pastër. Shpesh poezitë e tij, po edhe të poetëve të tjerë, të pasqyruara në libër, sjellin gjithashtu kumte të reja dhe përforcojnë idetë e shkulmojnë artistiksht rrjedhën rrëfimore të autorit Bajram Canameti.

Si përfundim, mund të themi se libri i Bajramit lexohet me një frymë dhe aty mëson mjaft për historinë, për figura (ca të lëna padrejtësisht në harrresë) dhe në morinë e librave monografikë, zë një vend të nderuar në radhët e para të tyre, që mund të merret si model i thellimit në një çështje, para se ta shkruash atë, duke mbajtur si devizë porosinë e Konicës së madh.

vlerësim

“Mjeshtër i madh”, *titull i merituar* për Muharrem Gjokën

Nga **Halil RAMA**

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta ka dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”, zotin Muharrem Gjoka, president i Ansamblit Artistik “Hazis Ndreu” - “Nderi i Kombit”. Vetë motivacioni që mban dekorata: “Në vlerësim të veprimtarisë dhe mbështetjes së shumanshme në lartësimin e kulturës kombëtare, vlerave atdhetare, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare, veçanërisht asaj dibrane, si dhe të kontributit të veçantë në zhvillimin dhe përparimin e vendit”, është vlerësimi më objektiv i rolit të këtij personaliteti dibran. Në fjalën e tij, kreu i shtetit do të vlerësonte se: “Prej vitesh pranë këtij grupimi artistik, si një dorë e ngrohtë, inkurajuese dhe mbështetëse, është një emër, i cili e nisi jetën e tij artistike si një talent i skenës dhe i valles dibrane dhe sot është president i këtij ansambli, ish-valltari virtuoz, një burrë Dardhe dhe Dibre, i vlerësuar edhe me Titullin ‘Nderi i Qarkut Dibër’, zoti Muharrem Gjoka. Roli i tij është i padiskutueshëm si artist dhe si njeri me zemër të madhe, me një kontribut më shumë se 50-vjeçar, duke gëzuar respektin e merituar në shoqëri, edhe si një humanist”.

Muharrem Gjokën, si mishërues dhe përçues i fjalës së mençur dibrane u “diplomua” në kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në “Universitetin e Dibrës”, leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendet dibrane....

Muharremi lindi në vitet e luftës, në Zall Dardhë, Dibër më 16 qershor të vitit 1943. Kaloji një fëmijëri të vështirë, por kjo e bëri më të fortë dhe të vetëdijshëm për të çarë rrugët e jetës.

Që në vitet e rinisë së tij u inkuadrua në kantierët e ndërtimit të rrugëve, fillimisht në Kurbnesh dhe më pas në Skuraj, duke afirmuar cilësi të jashtëzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë.

Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej këtu dhe mbrojtja e Atdheut e kërkon në Bilishtin e largët, në kufirin me Greqinë. Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, duke lënë gjurmët e mira të një patrioti të guximshëm dhe të një ushtari e djali të mirë.

Sërish pas shërbimit ushtarak në kantieret e ndërtimit, nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Reps, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Haprripe etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin e mirë, duke fituar një personalitet të padiskutueshëm.

Veçanërisht aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese spikatën në vitet 1965-1955 në ndërtimin në një kohë rekord të rrugës Qafë Bari – Fierzë dhe në vitin 1972 për asfaltimin e rrugës nacionale Peshkopi-Bulqizë.





Kreu i shtetit vlerësoi gjithashtu me Titullin “Naim Frashëri” Ansamblin Artistik “Hazis Ndreu”, me motivacionin: “Për veprimtarinë e shquar në mbartjen, ruajtjen dhe përsosjen e traditave, folklorit dhe trashëgimisë së çmuar etnokulturore të trevës së Dibrës. Me mirënjohje për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që ka shpalosur në skenat shqiptare dhe të huaja këngët dhe vallet tradicionale, veshjet koreografike si dhe melodité e pasura burimore të shumë brezave dibranë.”

Më pas, cilësitë e tij dhe vrulli i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejës, madje aty kreu edhe studimet e shkollës së mesme në teknikumin e ndërtimit, duke rritur më shumë nivelin e tij jo vetëm profesional, por edhe intelektual.

Tashmë shkollimi i jep mundësinë që të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qenë edhe drejtuesi i transportit. Jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit, etj.

Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontribuojë për shumë vite. Këtu kryen edhe shkollën ekonomike, çka i mundësoi ngjitje ne shkallët e karrierës deri Shef i Transportit të Ndërmarrjes së Asfaltimit që mbulonte gjithë Veriun e Shqipërisë.

Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, Rruga Ura u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002. Dy vjet më pas, pra në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë s’e ndali atë në vrullin e përjetshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes, vendlindjes dhe Shqipërisë.

Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar, që përmes punës fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend te merituar në shoqëri dhe komunitet.

Prej më shumë se dhjetë vitesh Muharrem Gjoka kryen funksionin e Presidentit të Grupit Artistik “Folk Alb Hazis Ndreu”, i cili ka konkurruar dhe fituar çmime të para në festivale ndërkombëtare si në Ulqin, Tetovë e Prishtinë. Po ashtu, që nga Kuvendi i shtatë i OBVL është zgjedhur Nënkryetar i kësaj organizate, funksion të cilin e kryen me përkushtim të rrallë.

Aktiviteti i tij i mësipërm është vlerësuar me Certifikatë Nderi nga Shoqata Kombëtare e Miqësisë dhe Bashkëpunimit Shqipëri-Itali; me Mirënjohje nga Qendra për Kulturë në Ulqin; me Certifikatë Mirënjohje nga Ansambli Artistik “Kuvendi” Zall Dardhë, si dhe me Titullin “AMBASADOR I PAQES” nga Federata e Paqes Universale.

Me Vendimin Nr.03, datë 24.03.2021, Këshilli i Qarkut Dibër i ka dhënë Z.Muharrem Gjoka Titullin “NDERI I QARKUT DIBER”, me motivacionin: “Për për mbajtjen gjallë të vlerave etnokulturore, për kontributin e çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, dhe si ish-drejtues në fushën e ndërtimeve dhe infrastrukturës rrugore në gjithë vendin”. Pas gjithë këtyre titujve dhe vlerësimeve ai thotë se dekorimi nga Presidenti Meta me Titullin “Mjeshtër i Madh”, atë dhe Familjen e tij i bën më krenarë se kurrë.

“Talenti i Avni Ndreut, si koreograf, valltar e poet si dhe aftësitë e tij artistike organizuese i kanë dhënë ansamblit ‘Hazis Ndreu’ një emër të madh në botën e kulturës shqiptare dhe përtej saj, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë.”

Kreu i shtetit vlerësoi gjithashtu me Titullin “Naim Frashëri” Ansamblin Artistik “Hazis Ndreu”, me motivacionin: “Për veprimtarinë e shquar në mbartjen, ruajtjen dhe përsosjen e traditave, folklorit dhe trashëgimisë së çmuar etnokulturore të trevës së Dibrës. Me mirënjohje për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që ka shpalosur në skenat shqiptare dhe të huaja këngët dhe vallet tradicionale, veshjet koreografike si dhe melodité e pasura burimore të shumë brezave dibranë.”

Presidenti Meta dekoroi me titullin “Mjeshtër i Madh” edhe Avni Ndreun i cili është nderi i kulturës dibrane dhe qytetar nderi i Dibrës dhe prej shumë dekadash në krye të këtij ansambli, duke mbajtur gjallë dhe duke transmetuar sidomos tek brezat më të rinj, cilësi dhe vlera artistike të shumta.

“Në Dardhë dhe në Dibër, mbetet i papërsëritshmi ‘Nderi i Kombit’, Hazis Ndreu, emri i të cilit është gdhendur edhe sot, jo vetëm në kujtesën e secilit prej nesh, por edhe në ansamblin artistik që mban emrin e tij të madh dhe që drejtohet nga i biri, një krijues shumë i talentuar dhe koreograf i përmasave kombëtare, si Avni Ndreu”, - tha Presidenti Meta. Për kreun e shtetit “Talenti i Avni Ndreut, si koreograf, valltar e poet si dhe aftësitë e tij artistike organizuese i kanë dhënë ansamblit ‘Hazis Ndreu’ një emër të madh në botën e kulturës shqiptare dhe përtej saj, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë.”





Personaliteti i Hafiz Xhemalit reflektonte dhe në pamjen e tij të jashtme. Thjeshtësia e tij shoqërohej me pastërtinë dhe elegancën. Stili i veshjes me hijeshi ishte shembull që edukonte.

Personaliteti i **Hafiz Xhemal Mullait**

Nga prof.dr. **XHEMAL BALLA**

Është e bukur që në këto ditë aktiviteti përkujtimor të kujtosh ato vite të bukura mësimi plot nostalgji me mësuesin e nderuar të Kuranit Hafiz Xhemalin. Në vitet e shkollimit në Medresenëë e Tiranës, orët e mësimit më mbresëlënëse ishin ato me mësues Hafiz Xhemal Mullai. Momentet mësimore që kalova më të, kanë qenë e kanë mbetur vazhdimisht pjesë e jetës time, kuptimi i punës dhe i ndjesive të mia, që edhe sot i kujtoj me dashuri, mallëngjim e respekt.

Ka kaluar një kohë e gjatë prej 65 vitesh, të shkëputur nga orët mësimore prej tij, por duke u vënë sot në rolin e nxënësit, shpreh respekt të veçantë për këtë mësues që ma bëri të dashur Kuranin në zemrën time. Falë tij, unë kuptova se vërtet mund të sjell diçka të bukur në mënyrën e të kënduarit të Kuranit. Nuk mund të harroj kënaqësinë që më fali në vitet e mukabeles si Hafiz në xhaminë e Pazarit të Ri (Kokonozi) për katër vite me rradhë mbresa të cilat janë të gjalla edhe sot.

I veçantë do të mbetet për mua kursi i specializimit në Universitetin El-Az-Harit në Kajro të Egjiptit, kur isha mësues në Medresenë e Tiranës, me rihapjen e saj kur erdhi në pushtet demokracia. Ishte viti 1993, në provimin e Kuranit dallohem më i miri në tërë grupin e specializimit. Doktori i Kuranit në mes të auditurës më tha: "Cili doktor t'a ka mësuar Kuranin?" Unë ju përgjigja: "E kam mësuar nga doktor Hafiz Xhemal Mullai". Kur doktori u foli të pranishëmve për jetën, aktivitetin dhe personalitetin e Hafiz Xhemalit, kjo ishte krenaria më e madhe për mua. Sepse përpara meje ka qëndruar një personalitet, që me potencialin e tij në fushën e Kuranit më ka mësuar dhe imponuar respektin dhe kulturën e të kënduarit të Kuranit. Hafiz Xhemali ishte një personalitet i mirëinformuar me një kulturë poliedrike, me imagjinatë të lartë, me ndjeshmëri dhe vizion për mësimin e Kuranit, e veçanërisht për memorizimin e tij.

Ora e mësimit me Hafiz Xhemalin, paraqitej si një orë shpirtërore, ku të gjithë japin e marrin nga njeri tjetri, sepse në krye qëndronte specialisti mësimdhënës, që menaxhonte në mënyrë të harmonizuar të gjitha hallkat e mësimdhënies. Sjellja e tij i jepte autoritetin e mësuesisë në përmbushjen e misionit edukativnë shkollë dhe si qytetar jashtë saj.

Hafiz Xhemali ishte një personalitet me virtyte e cilësi shpirtërore që rrezatonte energji e gjallëri, dhe me këtë sfidonte dhe moshën e tij. Mësimi i tij ishte i shenjtë sepse përçonte tek nxënësit me saktësi mesazhin Hyjnor. Me përkushtimin e tij në orën e mësimit ai ishta konkret, praktik dhe i drejtpërdrejtë. Nuk i ndante aftësitë e tij të mësimdhënies me ato edukative dhe për këtë kishte futuar nderin, prestigjin dhe dinjitetin e autoritetin personal. Ishte shembull pozitiv për nxënësit, i paanshëm dhe objektiv, i drejtë dhe real në rraport me kërkesat ndaj nxënësve. Me ne ai përfaqësonte mirësinë, dashurinë, harmoninë, respektin, mirësjelljen dhe optimizmin. Nuk u dëshpërua asnjëherë dhe nuk e humbi shpresën me nxënësit që paraqisnin dobësi, por punoi me zell e dashuri me ta. Ishte këmbëngulës e i aftë për të qenë gjithmonë i arsyeshëm dhe i matur në veprime me nxënësit.

Personaliteti i Hafiz Xhemalit reflektonte dhe në pamjen e tij të jashtme. Thjeshtësia e tij shoqërohej me pastërtinë dhe elegancën. Stili i veshjes me hijeshi ishte shembull që edukonte. Reflektonte vlera të mirëfillta njerzore, sepse u përpoq të kultivojë tek nxënësit humanizmin dhe solidaritetin që janë pjesë e domosdoshme e karakterit të një besim-



Hafiz Xhemali ishte një personalitet me virtyte e cilësi shpirtërore që rrezatonte energji e gjallëri, dhe me këtë sfidonte dhe moshën e tij. Mësimi i tij ishte i shenjtë sepse përçonte tek nxënësit me saktësi mesazhin Hyjnor. Me përkushtimin e tij në orën e mësimit ai ishta konkret, praktik dhe i drejtpërdrejtë. Nuk i ndante aftësitë e tij të mësimdhënies me ato edukative dhe për këtë kishte futuar nderin, prestigjin dhe dinjitetin e autoritetin personal. Ishte shembull pozitiv për nxënësit...

tari. Hafiz Xhemali zotëronte disa gjuhë të hueja, vecanërisht arabishten që është gjuha e Kuranit. Kultura gjuhësore përbënte një aspekt të rëndësishëm të personalitetit të tij si mësues i Kuranit, që vlerësohej si bazë në zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror për nxënësit e tij. Gjuha arabe është elementi bazë i mësimit të Kuranit. Nëpërmjet një pune sistematike na mësoi se si të shqiptojmë shkronjat e fjalës, bukur e pa gabime. Jo vetëm kaq por ai e përqëndronte vëmendjen dhe në zotërimin e normave dhe rregullave të texhvidit, dmth në shqiptimin e drejtë të shkronjave dhe muzikalitetin e tij.

Një formim i tillë i jepte prsonalitetit të tij një forcë të madhe që dallohej për individualitetin, nga këndimi melodioz, me aërin kumbues të mbrekullueshëm, që shërbenin si model jo vetëm për nxënësit por për të gjithë teollogët vendas. Ai zotërontë "shtatë mënyrat" e këndimit të Kuranit pasqyruese të përdorimit të ndryshëm në kohën e shpalljes përfshirëse të varieteteve në shqiptim, madje dhe me pak dallime në leksik. Fjala "Elkiraet" që shumësi bëhet kira'at rrjedh nga fjala ka'ra'a, që do të thotë "lexim, këndim" nga ku vjen dhe fjala "Kuran". Është një emër parafoljor , që dotë thotë "Këndim".

Hafiz Xhemali ishte i vetmi nga teologët shqiptar që lexonte Kuranin në përputhje me gjuhën (gramatikën) arabe pa asnjë të metë. Ai respektonte texhvidin në Këndimin e Kuranit. Tregonte qetësi, përulje dhe respekt gjatë këndimit. E shoqëronte me një zë të bukur dhe respektonte rregullat e texhvidit, që do të thotë e zbukuronte me një shqiptim të plotë e të duhur të gërmave të ndryshme në vende të ndryshme. Punë të veçantë bënte me grupin e nxënësve që ishin përfshirë në memorizimin përmendësh të Kuranit.

Ai është i vetmi në historinë e Medresesë së Tiranës, si mësues i lëndës së Kuranit. Për çdo etapë të orës së mësimit, ai zbulonte botën shpirtërore të nxënësve dhe provonte aftësitë dhe shprehitë e secilit. Pikërisht këtë e bënte me përzgjedhjen për t'i inkuadruar disa individë në memorizimin përmendësh të Kuranit, për të përgatitur si hafizë të ardhshëm, pjesë e të cilëve u bëra edhe unë. Në këtë mënyrë ai ishte i suksessshëm në orën e mësimit, duke qëndruar pranë secilit duke ndihmuar në artikullimin e fjalëve dhe shqiptimin e bashtingëlloreve. Ndikimi i tij psikologjik me taktin pedagogjik bënte që nxënësit e grupit të hafizëve të përvetësonin mirë mënyrën e këndimit të Kuranit.

Hafiz Xhemali ushqente edhe nxënësit e tjerë me frymën e ambicies për t'i edukuar me dëshirën, që edhe ato të mësonin sa më shumë pjesë përmendësh. Personaliteti i tij si mësues i Kuranit ishte në një shkallë të lartë, sepse shquhesh si një drejtues e organizues i mirëfilltë i proçesit mësimor. Zotëronte një kulturë të përgithshme teologjike, por mjaft i thelluar në njohjen e Kuranit. Pikërisht , kjo e bënte atë që të ishte shumë i përgatitur nga ana pedagogjike, didaktike e metodike. Nga ana tjetër pasioni për punën me nxënësit, dashurinë dhe respektin për personalitetin e tyre, kompletonin figurën e nderuar të personalitetit të tij si mësues.

Ai zotëronte shprehitë dhe mjeshtërinë e orës së mësimit të Kuranit, që ishte çelësi i suksesit të tij si "Hafiz" dhe mësues i Kuranit. Metodat e përdorura prej tij përmbanin shumë elementë ku përfsshihej jo vetëm marrja e njohurive teknike të leximit të Kuranit, por kjo e gërshetuar ngushtë me zbatimin në praktikë nga çdo nxënës. Kjo e bënte mësimin mjaft tërheqës dhe frutdhënës. Gjatë demostrimit të tij në leximin e pjesëve të Kuranit, atë e dominonte faktori psikologjik, përfshihesh në gjendje emocionale, që i jepnin atij siguri e përgjegjësi specifike për artikullimin e cdo shkronjee fjale. Intelegjenca dhe aftësia mendore kishte arritur te ai, që të kontrollonte funksionin e kujtesës në memorizim të plotë të Kuranit dhe të gëzonte titullin "Hafiz". Aftësinë e inteligjencës e shkrinte dhe te muzikaliteti i Kuranit, mënyra intuitive e shqiptimit dhe improvizimit si dhe ndjenja e ritmit. Të gjitha këto, nëpërmjet një mësimdhënie sistematike e bënin Hafiz Xhemalin shumë të dashur për nxënësit dhe të respektuar nga teologët.

Hafiz Xhemali ishte një teolog i mirëfilltë dhe jo rastësisht Universiteti Teologjik i Stambollit, ku ai u diplomua e emëroi pedagog të saj, si dhe anëtar të Gjykatës Islame, me qënëse ishte diplomuar dhe në jurisprudencë.

Fillimi i vitit 1924, Hafiz Xhemalin e gjen në Shqipëri, deputet të Dibrës në Kuvendin Kushtetues, propozuar nga shqiptarët e Turqisë, në një kohë kur gjendja politike e vendit ishte shumë e acaruar. interesat e Atdheut e sjellin në Shqipëri për të punuar në vendin e tij. Ai erdhi kur u mblodh Asambleja Legjislative Kombëtare, ku për herë të parë zgjidhet Nën Kryetar i saj dhe merr pjesë në përpilimin e ligjeve themelore të Shtetit Shqiptar. Personaliteti i Hafiz Xhemalit kishte përmasa më të gjëra se sa personaliteti i një mësuesi në Medresenë e Tiranës. Për kontributin e tij për Kombin dhe mos pranimin e pushtimit nga Italia fashiste, internohet për 5 vite në Itali. Edhe këtu do të tërhiqte vemendjeen e banorëve të Bergamos. Ai nuk hoqi dorë nga Kurani. Lexonte dhe këndonte dhe ato që e dëgjonin zërin e tij kumbues e melodioz mallëngjeheshin dhe i bënte të nxirrnin lot. Ata e Konsideruan atë njeri të shenjtë dhe i drejtuan lutje Papës që të ndërhyntë për t'a liruar para kohe nga internimi.

Kur u kthye në Shqipëri përjetoi një persekutim të dytë nga regjimi komunist, duke i sekuestruar shtëpinë dhe gjithçka kishte. Komuniteti Musliman, duke parë gjendjen se si përfundoi ky personalitet me vlera kombëtare e mori mësues në Medrese në moshën 63 vjeçare.

Për pedagogun e nderuar Hafiz Xhemali, mund të flasim pambarimisht, se si e drejtonte mësimin e Kuranit, orën e tij mësimore, personalitetin e tij që vinte nga një pedagog i Universitetit Teologjik të Stambollit, mendimet dhe personalitetin e tij si Parlamentar, si anëtar i Gjykatës Islame, si kryetar i Shoqërisë "Bashkimi" të shqiptarëve të Stambollit, drejtues i gazetës "Paqja" dhe ngritës i flamurit të Shqipërisë në Stamboll më 28 nëntor 1912.

Një personalitet i tillë mbeti në hije për shumë kohë deri sa do të vinte demokracia dhe në vitin 2016, mori vlerësimin nga Presidenti i Republikës me titullin "Nderi i Kombit". Edhe sot ky aktivitet do të shërbejë si homazh për kontributin e tij kombëtar, gjatë gjithë jetës e në përjetësi.

Tiranë qershor 2021

NJOFTIM PËR SHOQATA DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.

Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit: **rrugaearberit@gmail.com**

profil

Hysen Kuka, biri i rrallë i Rremullit të Matit

Nga **MEVLUD BUCI**

Hysen Kuka është bir i Rremullit të Matit, i njohur për cilësitë tipike të malësorit të kësaj zone me emër, që manifestohen te shpirt-liria, dituria, thjeshtësia, krenaria për gjurmët e djersës së punës, për familjen fisin, për vendlindjen e tij.

Ai u lind më 9 korrik 1942 në Rremull. U edukua nga prindër atdhetarë, pa harruar traditën e fisit që e mëkojmë me bujarinë e shpirtbardhësinë.

Gjithë këto vlera Hysen Kuka nuk i përvetësoi për inerci, por diti që ato t'i përçojë, me çfarë i sillte si mundësi, edhe formimi i tij vetjak.

Që në shkollën 7-vjeçare të Rremullit si dhe në shkollën e mesme për zooteknik pranë Institutit të Lartë të Veterinarisë, pastaj në studimet e tij (1968-1972) në Institutin "Vojo Kushi" për kulturë fizike, ai mundi të korrë rezultatin e studimeve të tij, që i kishte përgatitur me korrektesë e vullnet.

Duke punuar më pas në gjimnazet "Haki Fejza" dhe "28-Nëntori" në Mat si mësimdhënës i lëndëve edukim fizik dhe ushtarak, Hysen Kuka u dallua për përkrahjen e talenteve të reja, në respektimin e rregullave dhe normave shoqërore, si dhe në ndërtimin e urave të komunikimit me komunitetin.

Këto ditë e rilexova edhe një herë librin e Bajram Canametit "Rremulli-zemra e Matit" dhe u ndala te shkrimi "Bir i Rremullit Hysen Kuka" (f.313-314) dhe, midis të tjerash, shkëputa këtë pasazh:

"Hyseni ishte bir i Hazis Kukës, një burrë i rrallë, i ndershëm dhe i zgjuar, human dhe i sakrificës; prandaj Hyseni qëndroi përballë stuhive të politikës që u lëshuan mbi të si një breshër i çmendur. Ai punoi dhe drejtoi me durim e modesti, dhe këmbëngulje, me drejtësi dhe sinqeritet, pa u korruptuar dhe pa u përkulur. Remulli krenohet me birin e tij, që u priu matjanëve për një ndryshim të sistemit shoqëror pas 45 vitesh të pushtetit monist".



Farie Kuka

Hyseni, përmes meritës u gjend gjithnjë në ballë të veprimtarive, pa urrejtje, pa zemërata apo etje karriere, gjithnjë përmes guximit dhe të shpirtmirësisë për t`i gjykuar njerëzit pa ngjyra partiake.

"Si intelektual i provave dhe i vlerave organizative, ai ishte veprimtari i përkushtuar për demokracinë e vërtetë" - shprehet Haxhi Losha, një nga farmacistët më të mirë të Matit.

Si bir i Rremullit të Matit, Hyseni ka kaluar nëpër sprova të vështira, por gjithnjë ka ditur t`i përballë ato me durim e zgjuarsi. Për këtë, dhe për të, mund të bëhen dhjetëra shkrime, pse jo, edhe monografi. Edhe pse kanë shkruar të tjerë për të, për bashkëshorten Farije - ndjesë pastë, sërish për jetën e njeriut të vërtetë gjenden momente që nuk janë prekur dhe ndriçuar.

Kur shoh një fotografi të Cen Kukës si futbollist, ajo më shpie ndër vite të shkuara dhe vetvetiu ndjek me sytë e mendjes pasionin e tij për sportin dhe sesi ai me këtë arriti të japë aq sa mundej në atë kohë në këtë fushë.



Hysen Kuka

18 vite futbollist, mësues e veprimtar, një jetë e mbushur me emocione dhe përgatitje të lartë. Shoqëria, e veçanërisht vëllezërit e tij Mehmeti e Neziri, motrat Hane, Bardha, krenohen me të. Është një krenari e ligjshme.

Ai të flet për shokët, për fisnikërinë matjane, si dhe, në kujtesën e tij, janë gdhendur futbollistët, që krahas tij, kanë bërë epokë në Mat si: Zyber Xhetani, Astrit Maçi, Qirjako Kola, Shefki Çupi, Dali Farruku, Bashkim Mata, Edison Muça e plot të tjerë. Në këto vlerësime të tij gjen vend një shprehje e urtësisë matjane: "I miri vlerëson të mirin, se është vëlla me xhevahirin, i ligu përbuz të mirin, se është njësoj me vampirin".

Ky nderim i tij shtrihet më gjerë si për Esat Rukën - "Mjeshtër i Madh", Bajram Canametin - poet, studiues dhe publicist, autor i disaa librave me poezi e sidomos me studime biografike, për Kastriot Xhelal Selitën, për Bajram Çupin - ish-mësues i Cenit, Hamit Osmanin - mjek, Gjergj Xhaçkën, Islam Kosovën, Taxhedin Shehun e plot të tjerë.



Hysen Kuka, kapiten i ekipit të Matit

Hysen Kuka është një arkiv jetësor, shembulli i njeriut - demokrat e me vlera, kryetar i parë i PD, Mat-Martanesh, ish nënprefekti i parë i Matit, "Qytetar Nderi" së bashku me mësuesen e talentuar Farie Kuka, bashkëshorte e tij.

Hyseni gjithnjë ka ditur të mësojë nga shokët, por pa harruar të jetë vetë në ballë të punës dhe të përvojave vetjake e kolektive. Modest, kurrë nuk flet për vete, por krenohet për fisin, me të parët, Gjergj, Pal e Hoxhë Kukën. Pal Kuka si katragjysh i Cen Kukës, e ka emrin të shkruar në pllakë në Krujë si gjeneral dhe si besnik i Skënderbeut.



Hysen Kuka, Farie Kuka dhe Sajmiri.

Kur lexova shkrimin "E lindur dhe e përkushtuar për fëmijët" të autores Mimoza Keçi, zëvendës-drejtoreshë e shkollës së mesme të Burrelit "28 Nëntori", mora të dhëna dhe mësova për portretin e Farie Kukës (Kaziu), si mësuese e talentuar dhe mjeshtre e didaktikës dhe komunikimit pedagogjik me nxënësit. Ajo nuk jeton më, sepse më 2 maj 2020, u nda nga jeta.

Hyseni me Farien ka rritur dhe edukuar dy djem: Arbenin dhe Sajmirin, ky i fundit, specialist e mjeshtër, drejtues i Elektrikut. Me bashkëshorten e nderuar mjeken Alkida u prijnë punëve me përkushtim.

Njerëz të tillë bëhen shembull frymëzues për ata që i njohin e bashkë me atë që kanë shënuar si prova të vitalitetit jetësor dhe shoqëror, sjellin njëkohësisht edhe gjurmët e kohës, duke dëshmuar se koha nuk ka qenë e lehtë, por nëse e kupton atë dhe ndjek rrjedhat e saj me ndershmëri, ia del dhe ke me çfarë krenohesh. I tillë është Hysen Kuka, ky intelektual i Matit dhe njëkohësisht njeri i provave që transmetojnë vlera…

NJOFTIM PËR HOTELET, BUJTINAT DHE GUIDAT TURISTIKE QË OPEROJNË NË QARKUN E DIBRËS

Me qëllimin e mirë për nxitjen e turizmit në Dibër, redaksia e gazetës vendos në dispozicion **PA PAGESË** një hapsirë të posaçme informacioni për **GUIDAT TURISTIKE, HOTELET** dhe **BUJTINAT** në qarkun e Dibrës. Të interesuarit të sjellin një **foto të objektit**, të **dhënat e kontaktit** si dhe një tekst jo më të gjatë se **30 fjalë**.
Njoftimi do të qëndrojë pa pagesë në faqen e gazetës në versionin print dhe online nga muaji maj deri në tetor 2020.
Për më shumë informacion:
rrugaearbërit@gmail.com.
Tel: 068 65 08 441 (Whatsapp)

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

NJOFTIME

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

JU KUJTOJMË SE SHKRIMET DUHET TË JENË TË KORRIGJUARA/ REDAKTUARA.

Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë
www.rrugaearberit.com

Selim Çerpja vjen me **Gonxhe në muzg**

Nga **ILMI DERVISHI**

Këto ditë sapo doli nga botimi libri me poezi "Gonxhe në muzg", i autorit Selim Çerpja. Në 76 poezi të këtij vëllimi poetik trajtohen tema të larmishme e në veçanti tema të ditës, fenomene të shoqërisë së sotme. Poezia e tij lexohet rrjedhshëm, ka gjetje artistike, ka muzikalitet me rimë të zgjedhur që tingëllon bukur. Një veçanti e kësaj përmbledhje me poezi është këndvështrimi i autorit mjaft origjinal të ngjarjeve e fenomeneve të jetës së përditshme.

Selim Çerpja e ka librin e parë me poezi , por ai ka vite që shkruan, ka lexuesit e tij që e lexojnë në dorëshkrim, në rrjetet sociale por edhe në disa Antologji poetike, ku është pjesëmarrës me poezinë e tij. Vet Selimi vjen nga një trevë ku shquhet për art e kulturë, siç është Dardha, jo vetëm me muzikantë, këngëtarë, instrumentistë e valltarë virtuoz, por dhe shkrimtar e poet që kanë botuar letërsi artistike. Vetë Selimi vjen nga një familje me tradita kulturore. Gjyshi i tij, Qazim Selim Çerpja, është një nga themeluesit e grupit artistik të Dardhës, më 30 qershor 1949, e më vonë u bë bërthama e grupit që përfaqësoj Shqipërinë në Festivalin Botëror të Rinisë në Moskë.

Poezitë si: "Në diçka më ngjanë", "Sy të përlotur", "E vërteta", "Ndenjë e heshtur", "Nëse të mungoj" etj., duken si tituj të thjesht, por brenda rreshtave të poezive ka një fabul, ka një poezi që të shijon leximi dhe mbetet në kujtesë. Poezitë mbajnë brenda tyre sinqeritetin e autorit, shpesh gjenë unin poetik, që poezia ka indicje një moment gati intim apo personal e pas leximit lexuesi gjen diçka nga vetja e tij e ngritur në art.

Një vend të veçant në krijimtarinë e Selim Çerpes zë dhe poezitë me motive të dashurisë, të asaj dashurie të pastër e njerëzore e të jetuarit gjatë me dekada një jetë me dashuri. Në poezi nuk ka asgjë personale, por konceptimi filozofik i autorit, duke dhënë mesazhe të qarta artistike e filozofike të konceptit të dashurisë, të asaj dashurie të madhe që njerëzit i bën të lumtur.

Interesante dhe shumë prekëse është poezia "Puthje mes hekurave", që të kujton letërsinë e burgut, trajtuar nga shumë shkrimtarë e poetë europianë e shqiptarë. Poezia qëndron mes fantazisë dhe realitetit, e fantazia poetike e poetit, këtë moment që ndodhi apo ka ndodhur, e ngre në art, i jep vlera artistike universale:

E kujtoi puthjen e parë, / Se do ndodhte se kisha menduar,/ Shumë më e ëmbël se puthja e parë,/ Dhe pse mes hekurave të përqafuar… (Faqe 27).

Poezia vjen në laboratorin krijues të autorit ashtu si moment, si një çast dhe i jep jetë në vargje të shkruara bukur e me frymëzim, siç janë poezitë "Për nënën", "Sytë e tu", "Motrat", "Luleboret e vëllait tim" etj., ku atë ndjenjën njerzore mes njerzëve të dashur



e vesh me petkun artistik, duke na dhënë poezi të frymëzuara, pa fjalë të tepërta, na jep atë momentin magjik të ndjenjës së çastit njerzor.

Edhe pse është larguar shume shpejt nga vendlindja, rreth viteve 1980, duke ardhur në Tiranë, në poezin e Selim Çerpes gjen motive të vendlindjes të shkruara me mall e nostalgji, ku mes tyre do të veçoja poezit "Malli për vendlindjen" dhe "Viset ku linda", ku çdo lexues do përjetonte emocione e nostalgji për vendlindjen e tij.

Libri është botuar nga Botimet M&B, është paraqitur bukur nga ana grafike. Së shpejti poeti Selim Çerpja do jetë para lexuesi me librin e dytë me poezi "Nën pemën e mjerimit", që është në proces botimi.

AH, SIKUR…

Çdo festë bashkë mbi tavolinë,
Avitur rreth saj ata që jemi,
Pjatat mbushur me gostinë,
Mungojnë të afërmit që si kemi.

Sa emocione…ngec kafshata,
Mundohesh ta fshehesh, por s'je i qetë,
Në sofrën e ngrohtë as sot s'i pata,
Patjetër lotët rreshqasin vetë.

Kërkojmë të flasim me Perëndinë,
Mëshirë për ëndrrat që s'ua plotësuam,
Vargje elegjie për ata që s'e dinë,
Dhe për ne, që prinderit na munguan.

MALL PËR VENDLINDJEN

O lotet e mi, që bini mbi gurë,
Njomeni pak nga pak se kam kujtime,
Janë gurët që lozja me ta unë dikur,
Të thjeshtat lojëra, që gezonin zemrën time.

Sytë derdhin lotë edhe mbi ferra,
Ndjejmë mall edhe pse të gjëmbonin,
Rreze tyre çelnin lule që u vinte era,
Fëmijet i mblidhnin, tjerëve ua dhuronin.

Jeta është luftë, nga do të shpënë,
Mund të ndjehesh diku tjetër mirë,
A harrohen vallë, çukat ku ke rënë,
Dhe pse të kujtojnë një jetë të vështirë.

Jetë përrallore, ndoshta në Dubai,
Diku tjetër mund të bëhesh Mbret,
Vendlindjen, në zemër do ta mbajë,
Frymën do ma marrë, trupin do ma tretë…

ERDHE TI…

Çdo gjë me dukej se ndaloj,
Dhe jeta s`po gjen lumturi,
Thash, dikush më mallkoi,
Kur papritur…erdhe ti.

Acar, stuhi u ba moti,
As rrezja diellit nuk po ndrijë,
Mendova, njeriu bën jetë koti,
Kur papritur, erdhe ti.

Nuk shihja pranverë të lulëzojë,
As natyra s`kish stoli,
S`dëgjoja bilbilin të këndojë,
Kur papritur, erdhe ti.

Si një libër qënka jeta,
Tek fleta e fundit s`dua t`arrijë,
I pa ngopur me jetën mbeta,
Kur papritur, erdhe ti.

MË BËRË TË JETOJ

Si i dehur rend nga pas,
Bukurisë sate mëkatare,
Zemr e gjora sa nuk plas,
Nga ikjet tuaja lozonjare.

Nuk me ikën ketrushe sot,
Ta kam zënë me kohë pusinë,
Kam ardhe enkas në këtë botë,
Veç për t`falur dashurinë.

Do të mbaje n`bahçe si zanë,
Me aromë bjeshke dhe duke qesh,
Me lot malli i dola mbanë,
Mbas teje zemër, moj konteshë.

Çdo ditë ty unë të prisja,
Mendoja vallë pse vonoj,
Nga meraku doja të vdisja,
Më bëre ti…të jetoj.

LEGJENDA

Seta

Nga **SHAQIR SKARRA**

Gurgullon poshtë me rrapëllimë dhe e pret Drinin plak mes për mes mu tek Ura e Lushës. Kur vjen e inatosur, sa e sa veta ia kanë parë sherrin e, megjithatë, edhe kjo ka legjendën e bukur të saj, që tregohet ende jo vetëm në Çidhën, por në të gjithë trevat e Dibrës.

Thonë se Seta në kohë të hershme, që nuk mbahen mend, nuk ka qenë lumë siç është sot. Ajo ishte një cucë e bukur, rritur në këto shkrepa, që për nga bukuria vetëm zanat e malit ia kalonin. Kishte hedhur shtat për bukuri dhe binte në sy kudo ku ndodhej mes moshatarëve të saj. Ishte rritur tamam për nuse, por akoma nuk kishte trokitur njeri në derë për ta kërkuar Setën për nuse. Jo vetëm dy gërshetat e gjatë hedhur supeve, por një hijeshi më të madhe ia jepnin edhe dy mollëzat e faqeve sa, kur qeshte, i bëheshin dy gropa to.

Çdo ditë herët në mëngjes merrte tufën e deleve para e nisej lart, shumë lart fshatit të saj, pikërisht në ato pllaja të bukura, kur jo vetëm kishte bar të bollshëm për dele, por kishte dhe lule të ndryshme e mjaft të bukura, që Seta i mblidhte nga një tufë e i merrte me vete në shtëpi.

Një ditë ishte takuar rastësisht me një djalë të ri. Ai, hipur mbi një kalë të bardhë e me shpatën brezit, kishte ndaluar përpara këmbëve të Setës:

- A pihet ky ujë, moj burrneshë?

- Pihet, mor trim, por nuk të lënë armët të ulesh për të pi ujë. Po prit pak!

Seta mori shtamën që e mbante me vete, u gërmua dhe e mbushi me ujë tek burimi. Një buzëqeshje e lehtë ia tradhtoi fytyrën e mollëzat e faqeve u bënë gropë. Trimi, ashtu siç erdhi edhe iku, por Seta atë natë nuk fjeti gjumë. U end gjithë natën e natës mes ëndrrave, me djaloshin që i dha ujë, por që imazhin e fytyrës ende nuk e perceptonte dot. Erdhi si frullizë e si frullizë iku. Nesër në mëngjes u nis përsëri me tufën e deleve para. Këtu u takuan disa herë bashkë, por nënës nuk i tregoi.

Një ditë ishte drekë, dielli përvëlonte e delet ishin grumbulluar bashkë nën një hije ahu. Seta pa një kalë të bardhë që vraponte. I doli para dhe pa se ishte kali i trimit që dashuronte. Kali u ul mbi gjunjë dhe sikur i lutej Setës të ngjitej në kurrizin e tij. E ashtu bëri Seta. Kali u ngrit e fluturoi duke kaluar kodra e male. Në një luginë pa të shtrirë djaloshin që i kishte dhënë ujë me shtamën e saj, i larë në gjak, i cili po jepte shpirt. Kur pa vashën në gjunjë pranë tij, ktheu kokën nga kjo dhe mezi i nxori dy fjalë.

- Po as emrin nuk ta di moj vashë, edhe pse më ke dhënë ujë në shtamën tënde!?

- Quhem Setë, jam nga fshati atje poshtë, në shtëpi kam vetëm nënën e moshuar.

- A ta vendos kokën tek ti pak, moj Setë? Vasha u afrua, mori kokën e gjakosur të trimit në prehër dhe sakaq koka iu var poshtë. Me duart e saj Seta ia mbylli sytë, të cilit ende nuk i mësoi as emrin. Nën hijen e një ahu të madh ajo filloi të gërmojë me majën e shpatës së trimit, derisa vonë në darkë, pasi përgatiti varrin, e mbuloi me dhè, derdhi disa lule të freskëta, që nuk mundi t'ia jepte sa ishte gjallë dhe doli në një livadh duke qarë. Qau gjithë natën në mal e vetme, sa në mëngjes plasi dhe ra e vdekur për tokë nga të qarët e shumtë që bëri. Në atë livadh, ku plasi Seta, filloi të burojë ujë. Ishin lotët e Setës që kishte derdhur. Vonë, nëna plakë, kur pa se Seta nuk po vinte, doli sipër fshatit dhe filloi të thërrasë me sa fuqi kishte:

- Setaaaaaaaaaaaaaaa? Seeeeeeetë moj? Por askush nuk i përgjigjej plakës. Pas pak tek këmbët e saj erdhi një ujë i pastër si qelibar, që vinte gjithë zhurmë e potere, që nga sipër maleve. Uji sa vinte e shtohej. Ishin lotët e Setës që kishte derdhur për trimin e saj, por Seta nuk u kthye më në fshat. Mbeti në legjendë e sot e kësaj dite dhe lumi ka emrin e saj, Seta.

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

KSENOMANIAKU

rrëfenjë nga Abdurahim Ashiku

Ekam zakon që në takime të shkoj disa minuta përpara. Këtë m'a ka rrënjosur në mëndje e ma ka bërë hobi të jetës një shoku im i viteve studentore. Ai thoshte se po qe se vonohesh në një takim, pritësi që në sekondat e para pasi akrepi ka shënuar orën e saktë, nis të të numërojë të metat e tua, madje të gërryej e të gërryej për të gjetur e sajuar anët më negative.

Kjo më ka ndodhur edhe mua kur kam pritur e... kam pritur njerëz të ndryshëm. Gjithnjë tek anët negative të tij kam ngulur kazmën e gërryerjes.

Sigurisht u ka ndodhur edhe juve...

Shoku im i emigracionit më mori në telefon dhe më tha që të takohemi tek Hondo Centër në Omonia. E kishte ftuar një "Njeri i Dëgjuar" nga Tirana dhe donte që të ishim bashkë në bisedë. Kjo, sepse në një takim me të pikërisht në të njejtën datë para një viti në Tiranë për të cilin më kishte folur me habi superiore, i dukej se do të kishte të njejtat fjalë dhe në qeskën plastike të njejtën kërkesë. Njeriu nga Tirana kishte ardhë në Athinë dhe i kishte kërkuar takim "tek hondoja". Mezi ishin sqaruar derisa kishte kuptuar se bëhej fjalë për Hondo Centër në Omonia.

Unë zura një cep në sheshin para godinës së njohur tregtare pesë minuta përpara takimit. Para meje kishte shkuar "Njeriu i Dëgjuar" nga Tirana. Nën dorën e djathtë i varej një qeskë blu. Qeska ishte transparente dhe në të dalloheshin mirë tre libra goxha të trashë që pak a shumë rreth një kilogrami peshë rrokulliseshin. Shikonte herë pas here orën dhe vente e vinte në një trajektore lëvizjeje që më kujtonte një mësues matematike të vendlindjes sime që pas shumë vitesh burgu politik ishte këthyer në profesionin e vet si nëndrejtor shkolle. Mësuesi-nëndrejtor, në pushimet midis orëve të mësimit dilte dhe bënte ecejake nëpër koridor. Kolegët në fillim u habitën nga ecejaket e gjata dhe të heshtura të tij derisa mësuan se kjo lloj lëvizjeje drejtvizore ishte refleks i lëvizjeve në pushimet që u jepeshin të burgosurve.

Unë e njihja "Njeriun e Nderuar" sepse kishte qenë pjesë e trupit gjykues ideologjik në provimin pasuniversitar të filozofisë marksiste-leniniste në Universitetin e Tiranës. Për të thonin (dhe unë e përjetova dramatikisht me një notë më pak sa meritoja) se kishte maninë që të bënte pyetje të holla në fushën e etikës dhe estetikës marksiste-leniniste që edhe ai, po ta pyeste ndokush i rangut më të lartë, turbull do t'u përgjigjej....

Nejse. Këto bëjnë pjesë në serialin filmik trunor "Përrallë nga e kaluara" dhe unë nuk do t'i fusja fare në kujtesën e trurit kompjuterik sikur ai të mos e kishte nisur bisedën pikrisht me këtë serial.

Shoku im u ngjit në shesh, me ndërmjetësinë e shkallës zinxhirore nga metroja e Omonias, fiks në orën e caktuar. Pasi tokëm duart dhe u pyetëm me njeri - tjetrin, shoku im tha që të ngjitemi në katin e shtatë të qendrës tregtare sepse atje, i kishte thënë vajza, është një lokal shumë i bukur dhe nga xhamat e mëdhenj mund të shohësh si në pasqyrën e përrallës jo vetëm sheshin Omonia poshtë por edhe krenarinë e Athinjotëve - Akropolin e lashtë.

Njeriun e Dëgjuar e lam në një vend që të kulloste sytë me pamjen dhe ne zumë rradhë për të marrë kafetë dhe anekset përkatëse sepse lokali ishte i llojit "vetëshërbim". Për një moment sa nuk na ranë tabakatë në duar sepse Njeriu i Dëgjuar nuk ishte atje ku e kishim lënë. Pyetëm njeri tjetrin me zë goxha të lartë dhe vumë sytë në kërkim në tërë hapsirën sa një stadium basketbolli të lokalit. Kur e kapëm siluetën e tij sa nuk bërtitëm "Eureka" apo "Evrika" siç shqiptohej në greqishten e lashtë e siç shqiptohet edhe sot. Na tha se këtu i dukej Athina më bukur...Nejse, një njeriu të ditur që tërë jetën e tij është marrë me etikë dhe estetikë i lejohet të ndrrojë kursin e shikimit si të dojë e nga ku të dojë.

Ramë në bisedë, ose më mirë të them ai fliste dhe ne dëgjonim, ai ishte mësuesi e ne studentët, paçka se auditori ishte shumë i vogël, fliste një e dëgjonin dy. Gjene mirë se sot auditorët janë "flasin të tre njëherësh e nuk dëgjon asnjëri".

Njeriu i Ditur kishte qenë i persekutuar. Kur ishte bërë ai, qarkullimi i madh, e kishin çuar nja dy-tre kilometra larg universitetit si drejtor në një kurs kuadrosh. Rrogën nuk ia kishin ulur. As auditorin e dhënies së leksioneve për studentët. Megjithatë, thotë ai, ajo kohë ka qenë koha më prodhimtare e tij në përgatitjen për botim dhe botimin e librave. Ia kishte gjetur çilen. Kishte vënë të japin leksione e të drejtonin nja dy vetë "me shkollë partie". Ky për të ishte sakrilegji, dhuna që regjimi i diktaturës kishte ushtruar ndaj tij. Por ai, afër të tetëdhjetave në moshë, e ndjente veten të persekutuar edhe në demokraci. Në fillim e kishte nxjerrë në pension Berisha. Më tej, pas një rikthimi në punë, e kishte nxjerrë në pension Nanoja. Tani ishte rikthyer përsëri në punë. Shkruante dhe botonte libra. Jo me paratë e tij por me ato të shtetit. Kur tha këto ngriti qeskën lart dhe nxorri prej saj tre libra, njeri prej të cilëve, shkruar me gërma të vogla kompjuterike sa edhe gjysliket nuk i rroknin, i kalonte të gjashtëqind faqet. Kërkonte t'i përkthente në greqisht...

Shoku im e mori librin e trashë, e hapi, rregulloi syzet dhe nisi ta shfletojë. Ishte një libër që fliste për mitet dhe legjendat greke, për gjëra që ishin thënë e stërthënë, për ndodhi të kaluara gojë më gojë e të transformuara kohë më kohë, për burime skenarësh filmash të tipit "Zina" e filmash hollivudjanë. E pyes në se ka në libër pasqyrime dhe analiza për mitet shqiptare, për atë pasuri shpirtërore kombëtare që lidhet me kreshnikë e zana, me Mujo e Halilë, me Gjergj Elez Alia e bajlozë të zinj. Qeshi me ironi dhe më tha se librin e ka shkruar për grekërit e jo për shqiptarët. Shoku im ndërhyri dhe duke iu referuar tërë botimeve dhe filmimeve hollivudjanë e me karton, tha se për të tëra këto kanë shkruar e publikuar të huajt dhe se tema e miteve dhe legjendave të lashta greke është një temë e rrahur më shumë nga të huajt se grekët. Këtu ai në fillim u skuq e më pas u nxi. Pamja e tij më ngjau me pamjen e lypsit të rrugëve që ka fshehur këmbën nën pantollona për t'i treguar botës se është sakat, me çehren e lypsit kur dikush e shtyn dhe para njerëzëve del këmba e fshehur.

...Vite më parë për këtë njeri pata dëgjuar se kishte bërë një libër goxha voluminoz për një botues grek, libër të cilin e kishte përkthyer një nëpunës i botuesit dhe ishte shpërndarë anë e kënd Greqisë. Unë nuk e kam lexuar atë libër sepse së pari nuk më ka rënë në dorë dhe së dyti nuk e zotëroj aq thellë e gjërë greqishten sa të dal në breg i tharë. Shoku im që e kishte kaluar diagonal më pat thënë dikur se nuk ishte gjë përveçse një kronikë servilizmi, një përulje, një lypjeje e rëndomtë rruge.

...Edhe sot, në katin e sipërm të Hondo Center, po lypte. Kërkonte që të tre librat e tij, të botuara në shqip me paratë e taksapaguesve shqiptarë, t'i përkthente e t'i botonte në greqisht, t'ia përkthenin xhaba dhe t'ia botonin xhaba. Ani se ato libra nuk do t'i prekte kush me dorë, as grekë e as të tjerë. Atij i mjaftonte që librat të përkthenheshin e të botoheshin në gjuhë të huaj, ta merrte vesh (e kush ta merrte?) se shqiptarët përgjëroheshin për të huajën, për të kaluarën dhe të sotmen, ishin ksenomaniakë të shkallës sipërore...

...Tek u futëm në ashensorin luksoz e po zbrisnim një nga një katet shoku im kaloi nëpër dhëmbë fjalën ministri...

...Vite më parë, në vjeshtën e 91-shit, ai kishte qenë dëshmitar okular i deklaratës së një ministri shqiptar të periudhës së tranzicionit. Ministri kishte deklaruar para autoriteteve vendase që e shoqëronin se ai nuk kishte as frigorifer, as lavatriçe as televizor me ngjyra dhe se këto ishin pasojë e diktaturës...Gazetarët, si të kishin përpara një lyps të rëndomtë rruge, kishin kruajtur xhepat dhe të nesërmen ministri kishte ikur për në zyrën e tij në kryeqytetin shqiptar i shoqëruar nga një furgon me tërë pajisjet elektroshtëpiake, inventar i zakonshëm i një familjeje të zakonshme !...

...Kur zbritëm në sheshin para qenrës së madhe tregtare në sheshin Omonia Njeriu i Nderuar ia la në dorë qeskën me libra që deri në ato çaste i varej si hejbe. Një vit më parë, kur ishin takuar në Tiranë ai ia kishte lënë për një çast në dorë qeskën me libra dhe pastaj ia kishte marrë përsëri. Sot nuk e mori me vete...

...Atë ditë në Athinë bënte vapë e madhe !

Ai priti dritën jeshile për të marrë harkun orar të rrethit të Omonias. Shoku im vuri këmbët në shkallët zbritëse të metrosë së qendrës së kryeqytetit grek. Unë prita të hapet drita jeshile dhe mora krahun antiorar të rrethit të sheshit me tregime e ndodhi të shumëta për mërgatën shqiptare të fundit të shekullit të kaluar, ndodhi që ndonjëherë do të tregohen si mite e legjenda.

NEKROLOGJI

Ndahet nga jeta **Qemal Kërkuti**, mësuesi i mijëra nxënësve

Qemal Kërkuti u nda nga jeta më 17 qershor 2021. Qemali u nda nga familja, djemtë dhe vajzat dhe nipërit e mbesat, nga miqtë e shokët e tij duke lënë në dëshpërim të thellë gjithë ata që kanë jetuar dhe punuar me të.



Qemal Etem Kërkuti ka qenë mësues nga brezi i vjetër që ka lënë gjurmë në arsim në zonën e Maqellarës, për cilësitë e tij të larta si edukator dhe drejtues i aftë, që për 41 vjet la gjurmë të thella në brezat e nxënësve të tij. Do të mbetet i pashlyer në breza kontributi i tij në të gjithë zonën e Maqellarës si mësues i talentuar, si drejtor e nëndrejtor në shkollën "Hamdi Lleshi" Majtarë dhe në shkollën e Maqellarës deri sa doli në pension në vitin 2000.

Ai lindi më 1942 në Çernenë të Maqellarës në një familje me tradita të vyera patriotike. Xhaxhai i tij ra dëshmor i Luftës Nacionalçlirimtare duke dhënë jetën për çlirimin e Tiranës në nëntor 1944. Jeta e Qemalit është një shembull plot krenari për familjen e tij, për shokët dhe dashamirët. Pasi mbaroi shkollën pedagogjike punoi si mësues në Maqellarë dhe drejtues më 1964 në shkollën e Majtarës, pastaj mbaroi studimet në degën gjuhë – letërsi në Institut, dhe punoi deri sa doli në pension.

Qemal Kërkuti do të mbetet në memorien e kolegëve të tij si mësues shumë i përgatitur që me metodat e tij e bënte tërheqëse dhe të dashur gjuhën shqipe dhe letërsinë. Udhëhiqte me shembullin e tij personal punën në shkollë, ishte aktiv në tërë veprimtarinë mësimore dhe edukative, ishte gjithmonë i papërtuar duke ndihmuar me shembullin e tij tërë shokët dhe shoqet mësues dhe edukatore. Ai së bashku me bashkëshorten e tij, Lirie Kërkutin (Goxhi), ndarë nga jeta pak më shumë se 1 vit më parë, është çifti model i mësuesve në zonën e Maqellarës që me punën dhe shembullin e tyre u bënë shumë të shtrenjtë për të gjithë kolegët e tyre.

Qemal Kërkuti ishte jo vetëm mësues i zoti, por dhe një veprimtar i tillë që dha shembull në ngritjen social-kulturore, artistike dhe sportive në vitet '60 – 90'. Kjo ishte një veprimtari që e bëri të shquhej dhe si artist, dhe si futbollist, edhe si veprimtar në të gjithë fushat e jetës në atë periudhë kur Maqellara shquhej në Dibër në këto aktivitete me shumë vlera.

Qemal Kërkuti, mjeriu që mësoi me qindra nxënës në zonën e Maqellarës, do të mbetet në kujtesën e brezave . Ai do të jetë shembull krenarie për familjen e tij, për vëllezërit dhe motrat, për fëmijët dhe nipërit dhe mbesat që la pas. Jeta dhe vepra e tij do të kujtohen përgjithmonë nga të gjithë.

Le të prehet i qetë në pafundësi mësuesi i shquar Qemal Kërkuti duke lënë shembullin e bukur të Edukatorit me shkronjë të madhe.

Ramazan Ilnica, Shahin Lazri, Qamil Sula, Neki Osmani, Baudin Strazimiri, Petrit Myftari, Skënder Pahumi, Avni Gjoni, Ruzhdi Keshi, Hajri Xhili, Jeton Tafçiu, Jonuz Duka, Ramazan Piku, Zabit Lleshi, Islam Uka, Artan Kerkuti

8/7/2021

Big market

DI ÇFARË ZGJEDH!

Ejani të përfitoni Nga Super Ofertat

NGA 8-15 KORRIK

DJATHE
LOPE
1KG



Oferta
299 ~~370~~ lekë

oferta 1+1

PULE
TIK TIK
1PULE
+ GJYSEM



Oferta
299 lekë

KOFSHA
PULE
1KG



Oferta
149 ~~200~~ lekë

PARIZIER
EHW
1KG



Oferta
499 ~~470~~ lekë

KERNACKA
SONY



Oferta
85 ~~130~~ lekë

PANNA
SANIA
200 ML



Oferta
55 ~~70~~ lekë

MAJONEZE
TUSCE



Oferta
190 ~~245~~ lekë

SARDELE
TRATA



Oferta
109 ~~130~~ lekë

MIELL
DIAMOND
1KG



Oferta
49 ~~60~~ lekë

MAKARONA
DONNA CHIARA
500 GR



Oferta
50 ~~75~~ lekë

ORIZ
DIAMOND



Oferta
75 ~~95~~ lekë

oferta 1+1

SALCE
+ FERGESE
SEJEGA



Oferta
159 lekë

Oferta te vlefshme vetem ne PESHKOPI & MAQELLARE

Shfleto ofertat në vijim

Big Market Big Market www.bigmarket.al

cyan magenta yelloë black